



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar për auditimin e ushruar në Autoritetin e Konkurrencës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

“AUDITIM FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIE”

NË

AUTORITETIN E KONKURRENCËS

Tiranë 2024

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	3-4
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	3-4
3.	Konkluzion i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	6
II.	HYRJA	6-7
1.	Objektivat dhe qëllimi i auditimit	7
2.	Identifikimi i çështjes	7-8
3.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	8
4.	Përgjegjësitë e audituesve	8
5.	Kriteret e vlerësimit	8
6.	Standardet e auditimit	9
7.	Metodat e auditimit	9
8.	Dokumentimi i auditimit	9-10
III	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	10
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	10
2.	Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit:	10
2.1	Hartimi dhe zbatimi i buxhetit të shtetit. - Zbatimi i kriterëve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit. -Përshkrimi dhe realizimi i të ardhurave.	10-20
2.2	Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit. -Vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur saktë dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse, si dhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare. -Inventarizimi i pronës shtetërore. -Opinioni mbi pasqyrat financiare të vitit 2023.	20-35
2.3	Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave.	35-39
2.4	Zbatimi i dispozitave ligjore mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare. -Ligjshmëria saktësia e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe arkës.	39-61
2.5	Prokurimet e fondeve publike -Zbatimi i legjislacionit për realizimin e procedurave të prokurimit publik -Lidhja dhe zbatimi i kontratave deri në marrjen në dorëzim të mallrave/punëve dhe shërbimeve.	61-71
2.6	Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar.	71-75
2.7	Probleme të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimit.	75
IV	REKOMANDIME	75-82
V	ANEKSE	83-110

I.PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1.1 Përshkrim i shkurtër i Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Autoriteti i Konkurrencës është organ publik, i pavarur. Buxheti vjetor për financimin e veprimtarisë së Autoritetit, i cili përbën zë me vete në Buxhetin e Shtetit, miratohet nga Kuvendi i Shqipërisë. Të ardhurat që krijohen në zbatim të këtij ligji, përfshirë edhe të ardhurat nga gjrobat, derdhen në Buxhetin e Shtetit dhe përdoren sipas akteve ligjore në fuqi. Autoriteti mban llogari të shpenzimeve dhe të të ardhurave faktike, në përputhje me legjislacionin shqiptar të kontabilitetit.

Auditimi i këtij institucioni ka rëndësi përse i përket kryerjes së transaksioneve financiare dhe përdorimin e fondeve publike.

Qëllimi i këtij auditimi, synon në dhënien e opinionit financiar me siguri të arsyeshme, për periudhën 2021-2023 dhe dhënien e opinionit të përputhshmërisë mbi veprimtarinë e AK për periudhën 2021-2023. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime, me synim marrjen e masave dhe veprimeve korigjuese nga subjekti i audituar. Në përmbushjen e qëllimit të auditimit janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

-Hartimi dhe zbatimi i buxhetit të shtetit. *(Zbatimi i kriterëve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit. Përshkrimi dhe realizimi i të ardhurave).*

-Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit. *(Vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur saktë dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse, si dhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare. Inventarizimi i pronës shtetërore. Opinioni mbi pasqyrat financiare të vitit 2023).*

-Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave.

-Zbatimi i dispozitave ligjore mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare. *(Ligjshmëria saktësia e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe arkës).*

-Prokurimet e fondeve publike. *(Zbatimi i legjislacionit për realizimin e procedurave të prokurimit publik. Lidhja dhe zbatimi i kontratave deri në marrjen në dorëzim të mallrave/punëve dhe shërbimeve).*

-Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar.

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, bazuar në kombinimin e testeve të ndryshme në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testeve të kryera me qëllim arritjen e objektivave të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:

a. *Intervistimi* - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse:

b. *Raporte dhe informacione* - shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve relevante që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe drejtimit e auditimit;

c. *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm*- duke marrë informacionet e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar të subjektit;

d. *Verifikimi në sistem dhe në terren*- me përzgjedhje të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;

e. *Të kombinuara*, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit në tërësi, dhe sipas drejtimeve në veçanti.

I.1 Përshkrim i përmbledhur i gjetjeve dhe rekomandimeve nga auditimi në terren.

Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se Autoriteti i Konkurrencës për periudhën 01.01.2021 deri në 31.12.2023, paraqet mangësi në disa drejtime të veprimtarisë. Gjetjet kryesore të rezultuara nga auditimi në vijim:

I. Nga auditimi i procesit të inventarizimit të aktiveve afatgjata dhe afatshkurta të realizuar në AK, rezultoi se: Për vitet 2022-2023 janë parashikuar dhe propozuar për tu nxjerrë nga përdorimi aktive me vlerë totale 3,196,058 lekë (respektivisht v.2022 propozuar 9 artikuj me vlerë 490,232 lekë, v.2023 propozuar 27 artikuj me vlerë 2,705,826 lekë). Procesi i nxjerrjes nga përdorimi dhe asgjësimit të aktiveve të propozuara, është bërë në kundërshtim me UMF Nr.30 datë 27.12.2011, i ndryshuar pika 109, pasi rezultojë mungesë e gjurmës së kryerjes së këtij procesi.

II. Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik viti 2023, rezultoi se në procedurën “Blerje autoveture e re për nevojat e AK”, në zbatim të Kontratës Nr.255/10, datë 15.06.2023 është likuiduar OE fitues “A” me Urdhër Shpenzimin Nr.267, datë 10.11.2023 në vlerën 3,500,000 lekë me TVSH. Bazuar në ofertën e paraqitur nga operatori, vlera e saj rezulton 2,900,000 lekë pa TVSH/3,480,000 lekë me TVSH. Nga mbartja e gabimeve materiale në vlerë që nga aktet e KVO mbi vlerësimin e ofertës deri në lidhjen e kontratës, është krijuar dëm për buxhetin e AK në vlerën 20,000 lekë (500,000 lekë –3,480,000 lekë) përfituar padrejtësisht nga OE fitues.

III. Nga auditimi i procedurave të kryera me sistem dinamik blerje bileta avioni rezultoi se: Me Urdhër Shpenzimin Nr.45, datë 09.03.2022 është likuiduar OE F. SHPK, me vlerë 74,221 lekë ose 73,616 lekë më shumë se oferta e paraqitur. (oferta në vlerën 605 lekë). Fatura elektronike e sjellë nga OE rezulton në vlerën 74,221 lekë dhe është nënshkruar edhe nga Komisioni, ndërkohë që procesverbali i vlerësimit nga Komisioni është nënshkruar për ofertën në vlerën 605 lekë paraqitur nga OE F. SHPK, duke shkaktuar dëm për buxhetin e AK në vlerën 73,616 lekë, përfituar padrejtësisht nga OE F. SHPK.

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si vijon:

Rekomandimi: Autoriteti i Konkurrencës të vlerësojë dhe të analizojë vlerën prej 3,196,058 lekë propozuar për t’u nxjerrë nga përdorimi, e cila rezulton pa dokumentacion justifikues ku të përcaktohen shkaqet, arsyet, përgjegjësitë ligjore dhe financiare.

Rekomandimi: Të analizohen rezultatet e grupeve të inventarizimit për të formalizuar procesin e vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësinë shpenzuese; listën e aktiveve të identifikuara dhe kriteret për vlerësim, procesverbalin për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve si dhe përgjegjësitë për nxjerrjen nga përdorimi ose tjetërsimin e aktiveve në referencë UMF Nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar.

Rekomandimi: Komisionet e Vlerësimit të Aktiveve për nxjerrjen jashtë përdorimit, në përfundim të procesit të inventarizimit të aktiveve të përpilojnë një raport përmbledhës të detajuar mbi procedurën e ndjekur për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, arsyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës.

Rekomandimi: Të merren masa nga titullari i Autoritetit të Konkurrencës të nxjerrë aktin administrativ për kërkimin e dëmit shkaktuar buxhetit të AK në vlerën 20,000 lekë, përfituar padrejtësisht nga OE “A”, duke ndjekur në rrugë gjyqësore kthimin e tij në të gjitha shkallët e gjykimit.

Rekomandimi: Të merren masa nga titullari i Autoritetit të Konkurrencës të nxjerrë aktin administrativ për kërkimin e dëmit shkaktuar buxhetit të AK në vlerën 73,616 lekë, përfituar padrejtësisht nga OE “F”, duke ndjekur në rrugë gjyqësore kthimin e tij, në të gjitha shkallët e gjykimit.

1.3. Konkluzion i përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit.

Opinion mbi auditimin financiar (I pamodifikuar, me theksim të çështjes)¹:

Ne kemi audituar Pasqyrat Financiare Vjetore (PFV) të Autoritetit të Konkurrencës (në vijim AK), për periudhën ushtrimore 01.01.2023-31.12.2023, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, të performancës financiare, të ndryshimit të aktiveve, të fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare. Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, pasqyrat financiare të AK, paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar në datën 31.12.2023 dhe rezultatet e operacioneve të tyre dhe të flukseve monetare për vitin e përfunduar, por gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare nuk përmbanin gabime materiale por, ekzistojnë apekte që duhen nënvizuar.

Audituesit nën gjykimin profesional e të pavarur japin një opinion të pamodifikuar me theksim çështje, pasi ekzistojnë aspekte që duhen nënvizuar. Gjithashtu ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e **opinionit të pamodifikuar me theksim çështje** mbi pasqyrat financiare.

Baza për opinion mbi pasqyrat financiare.

Ne kemi kryer auditimin financiar në mbështetje me Ligjin Nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI-s) mbështetur në ISSAI 200 “Parimet e auditimit financiar”, ISSAI 2000 “Aplikimi i standardeve të auditimit financiar”, në Manualin e Auditimit Financiar të KLSH-së, të miratuar me Vendimin Nr. 246, datë 29.12.2022 të Kryetarit të KLSH, si dhe ISSAI 130- Kodi i Etikës. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipër përmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin Nr.56 , datë 30.04.2015, të Kryetarit të KLSH-së.

Ne besojmë se evidencat e marra gjatë auditimit janë të mjaftueshme dhe krijojnë bazën e arsyeshme për dhënien e opinionit **të pamodifikuar me theksim çështje**. Nën gjykimin profesional të audituesit është marrë në konsideratë pragu i materialitetit për vitin 2023 (për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar në vlerën 1,8 milion lekë për tu konsideruar), pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që procesi i inventarizimit rezulton i kryer, por nuk ka gjurmë/dokumente justifikuese mbi procesin e kryerjes së asgjësimit si dhe nuk ka regjistër kontabël të aktiveve në kundërshtim me UMF Nr.30, datë 27.11.2011”Për menaxhimin në sektorin publik” i ndryshuar.

Opinion mbi përputhshmërinë (i pamodifikuar/i pakualifikuar²)

Ne kemi audituar përputhshmërinë e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës (këtu e më poshtë AK), me kriteret e vlerësimit përfshirë kuadrin ligjor, rregullat dhe rregulloret që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, procedurat e prokurimit, zbatimin e kontratave,

¹ Referuar Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së, miratuar me Vendimin Nr. 246, datë 29.12.2022 “Për miratimin e manualit të auditimit financiar”, të Kryetarit të KLSH-së (2022, fq.54), Kapitulli VII pika 4.1. Një opinion me “Theksim Çështjeje”, jepet në rastet kur audituesi nuk është dakord ose është i pasigurt, për një ose më shumë çështje specifike, që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare por që nuk janë thelbësore për arsyetimin e pasqyrave.

² Referuar Manualit të Auditimit Përputhshmërisë të KLSH-së, miratuar me Vendimin Nr. 245, datë 29.12.2022 “Për miratimin e manualit të auditimit të përputhshmërisë”, të Kryetarit të KLSH-së (2022, fq.102), Kapitulli VII, pika 7.3.3 *Opinion i pamodifikuar, i pa kualifikuar: kur nuk janë gjetur apo konstatuar raste të mos përputhjeve material në një angazhim të sigurisë së arsyeshme, audituesi shpreh opinion të pamodifikuar ose të pakualifikuar që informacioni i përgatitur është në të gjitha aspektet material, në përputhje me kriteret e aplikueshme.*

veprimeve me bankën, etj. Në opinionin tonë, bazuar në punën e kryer të auditimit, në tërësi ka rezultuar se veprimtaria e AK-së është në përputhje, me të gjitha aspektet materiale, me legjislacionin për prokurimi publik, përveç një rasti i rezultuar me gabim material të mbartur në aktet e KVO dhe një rasti të mos konvertimit të monedhës së ofertës (në total 93,616 lekë me TVSH) e cila është nën vlerën e materialitetit të shënuara këto në paragrafin bazat për përgatitjen e **opinionit pamodifikuar/pakualifikuar** mbi përputhshmërinë.

Baza për opinionin e përputhshmërisë

Ne kemi kryer auditimin e përputhshmërisë në mbështetje me Ligjin Nr.154/2014, miratuar në datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në përputhje me ISSAI 4000 “Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë”, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së Nr. 245, datë 29.12.2022. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në INTOSAI P-10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 130- Kodi i Etikës. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipër përmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin Nr.56 , datë 30.04.2015, të Kryetarit të KLSH-së.

Ne besojmë se evidencat e auditimit janë të mjaftueshme dhe krijojnë bazën e arsyeshme për dhënien e opinionit **të pamodifikuar/pakualifikuar**.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin Nr.154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Programit të Auditimit Nr.506/1 Prot, datë 15.04.2024 i ndryshuar miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 15.04.2024 deri në datë 14.06.2024, në subjektin Autoritetin e Konkurrencës (këtu e më poshtë AK) u krye auditimi financiar dhe përputhshmërie për periudhën nga 01.01.2021 deri në 31.12.2023 nga grupi i auditimit me përbërje:

- | | |
|---------|-------------------|
| 1.MH, | përgjegjës grupi; |
| 2.AK, | auditues |
| 2. NM, | auditues |
| 3.MN, | auditues |
| 4.L LI, | auditues |

Auditimi u shtri mbi çështjet kryesore të veprimtarisë së institucionit në: zbatimin e kriterëve në planifikimin dhe realizimin e planit buxhetor mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave, organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit, vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur saktë dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse, rakordimi me pasqyrat e tjera financiare, zbatimi i dispozitave ligjore mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare, saktësia e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe arkës, marrëdhëniet e punës, auditimin e prokurimeve publike, vlerësimin e funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar, si dhe probleme të dala gjatë auditimit.

Në përfundim të punës audituese në terren, nga grupi i auditimit janë mbajtur aktkonstatimet si dhe është organizuar takimi përmbyllës në terren (AK) me datë 30.05.2024 me Sekretarin e Përgjithshëm në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, përfaqësues të strukturave drejtuese, si dhe grupit të auditimit. Takimi përmbyllës në terren është mbajtur sipas protokollit përkatës (Dokumenti standard 2/2) parashikuar në “Rregulloren e Procedurave të Auditimit”, miratuar me Vendimin Nr.07, datë 17.01.2024 të Kryetarit të KLSH e ndryshuar.

OBJEKTIVAT, FUSHË VEPRIMI DHE METODOLOGJIA

1.Objekti dhe qëllimi i auditimit.

Në objektivat dhe qëllimet e auditimit, synohet dhënia e opinionit financiar me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2021-2023, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të AK-së, referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi. Qëllimi i auditimit është vlerësimi nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.

Për auditimin e përputhshmërisë objektivi i auditimit synon në dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional dhe të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga AK të rregullave, ligjeve, politikave kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve gjatë veprimtarisë së tij.

Qëllimi i tij është përcaktimi i nivelit të zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi lidhur me aktivitetin e AK për periudhën në auditim.

Auditimi synon gjithashtu në përcaktimin nga ana e audituesve:

- auditimin e sistemeve financiare dhe transaksionet, duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret;
- nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik;
- dhënien e Opinionit dhe rekomandimeve për marrjen e masave për përmirësimin e veprimtarisë së AK-se.

2.Identifikimi i çështjes.

Projekt raporti mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë së veprimtarisë së AK Tiranë, për periudhën 01.01.2021 deri më 31.12.2023, ka identifikuar sipas kriterëve specifike të vlerësimit, shqyrtimin dhe vlerësimin e fushave në vijim:

- përputhshmëria me kriteret ligjore, lidhur me planifikimin dhe realizimin e planit buxhetor,
- përputhshmëria/rregullshmëria në mbajtjen e kontabilitetit,
- përputhshmëria me kriteret ligjore në auditimin mbi inventarizimin e pronës;
- përputhshmëria me kriteret ligjore në zbatimin e dispozitave ligjore mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.
- përputhshmëria me kriteret ligjore mbi realizimin e procedurave të prokurimit publik,
- vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me Ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar sipas komponentëve.

3.Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.

Strukturat drejtuese të AK, kanë për detyrë që të përgjigjen për garantimin e sistemeve të përshtatshme dhe efektive të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës. Ato janë përgjegjëse për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësi të caktuara në kuadrin ligjor dhe rregullator. Gjithashtu, strukturat drejtuese janë përgjegjëse për vënien në dispozicion të dokumenteve zyrtare, shpresore apo elektronike, si dhe informacionit të kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH-së.

4.Përgjegjësitë e audituesve.

Audituesit e KLSH kanë përgjegjësi në dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktiviteti i njësisë/AK dhe informacioni përputhen apo jo, në të gjitha aspektet materiale me kriteret e përcaktuara, i cili shprehet nëpërmjet dhënies së opinionit të auditimit, duke respektuar Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI), si dhe Kodin e Etikës me qëllim që të arrihet niveli i arsyeshëm i sigurisë për dhënien e këtij opinionit. Këto standarde kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike si dhe të planifikojë e kryejë auditimin, me qëllim që të arrijnë nivelin e sigurisë së kërkuar. Përgjegjësia jonë (Audituesit e KLSH-së) është

që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinion mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

-Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit;

-Nëse shpenzimet janë planifikuar mbi bazën e nevojave në nivel institucioni nëse janë realizuar në përputhje me planin e miratuar nga ministri i Financave;

-Nëse janë zbatuar dispozitat ligjore lidhur me planifikimin dhe realizimin e planit buxhetor, mbajtjen e kontabilitetit;

-Nëse janë zbatuar dispozitat ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare;

-Nëse janë identifikuar dhe raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të merren veprime korigjuese si dhe të identifikohen personat përgjegjës për veprimet e tyre etj.

5.Kriteret e vlerësimit.

Kriteret e vlerësimit të përdorura në këtë auditim e kanë burimin në legjislacionin përkatës që rregullon çështjet si drejtime të auditimit:

-Ligji Nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

-Ligji Nr.9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar;

-Ligji Nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar;

-Ligji Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe të gjitha aktet e dala në zbatim të tij (VKM, udhëzime APP-së etj.);

-Udhëzimi MF Nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar;

-Udhëzimi i Ministrisë së Financave Nr. 30, datë 27.12.2012 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar;

-Akte të tjera ligjore/nënligjore në zbatim të ligjeve të sipërcituar.

6.Standardet e auditimit.

Standardet e zbatuara nga grupi i auditimit gjatë kryerjes së angazhimit të auditimit:

-ISSAI 200 (Parime themelore të auditimit financiar);

-ISSAI 100 (Parime themelore të auditimit të sektorit publik), që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;

-Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) që zbatohen nga anëtarët e Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve/IFAC;

-Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH Nr.246, datë 29.12.2022;

-ISSAI 400 (Parime parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë), që përcakton parimet themelore të ISSAI 100 dhe i zhvillon më tej ato, duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;

-ISSAI 4000 “Prezantimi i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”;

-Manuali i Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve/ECA; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”; etj.;

-Praktikat më të mira të fushës.

7.Metodat e auditimit.

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit, në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testimeve të kryera me qëllim arritjen e objektivave të auditimit. Nisur nga veçoritë e subjektit të audituar, AK, funksion në zbatim të Ligjit Nr.9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar.

Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:

a. *Intervistimi* - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse;

b. *Raporte dhe informacione* - shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve relevante që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe drejtimit e auditimit;

c. *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm*- duke marrë informacionet e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar të subjektit;

d. *Verifikimi në sistem dhe në terren*- me përzgjedhje të çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;

e. *Të kombinuara*, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit në tërësi, dhe sipas drejtimeve në veçanti.

8. Dokumentimi i auditimit.

Audituesit e KLSH, mbi bazën e dokumentacionit (evidencave) të kërkuar/a dhe të vëna në dispozicion, intervistave, takimeve, konsultave dhe komunikimeve me nëpunësit e AK, kanë përgatitur dokumentacionin e mjaftueshëm të auditimit, si rezultat i kuptimit të qartë të kritereve të përdorura, të fushë-veprimit të auditimit; të gjykimeve, të përfundimeve të arritura mbi bazën e programit të auditimit, natyrën, kohën, shtrirjen dhe rezultatet e procedurave të kryera; arsyetimin pas të gjitha çështjeve të rëndësishme që kërkohet për ushtrimin e gjykitit profesional, si dhe konkluzioneve lidhur me to. Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, e-mail-ve, të finalizuar këto në akt konstatimet e mbajtura në subjekt dhe më pas me shqyrtimin e observacioneve të subjektit, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij Raporti.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.

Autoriteti i Konkurrencës është organ publik, i pavarur. Buxheti vjetor për financimin e veprimtarisë së Autoritetit, i cili përbën zë me vete në Buxhetin e Shtetit, miratohet nga Kuvendi i Shqipërisë. Të ardhurat që krijohen në zbatim të këtij ligji, përfshirë edhe të ardhurat nga gjobat, derdhen në Buxhetin e Shtetit dhe përdoren sipas akteve ligjore në fuqi. Autoriteti mban llogari të shpenzimeve dhe të të ardhurave faktike, në përputhje me legjislacionin shqiptar të kontabilitetit.

AK përbëhet nga Komisioni dhe nga Sekretariati. Komisioni i Konkurrencës është organi vendimmarrës kolegjial i përhershëm i Autoritetit dhe përbëhet nga pesë anëtarë ndërsa Sekretariati i cili zgjidhet nga Komisioni dhe drejtohet nga Sekretari i Përgjithshëm, harton dhe paraqet raportet e hetimit pranë Komisionit për vendimmarrje, monitoron dhe analizon kushtet e tregut për zhvillimin e konkurrencës së lirë dhe efektive, ndjek dhe kontrollon zbatimin e vendimeve të marra nga Komisioni etj.

Autoriteti, në ushtrimin e funksionit të tij, zbaton Kodin e Procedurave Administrative, përveç rasteve kur ligji për konkurrencën parashikon ndryshe.

Në ushtrimin e veprimtarisë së tij, Komisioni vendos gjoba, në masën jo më shumë se 1 për qind të xhiros totale të vitit paraardhës financiar, mbi ndërmarrjet ose grupimet e ndërmarrjeve nëse: japin të dhëna jo të sakta, jo të plota ose mashtruese ose nuk japin të dhëna brenda afatit kohor, të përcaktuar në vendimin e marrë. Kundër vendimeve të Komisionit për vendosjen e sanksioneve mund të bëhet ankim në Gjykatën e Tiranës brenda 30 ditëve nga marrja e vendimit. Organi i ngarkuar nga ligji i konkurrencës për ekzekutimin e gjobës është Policia Tatimore.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit:

Në zbatim të programit të auditimit Nr. 506/1, datë 15.04.2024, i ndryshuar miratuar nga Kryetari i KLSH-së, në Autoritetin e Konkurrencës u ushtrua auditim financiar dhe përputhshmërie për periudhën 01.01.2021-31.12.2023, sipas këtyre drejtimeve:

- 2.1 Hartimi dhe zbatimi i buxhetit të shtetit;
- 2.2 Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit;
- 2.3 Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe të pagave;
- 2.4 Zbatimin e dispozitave ligjore mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare;
- 2.5 Auditimi i prokurimeve publike;
- 2.6 Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar;
- 2.7 Të ndryshme të dala gjatë auditimit.

2.1. Hartimi dhe zbatimi i buxhetit të shtetit.

Në zbatim të pikës 2.1 të programit të auditimit Nr.506/1, datë 15.04.2024 u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- PBA 2021-2023, projektbuxheti viti 2021;
- PBA 2022-2024, projektbuxheti viti 2022;
- PBA 2023-2025, projektbuxheti viti 2023;
- Raportet e realizimit të buxhetit për vitet 2021,2022 dhe 2023.

Auditimi i këtij drejtimi u bazua në:

- Ligji Nr.9936, datë 26.06.2008 *“Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar
- Ligji Nr. 10296, datë 08.07.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”*, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 137/2020 *“Për buxhetin e vitit 2021”*;
- Ligji Nr. 115/2021, *“Për buxhetin e vitit 2022”*;
- Ligji Nr. 84/2022, *“Për buxhetin e vitit 2023”*;
- VKM Nr.190, datë 03.03.2021 *“Për miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2022 - 2024”*;
- VKM Nr. 440, datë 22.07.2021 *“Për miratimin e tavanëve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2022- 2024”*;
- VKM Nr.130, datë 02.03.2022 *“Për miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023 - 2025”*;
- VKM Nr.535, datë 29.07.2022 *“Për miratimin e tavanëve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2023- 2025”*;
- VKM Nr.195, datë 05.04.2023 *“Për miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026”*;
- VKM Nr. 436, datë 19.07.2023 *“Për miratimin e tavanëve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2024-2026”*;
- Udhëzimet Plotësuese si dhe çdo akt ligjor e nënligjor në funksion të zbatimit të buxhetit të shtetit për vitet 2021-2023.

Autoriteti i Konkurrencës e ushtron aktivitetin financiar në programin buxhetor *“Mbikëqyrja e Tregut dhe Garancia e Konkurrencës” (04120)*. AK është institucion publik i pavarur dhe i ushtron detyrat e tij në zbatim të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës. Buxheti vjetor për

financimin e veprimtarisë së Autoritetit, përbën zë me vete në Buxhetin e Shtetit dhe miratohet nga Kuvendi i Shqipërisë.

Nga auditimi për **vitin 2021**, mbi zbatimin e kritereve në planifikimin e buxhetit, realizimit të planit buxhetor:

PBA 2021-2023, projektbuxheti i vitit 2021;

Në zbatim të Ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe Udhëzimit Nr.7, datë 28.02.2018 të Ministrit të Financave “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, Autoriteti i Konkurrencës (AK) ka përgatitur kërkesat buxhetore në kuadër të Programit Buxhetor Afatmesëm.

Gjetja 1. Për vitin 2021, Titullari i institucionit nuk ka ngritur Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS) si dhe mungonte dokumentacioni i aktivitetit të tij për periudhën objekt auditimi. Grupi i Menaxhimit Strategjik luan një rol të rëndësishëm në drejtim të integritetit të informacionit financiar, sistemin e saj të kontrollit të brendshëm si dhe kujdeset për performancën e njësisë publike. GMS duhet të mblidhet të paktën katër herë në vit dhe vendimet e saj duhet të regjistrohen nga sekretari si dhe të vihen në dispozicion të drejtimit të njësisë publike. Mosveprimet e mësipërme vijnë në kundërshtim me Ligjin nr.10 296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 8, pika 8, germa “b” dhe neni 27, Manualin e MFK-së, pika 2.2.6, si dhe Udhëzimin nr.16, dt.20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”.

- Kërkesat buxhetore në kuadër të përgatitjes së PBA-së 2021-2023, nuk janë diskutuar/trajtuar në mbledhjet e Ekipit të Menaxhimit të Programit. Mosveprimet e anëtarëve të ekipit të menaxhimit të programit si përgjegjës për realizimin e detyrave teknike si dhe zbatimin e procedurave të përgatitjes së kërkesave buxhetore vijnë në kundërshtim me pikën 2.6 të Udhëzimit nr.7, datë 28.2.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”. Bazuar në pikën 2.5 të Udhëzimit përcaktohet se: “Nëpunësi i autorizuar në cilësinë e Drejtuesit të programit është përgjegjës për të garantuar që janë duke u realizuar siç duhet përgjegjësitë e ekipit të menaxhimit të programit, si një komponent kyç i organizimit institucional për përgatitjen e kërkesave buxhetore, si dhe ka përgjegjësinë për të marrë pjesë në takimet e Grupit për Menaxhimin Strategjik”.

Në zbatim të këtij detyrimit ligjor të pikën 2.5 të udhëzimit të lartpërmendur, Nëpunësi i autorizuar/Drejtuuesi i programit është përgjegjës për të garantuar që janë duke u realizuar siç duhet përgjegjësitë e ekipit të menaxhimit të programit, si një komponent kyç i organizimit institucional për përgatitjen e kërkesave buxhetore, si dhe ka përgjegjësinë për të marrë pjesë në takimet e Grupit për Menaxhimin Strategjik, duke marrë pjesë në çdo diskutim si dhe vendim-marrjet përkatëse që kanë ndikim mbi programin e tyre.

-Me shkresën Nr.287/1 prot, datë 05.8.2020, AK ka dërguar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, projektbuxhetin afatmesëm 2021-2023 dhe detajimin e projektbuxhetit të vitit 2021, (faza II-të). Kërkesat buxhetore janë detajuar në mbështetje të misionit të Autoritetit të Konkurrencës, në realizimin e qëllimit të politikës së programit, tavanëve të miratuara në VKM Nr.577/2020 “Për miratimin e tavanëve përfundimtare të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023” si dhe janë dërguar brenda afatit dhe sipas formatit të përcaktuar në Udhëzimin plotësues Nr.28, datë 10.07.2020 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023.”

Me shkresën Nr. 465/1 prot, datë 23.12.2020 është dërguar në MFE detajimi i planit të buxhetit për vitet 2021,2022 dhe 2023, pas miratimit të Ligjit Nr.137, datë 16.11.2020 “Për buxhetin e

vitit 2021”, për programin e vetëm buxhetor 04120 “Mbykqyrja e Tregut dhe Garancia e Konkurrencës”.

Me Ligjin Nr.137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021” i ndryshuar, është miratuar buxheti i shtetit për vitin 2021, pjesë e të cilit është edhe buxheti për grupin buxhetor “Autoriteti i Konkurrencës” në vlerën 72,240,000 lekë. Numri i punonjësve të AK-së është 46, sipas strukturës së miratuar me Vendimin Nr.27, datë 08.3.2021 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Autoriteti i Konkurrencës në vitin 2021, ka administruar dhe menaxhuar fondet buxhetore për programin e vetëm (04120) “Mbykqyrja e Tregut dhe Garancia e Konkurrencës”.

Ndryshimet buxhetore gjatë vitit 2021.

Buxheti i vitit 2021 i alokuar me Ligjin Nr.137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021” për Autoritetin e Konkurrencës në fillim të vitit 2021, ishte 72,240,000 lekë. Me ndryshimet e pësuara gjatë vitit si rezultat i shtesave, ky buxhet ka arritur në vlerën 78,273,000 lekë ose 6,033,000 lekë më shumë nga buxheti fillestar.

-AK me shkresën Nr.264 prot, datë 25.5.2021, lënda “Kërkesë për rialokim fondi brenda buxhetit 2021” ka kërkuar pakësim në artikullin 602, në vlerën 129,895 lekë dhe shtesë në artikullin 606 “Transferata tek individët” në vlerën 129,895 lekë. Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën Nr.9493/1 prot, datë 03.6.2021 dhe shkresë 9493/3 prot, datë 30.6.2021 ka miratuar rialokimin e fondeve për shpenzimet korrente.

- AK me shkresën Nr.285 prot, datë 07.6.2021, lënda “Kërkesë për një shtesë në fondin e pagave për vitin 2021” ka kërkuar shtesë në vlerën 4,8 milion lekë.

-Me shkresë Nr.11616/25 prot, datë 08.7.2021 Ministria e Financave ka dërguar detajimin e ndryshimeve të fondeve buxhetore për vitin 2021.

Në mënyrë të detajuar ndryshimet e buxhetit për vitin 2021 paraqiten në tabelë:

Tabela 1

Shtesa (Fondi i veçantë-llogaria 606)	+833,520,
<i>Fondi i pagave (llogaria 600)</i>	5,199,480
Efekti neto në buxhet (shtesa)	6,033,000

Burimi:AK

Tabela 2: Raporti i Shpenzimeve për 12 mujorin e vitit 2021

Programet		Shpenzimet e Ministrisë/Institucionit						
		(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)=(6)-(5)
Titulli	Emertimi	Fakti i vitit paraardhës Viti 2020	PBA Viti 2021	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2021	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2021	Buxheti Vjetor Plan i Periudhes/progresiv	Fakti i Periudhes/progresiv	Diferenca
04120	MBIKËQYERJA E TREGUT DHE ADVOKACIA E KONKURRENCES	71,130	72,240	72,240	78,273	78,273	71,957	-6,316

Burimi:AK

Realizimi faktik për vitin 2021 është 71,957,000 lekë, ose në masën 99% e total buxhetit të planifikuar.

Tabela 3: Shpenzimet buxhetore sipas klasifikimit ekonomik (në mijë lekë)

Emri i Grupit	AUTORITETI I KONKURRENCES						Kodi i Grupit	77
Programi	MBIKËQYERJA E TREGUT DHE ADVOKACIA E KONKURRENCES						Kodi i Programit	04120
Art.	Emertimi	(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)=(6)-(5)
		Fakti i vitit paraardhës Viti 2020	PBA Plan Viti 2021	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2021	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2021	Buxheti Vjetor Plani i Periudhes/progresiv	Fakti i Periudhes/progresiv	Diferenca
600	Paga	50,036	53,500	53,500	57,581	57,581	53,050	-4,531
601	Sigurime Shoqërore	7,876	9,500	9,500	9,500	9,500	8,580	-920
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	11,832	8,000	8,000	7,870	7,870	7,094	-776
603	Subvencione	0	0	0		0		0
606	FONDI Vecante	0	0	0		0		0
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	432	240	240	2,322	2,322	2,250	-72
Non-Totali	Shpenzime Korrente	70,176	71,240	71,240	77,273	77,273	70,974	-6,299
230	Kapitale të Patrupëzuara							0
231	Kapitale të Trupëzuara	3,412	1,000	1,000	1,000	1,000	983	-17
232	Transferta Kapitale							0
Non-Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	3,412	1,000	1,000	1,000	1,000	983	-17
230	Kapitale të Patrupëzuara							0
231	Kapitale të Trupëzuara		0					0
232	Transferta Kapitale							0
Non-Totali	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	0	0	0	0	0	0	0
Totali	Shpenzime Kapitale	3,412	1,000	1,000	1,000	1,000	983	-17
	Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti						0	
Totali (korrente + kapitale + Shp nga te ardh.jashte limiti)		73,588	72,240	72,240	78,273	78,273	71,957	-6,316

Burimi:AK

-Nga auditimi për vitin 2022, mbi zbatimin e kritereve në planifikimin e buxhetit, realizimit të planit buxhetor:

-PBA 2022-2024, projektbuxheti viti 2022;

Në zbatim të Ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Udhëzimit Nr.7, datë 28.02.2018 të Ministrit të Financave “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, Autoriteti i Konkurrencës (AK) ka përgatitur kërkesat buxhetore në kuadër të Programit Buxhetor Afatmesëm.

Me Urdhrin Nr.24/3 prot, datë 01.04.2022 të Sekretarit të Përgjithshëm të AK është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik GMS dhe Ekipi i Menaxhimit të Programit EMP, për programin bazë (04120) “Mbykqyrja e Tregut dhe Advokacia e Konkurrencës”. Konstatohet se, kërkesat buxhetore në kuadër të përgatitjes së PBA 2022-2024, nuk janë diskutuar/trajtuar në mbledhjet e Ekipit të Menaxhimit të Programit.

Me shkresën Nr.131/2 prot, datë 30.4.2021, Autoriteti i Konkurrencës ka përcjellë në Ministrinë e Financave projektbuxhetin afatmesëm 2022-2024 (faza I).

Tavanet përfundimtare të shpenzimeve buxhetore për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024 janë miratuar me VKM Nr. 440 datë 22.07.2021 “Për miratimin e taveveve përfundimtare të Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024”. Konstatohet se kërkesat buxhetore janë dërguar brenda afatit dhe në respektim të taveveve të miratuara me VKM Nr.119, datë 03.03.2021 "Për miratimin e taveveve përgatitore të shpenzimeve për PBA 2022-2024" në nivel programi.

Me shkresën Nr.366/1 prot, datë 01.9.2021, Autoriteti i Konkurrencës ka përcjellë në Ministrinë e Financave projektbuxhetin afatmesëm 2022-2024 dhe detajimin e projektbuxhetit të vitit 2022 (faza II-të). Kërkesat e Autoritetit të Konkurrencës në projektbuxhetin afatmesëm 2022-2024 (faza II-të), janë hartuar në programin bazë (04120) “Mbykqyrja e Tregut dhe advokacia e Konkurrencës”. Konstatohet se kërkesat buxhetore janë dërguar brenda afatit dhe në respektim të taveveve të miratuara me VKM Nr.440 datë 22.07.2021 "Për miratimin e taveveve përgatitore të shpenzimeve për PBA 2022-2024" në nivel programi.

Me Ligjin Nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, është miratuar buxheti i shtetit për vitin 2022, pjesë e të cilit është edhe buxheti për grupin buxhetor “Autoriteti i Konkurrencës” në

programin e vetëm (04120) “Mbyqyrja e tregut dhe advokacia e e konkurrencës”, me vlerë totale prej 71,000,000 lekë. Gjatë vitit 2022 AK ka funksionuar me strukturën organizative të miratuar me Vendimin Nr.27, datë 08.3.2021 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë me të njëjtin numër punonjësish.

Ndryshimet buxhetore në vitin 2022.

Buxheti i vitit 2022 i alokuar me Ligjin Nr.115/2021, datë 16.12.2021 “Për buxhetin e vitit 2022” për Autoritetin e Konkurrencës, në fillim të vitit 2022 ishte 71,000,000 lekë. Me ndryshimet e pësuara gjatë vitit si rezultat i shtesave por edhe pakësimeve përmes Aktit Normativ Nr.3, datë 12.03.2022. “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr.115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, ky buxhet ka arritur në vlerën 74,224,400 lekë, ose 3,224,400 lekë më shumë nga buxheti fillestar.

Dokumentaoni i vendosur në dispozicion mbi ndryshimet e buxhetit është si më poshtë:

-Shkresë Nr.641 prot, datë 02.11.2022 përmes së cilës, AK ka kërkuar shtesë në zërin “fond page” në shumën 3,000,000 lekë për përballimin e efekteve të ndryshimit të nivelit të pagave në zbatim të VKM-ve përkatëse.

-Shkresë Nr.2234/1 prot, datë 09.11.2022 “Dërgohet miratimi i fondeve buxhetore shtesë në buxhetin e vitit 2022, dërguar nga Ministria e Financave.

- Shkresë Nr.2235 prot, datë 05.12.2022 “Mbi detajimin e ndryshimeve sipas aktit normativ Nr.17, datë 01.12.2022, dërguar nga Ministria e Financave.

-Shkresë Nr.24043/4 prot, datë 30.12.2022 “Mbi detajimin e ndryshimeve sipas aktit normativ Nr.19, datë 30.12.2022, dërguar nga Ministria e Financave.

-VKM Nr.898, datë 29.12.2022 “Për mbështetje financiare të menjëhershme të punonjësve të njësive të qeverisjes së përgjithshme dhe institucioneve të arsimit të lartë publik për zbutjen e impaktit të krizës”.

Në mënyrë të detajuar ndryshimet e buxhetit gjatë vitit 2022 paraqiten në tabelën si më poshtë:

Tabela 4

Në lekë

Shtesa (Fondi i veçantë-llogaria 606)	+618,400,
<i>Shpenzime për ndihmë të menjëhershme, shpërblime, etj. (llog. 600)</i>	+3,910,000
<i>Fondi i sigurimeve shoqërore 601</i>	+1,100,000
Pakësime (Akti Normativ Nr. 3, dt. 12.03.2022)	-2,404,000
<i>Fondi i pagave (llogaria 600)</i>	-1,338,000
<i>Fondi i sigurimeve shoqërore (llogaria 601)</i>	-240,000
<i>Shpenzime operative (llogaria 602)</i>	-826,000
Efekt neto në buxhet (shtesa-pakësime)	3,224,400

Burimi:AK

Tabela 5: Raporti i Shpenzimeve për 12 mujorin e vitit 2022

PBA	Buxheti		SHTESA						PAKESIM	BUXHETI		Diferenca
	FILLESTAR	SIGURIME	KOMP PAGE, MIN FIN	PAGA	F VECANTE	PAGAT VKM	NDIHME FINANCIARE VKM	TOTAL	A NORMATIV			
		SHKURT	SHKURT	GUSHT	TETOR	DHJETOR	DHJETOR	SHTESA	MARS	PERFUNDIMTAR	FAKTIK	
72,600,000	71,000,000	1,100,000	368,400	500,000	250,000	3,000,000	410,000	5,628,400	2,404,000	74,224,400	71,801,000	2,423,400

Burimi:AK

Realizimi faktik për vitin 2022 është në vlerën 71,801,000 lekë ose në masën 96% e total buxhetit të planifikuar. Realizimi i treguesve kryesorë të buxhetit, pasqyrohet në tabelën si më poshtë:

Tabela 6 :Shpenzimet buxhetore të vitit 2022 sipas klasifikimit ekonomik (në mijë lekë)

		12 Mujori i Vitit 2022					ne 000/leke	
Emri i Grupit	AUTORITETI I KONKURRENCES MBIKQYRJA E TREGUT DHE ADVOKACIA E KONKURRENCES						Kodi i Grupit	77
Programi							Kodi i Programit	04120
Art.	Emertimi	(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)=(6)-(5)
		Fakti	PBA	Buxheti Vjetor	Buxheti Vjetor	Buxheti Vjetor	Fakti	Diferenca
		i vitit paraardhes Viti 2021	Plan Viti 2022	Plan Fillestar Viti 2022	Plan i Rishikuar Viti 2022	Plani i Periudhes/progressiv	i Periudhes/progressiv	
600	Paga	53,050	53,500	53,500	55,162	55,162	53,888	-1,274
601	Sigurime Shoqërore	8,580	9,600	9,600	9,360	9,360	8,743	-617
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	7,094	8,260	8,260	7,264	7,264	7,002	-262
603	Subvencione		0	0		0		0
606	FONDI Vecante		0				0	0
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	2,250	240	240	1,438	1,438	1,169	-269
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	70,974	71,600	71,600	73,224	73,224	70,802	-2,422
230	Kapitale të Patrupëzuara							0
231	Kapitale të Trupëzuara	983	1,000	1,000	1,000	1,000	1,000	0
232	Transferata Kapitale							0
Nen-Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	983	1,000	1,000	1,000	1,000	1,000	0
230	Kapitale të Patrupëzuara							0
231	Kapitale të Trupëzuara		0					0
232	Transferata Kapitale							0
Nen-Totali	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	0	0	0	0	0	0	0
Totali	Shpenzime Kapitale	983	1,000	1,000	1,000	1,000	1,000	0
Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti							0	
Totali (korrente + kapitale + Shp nga te ardh.jashte limiti)		71,957	72,600	72,600	74,224	74,224	71,802	-2,422

Burimi:AK

Nga Buxheti i vitit 2022, vetëm vlera prej 2,423,400 lekë ka mbetur pa u shfrytëzuar e cila përbëhet nga:

- Mbetjet në fondin e sigurimeve shoqërore në vlerën 617,261 lekë;
- Mbetjet në fondet për shpenzimet (602) në vlerën 262,209 lekë;
- Mbetjet në fondet për shpenzimet (606) në vlerën 270,009 lekë;
- Mbetjet në fondet për shpenzimet (231) në vlerën 400 lekë.

-Nga auditimi për vitin 2023, mbi zbatimin e kriterëve në planifikimin e buxhetit, realizimit të planit buxhetor:

-PBA 2023-2025, projektbuxheti viti 2023;

Në zbatim të Ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” dhe Udhëzimin e MFE Nr.8, datë 26.02.2021 “Për përgatitjen e PBA 2023-2025”, Autoriteti i Konkurrencës (AK) ka përgatitur kërkesat buxhetore në kuadër të Programit Buxhetor Afatmesëm.

Me Urdhrin Nr.170/1, datë 13.3.2023 të Sekretarit të përgjithshëm të AK është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik GMS dhe Ekipi i Menaxhimit të Programit EMP për programin bazë (04120) “Mbykqyrja e Tregut dhe Advokacia e Konkurrencës”. Konstatohet se, kërkesat buxhetore në kuadër të përgatitjes së PBA 2023-2025, nuk janë diskutuar/trajtuar në mbledhjet e Ekipit të Menaxhimit të Programit.

Me shkresën Nr.166/2, datë 24.05.2022, Autoriteti i Konkurrencës ka përcjellë në Ministrinë e Financave projektbuxhetin afatmesëm 2023-2025 (faza I) dhe me shkresën Nr.495, datë, 31.08.2022, ka përcjellë projektbuxhetin afatmesëm 2023-2025 dhe detajimin e projektbuxhetit të vitit 2023, (faza II-të), në programin bazë (04120) “Mbikqyrja e Tregut dhe Advokacia e Konkurrencës”. Kërkesat buxhetore janë dorëzuar brenda afatit të përcaktuar në Udhëzimin plotësues Nr.22, datë 08.07.2022 “Për përgatitjen e PBA 2023-2025”, si dhe janë të shoqëruara

me relacion shpjegues sipas pikës 8(g) kap.1, i Udhëzimit Nr.7/2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”.

Me shkresën Nr.7 prot, datë, 05.11.2023, është dërguar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, detajimin e buxhetit për vitet 2023-2025, pas miratimit të Ligjit Nr.84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”. Me Ligjin Nr.84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, është miratuar buxheti i Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2023, në vlerën 80,540,000 lekë.

Numri i punonjësve të AK-së është 49, sipas strukturës së miratuar me Vendimin Nr.42, datë 08.6.2023 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Ndryshimet buxhetore në vitin 2023.

Buxheti i vitit 2023 i alokuar me Ligjin Nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, për Autoritetin e Konkurrencës në fillim të vitit 2023, ishte në vlerën 83,540,000 lekë. Me ndryshimet e pësuara gjatë vitit ky buxhet është në vlerën 99,861,270 lekë ose 16,321,270 lekë më shumë nga buxheti fillestar.

Nga subjekti është vendosur në dispozicion dokumentacioni si më poshtë:

-Shkresë Nr.2737 prot, datë 09.2.2023 nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë mbi miratimin e detajimit të fondit të veçantë për vitin 2023.

-Shkresë Nr.372 prot, datë 05.7.2023, lënda “Kërkesë për shtesë fondi për vitin 2023”, me anë të së cilës AK ka kërkuar shtesë në zërin “Fond page” (llog 600) në vlerën 18.400.000 lekë dhe në zërin “Kontribute për sigurime shoqërore” (llog 601) në vlerën 2,300,000 lekë.

-Shkresë Nr.12727 prot, datë 01.7.2023 nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë mbi miratimin e akordimit të fondeve shtesë për përballimin e efekteve financiare të rritjes së pagave.

- Shkresë Nr.583 prot, datë 27.9.2022, lënda “Dërgohen kërkesat buxhetore në vijim të takimit mbi PBA 2023-2025”.

Në mënyrë të detajuar ndryshimet e buxhetit për vitin 2023 paraqiten në tabelë:

Tabela 7

Në lekë

Shtesa (Fondi i veçantë-llogaria 606)	+250,000,
<i>Shpenzime për shpërblime, etj. (llog. 600)</i>	+2,371.270
<i>Fondi i sigurimeve shoqërore 601</i>	+2,300,000
<i>Fondi i pagave (llogaria 600)</i>	+18,400,000
Pakësime të fondeve të lira (llog 600 /601)	-7,000.000
Efekti neto në buxhet (shtesa-pakësime)	16,321,270

Tabela 8. Raporti i Shpenzimeve për 12 mujorin e vitit 2023

PBA	Buxheti FILLESTAR	SHTESA					PAKESIM PAGA SIG DHJETOR	BUXHETI PERFUNDIMTAR	BUXHETI FAKTIK	Diferenca
		PAGAT VKM KORRIK	AUTOMJET SHKURT	F VECANTE SHKURT	SHPERBLIME BE DHJETOR	TOTAL SHTESA				
83,540,000	83,540,000	20,700,000	3,000,000	250,000	2,371,270	26,321,270	7,000,000	99,861,270	98,050,386	1,810,884

Realizimi faktik për vitin 2023 është 98,050,386 lekë, ose në masën 98% e total buxhetit të planifikuar.

Tabela 9. Shpenzimet buxhetore të vitit 2023 sipas klasifikimit ekonomik (në mijë lekë)

Emri i Grupit	AUTORITETI I KONKURRENCES MBIKQYRJA E TREGUT DHE ADVOKACIA E KONKURRENCES						Kodi i Grupit	77
Programi							Kodi i Programit	04120
Art.	Emertimi	(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)=(6)-(5)
		Fakti	PBA	Buxheti Vjetor	Buxheti Vjetor	Buxheti Vjetor	Fakti	Diferenca
		i vitit paraardhes Viti 2022	Plan Viti 2023	Plan Fillestar Viti 2023	Plan i Rishikuar Viti 2023	Plani i Periudhes/progressiv	i Periudhes/progressiv	
600	Paga	53,888	57,350	57,200	72,371	72,371	72,002	-369
601	Sigurime Shoqërore	8,743	10,290	10,440	11,340	11,340	11,195	-145
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	7,002	10,660	10,660	10,410	10,410	9,812	-598
603	Subvencione		0	0		0		0
606	FONDI Vecante		0				0	0
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	1,169	240	240	740	740	522	-218
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	70,802	78,540	78,540	94,861	94,861	93,531	-1,330
230	Kapitale të Patrupëzuara							0
231	Kapitale të Trupëzuara	1,000	2,000	2,000	5,000	5,000	4,519	-481
232	Transferta Kapitale							0
Nen-Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	1,000	2,000	2,000	5,000	5,000	4,519	-481
230	Kapitale të Patrupëzuara							0
231	Kapitale të Trupëzuara		0					0
232	Transferta Kapitale							0
Nen-Totali	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	0	0	0	0	0	0	0
Totali	Shpenzime Kapitale	1,000	2,000	2,000	5,000	5,000	4,519	-481
	Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti						0	
	Totali (korrente + kapitale + Shp nga te ardh.jashte limiti)	71,802	80,540	80,540	99,861	99,861	98,050	-1,811

Raportet e Monitorimit

Referuar pikës 266 të Udhëzimit Nr. 9, dt.20.7.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit përcaktohet se: “Çështjet kryesore dhe mangësitë serioze në lidhje me procesin e zbatimit të buxhetit, nivelin e performancës gjatë realizimit të objektivave dhe trajtimin e risqeve të lidhura me to, të evidentuara gjatë takimeve periodike midis manaxherëve dhe raporteve të monitorimit, parashtrihen nga Nëpunësi Autorizues në mbledhjet periodike të Grupit për Menaxhimin Strategjik të kryesuar nga Titullari i njësisë së qeverisjes së përgjithshme, me qëllim diskutimin e mëtejshëm dhe miratimin e masave konkrete për përmirësimin e procesit dhe minimizimin e risqeve (duke përcaktuar dhe drejtuesin përgjegjës për menaxhimin e tyre).

-Raportet e monitorimit duhet të përfshijnë informacion mbi arritjet në terma sasiorë dhe vlerore të produkteve të realizuara, të identifikojnë mosarritjet dhe të shpjegojnë shkaqet e tyre duke propozuar në të njëjtën kohë masa për përmirësimin e situatës.

Për periudhën 2021-2023, u vunë në dispozicion të auditimit raportet e monitorimit si më poshtë:

-Raport monitorimi për 12 mujorin e vitit 2021, dërguar në MFE me shkresën Nr.266, datë 14.04.2022 dhe Raport monitorimi për 4 mujorin e parë 2021, dërguar në MFE me shkresën Nr.99/1, datë 28.05.2021;

-Raport monitorimi për 12 mujorin e vitit 2023, dërguar në MFE me shkresën Nr.180, datë 16.02.2024 dhe Raport monitorimi për 4 mujorin e parë 2022, dërguar në MFE, me shkresën Nr.391 prot, datë 02.6.2022;

-Raport monitorimi për 4 mujorin II- 2022, dërguar në MFE, me shkresën Nr.520 prot, datë 29.9.2022.

Tabela 10. Raportet e Monitorimit

Raporti i monitorimit	4-mujor	8-mujor	12-mujor
2021	✓	-	✓
2022	✓	✓	-
2023	-	-	✓

Gjetje 2. AK nuk ka dorëzuar të gjitha raportet e monitorimit për periudhën objekt auditimi 2021-2023 pranë MFE sipas përcaktimeve ligjore, duke mos dhënë informacion të plotë mbi situatën reale buxhetore ndaj MFE-së.

-Për vitin 2021, nuk është përgatitur dhe dorëzuar raporti 8-mujor, për vitin 2022, nuk është përgatitur dhe dorëzuar raporti 12-mujor dhe për vitin 2023, nuk është dorëzuar raporti 4-mujor dhe raporti 8 mujor. Mosveprimet e mësipërme vijnë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, i ndryshuar, neni 65 “Monitorimi” ku citohet “Nëpunësit autorizues të njësisve të qeverisjes qendrore i paraqesin, sa herë që kërkohet, por jo më pak se tri herë në vit, nëpunësit të parë autorizues raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit për performancën financiare, produktet dhe objektivat e politikës, të realizuar për çdo program të përcaktuar në vitin e parë të dokumentit përfundimtar të programit buxhetor afatmesëm.” dhe në kundërshtim me Udhëzimin nr.22, datë 17.11.20216 “Për procedurat standarte të Monitorimit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore”, kreu II dhe kreu III, pika 3.2, i ndryshuar me Udhëzimin nr.14, datë 30.05.2023 “Për procedurat standarte të Monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore”, ku citohet “Raportet e 4-mujorit dhe 8-mujorit duhet të dorëzohen pranë MFE deri me 30 Maj dhe me 30 Shtator, ndërsa raporti 12-mujor duhet të dorëzohet deri në fund të muajit shkurt të vitit pasardhës”.

-Në përmbajtjen e raporteve të monitorimit, subjekti ka përshkruar/pasqyruar veprimtarinë e institucionit si dhe të dhëna në terma sasiorë por nuk është kryer një analizë mbi ndryshimet e zërave buxhetore për periudhën raportuese, mosarritjet dhe shkaqet e tyre duke propozuar në të njëjtën kohë masa për përmirësimin e situatës apo mangësitë në lidhje me procesin e zbatimit të buxhetit, mosveprime jo në përputhje me përcaktimet e pikës 267 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.7.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar.

Të ardhurat e realizuara nga Autoriteti i Konkurrencës për periudhën 2021-2023.

Në bazë Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” neni 73 dhe 74, Komisioni i Konkurrencës si organ vendimmarrës i Autoritetit, vendos gjoba për kundërvajtjet administrative sipas parashikimeve në këtë ligj. Të ardhurat e krijuara nga gjobat, derdhen në Buxhetin e Shtetit dhe përdoren sipas akteve ligjore në fuqi.

Për periudhën objekt auditimi të ardhurat e realizuara nga AK janë si më poshtë:

- Të ardhurat e realizuara nga përqendrimet (njoftim dhe autorizim përqendrimi) deri më 31 dhjetor 2021 janë në shumën 16,658,922 lekë.
- Gjatë vitit 2022, në buxhetin e shtetit është derdhur si e ardhur nga përqendrimet (njoftime dhe autorizime përqendrimi) shuma prej 30,581,149 lekë. Të ardhurat e arkëtuara në buxhetin e shtetit nga vjelja e gjobave deri më 31 dhjetor 2022 është në shumën 26,324,857 lekë. Në raportin vjetor të veprimtarisë së AK-së, të ardhurat nga përqendrimet janë pasqyruar në shumën 26,110,008 lekë. Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, rezultoi se vlera e psqyruar në raport ishte hedhur gabim, pasi vlera e saktë e arkëtuar në Degën e Thesarit është në shumën 30,581,149 lekë.
- Të ardhurat e realizuara nga përqendrimet (njoftim dhe autorizim përqendrimi) deri më 31 dhjetor 2023 janë në shumën 30,738,335.33 lekë. Të ardhurat e arkëtuara në buxhetin e shtetit nga vjelja e gjobave deri më 31 dhjetor 2023 në shumën 15,526,524 lekë.

Në formë tabele të dhënat e mësipërme paraqiten si më poshtë:

Të ardhurat e realizuara nga AK

Në lekë

Viti	Nga procedurat e përqendrimeve	Nga gjobat
2021	16,658,922	-
2022	26,110,008	26,324,857
2023	30,738,335	15,526,524

Konkluzion: Nga auditimi i dokumenteve në lidhje me zbatimin e kriteve në planifikimin e buxhetit, nga strukturat përgjegjëse të Autoritetit të Konkurrencës, rezulton se;

☞ janë kryer veprime në respektim të procedurave dhe në përputhje me përcaktimet ligjore për periudhën objekt auditimi;

☒përgatitja e programit buxhetor është në përputhje me afatet, formatet e kërkuara dhe tavanet e miratura për vitet 2021-2023;

☒për vitin 2021, nga AK nuk administrohet urdhëri i titullarit për ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) si dhe dokumentacioni i aktivitetit të tij, jo në përputhje me Ligjin Nr.10 296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 8, pika 8, germa “b” dhe nenin 27, si dhe Manualin e MFK-së, pika 2.2.6;

☒mungon gjurma e auditimit (procesverbale të mbledhjeve) për aktivitetin e GMS/EMP lidhur me diskutimin/trajtimin e kërkesave buxhetore në kuadër të përgatitjes së PBA-ve si dhe të ushtrimit të përgjegjësisë në kuadër të monitorimit të zbatimit të buxhetit, jo në përputhje me Udhëzimin Nr.7, datë 28.2.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimin Nr.14, datë 30.05.2023 “Për procedurat standarde të Monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qëndrore;

☒mbi zbatimin e procedurave dhe afateve për monitorimin dhe zbatimin e buxhetit për performancën financiare mbi realizimin e programit buxhetor, nuk janë dorëzuar të gjitha raportet e monitorimit për periudhën objekt auditimi 2021-2023, jo në përputhje me përcaktimet e Ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, i ndryshuar, neni 65 dhe Udhëzimit Nr.22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të Monitorimit në Njësitë e Qeverisjes Qëndrore”, kreu II dhe kreu III, pika 3.2, i ndryshuar;

☒në raportet e monitorimit, nuk është kryer një analizë mbi ndryshimet e zërave buxhetore për periudhën raportuese, mosarritjet dhe shkaqet e tyre duke propozuar në të njëjtën kohë masa për përmirësimin e situatës apo mangësitë në lidhje me procesin e zbatimit të buxhetit, jo në përputhje me përcaktimet e pikës 267 të Udhëzimit Nr.9, dt.20.7.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, por pasqyrohet vetëm veprimtaria e institucionit si dhe jepen të dhëna në terma sasiorë.

2.2. Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit.

Në zbatim të pikës 2.2 të Programit të auditimit Nr. 506/1 prot., datë 15.04.2024, i ndryshuar, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

-Pasqyrat Financiare viti 2021, 2022, 2023;

-Aktrakordimi i të ardhurave për periudhën objekt auditimit;

-Situacioni shpenzimeve;

-Inventarët;

-Dokumentacion justifikues mbështetës (Urdhër Shpenzime, Fletë Hyrje/Dalje, Kartela inventari, etj rast pas rasti)

Auditimi u krye në zbatim të Udhëzimit të MFE Nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar me Udhëzimin Nr.5 datë 21.02.2022 si dhe UMF Nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe të njësisive që varen prej tyre”, ndryshuar me UMF Nr. 26, dt. 27.12.2007.

Nga auditimi mbi llogaritë vjetore të institucionit rezultoi se:

Për vitet objekt auditimi, organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit është strukturuar brenda Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Buxhetit.

Nga auditimi rezultoi:

☒Për vitet 2021-2023 mbajtja e kontabilitetit dhe mbyllja e llogarive vjetore në Autoritetin e Konkurrencës është bërë në përputhje me Udhëzimin e MFE Nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e

qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar me Udhëzimin Nr.5 datë 21.02.2022, si dhe UMF Nr. 14, datë 28.12.2006, “*Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe të njësisve që varen prej tyre*”, ndryshuar me UMF Nr. 26, dt. 27.12.2007 “*Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të institucioneve qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe njësisve të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorët e huaj*”. Dokumentat justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike, janë plotësuar konform dispozitave ligjore në fuqi. Bilanci ka të plotësuar aktiv-pasivin pasqyrat dhe anekset përkatëse me informacione.

☞ Pasqyrat financiare për të tre vitet nuk janë nënshkruar nga Nëpunësi Zbatues, por nga hartuesi i tyre (specialisti pranë Drejtorisë së Financës) duke operuar kështu jo në përputhje me Ligjin Nr.10296 datë 08.07.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*” i ndryshuar pikat 2 gërma b dhe pika 3 gërma “ë”.

☞ Llogaria 4342 “*Të tjera operacione me shtetin (debitor)*” e cila për vitin 2023 pasqyrohet në vlerën 9,308,085 lekë rezulton e nënvlerësuar për diferencën prej 120,003 lekë dhe e mos kuadruar me Llogarinë 7206 “*Financim i pritshëm nga buxheti*” në Pasiv të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar, në moszbatim të Ligjit 10296 datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, i ndryshuar neni 6, neni 10 dhe 11, Udhëzimit Nr.8 datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” i ndryshuar pika 32.

☞ Për të tre vitet objekt auditimi rezultojë i njëjti fenomen, i mos kuadrimin të llogarisë 4342 “*Të tjera operacione me shtetin (debitor)*” me Llogarinë 7206 “*Financim i pritshëm nga buxheti*” në Pasiv të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar, në moszbatim të Ligjit 10296 datë 08.07.2010 i ndryshuar dhe Udhëzimit Nr.8 datë 09.03.2018 i ndryshuar.

☞ Mbi hartimin e regjistrit të aktiveve nuk ka gjetur zbatim Udhëzimi Nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, kapitulli III “*Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre*”, paragrafi 26, 27 dhe 30.

Nga auditimi mbi procesin e inventarizimit (për v.2023) rezultuan mangësi dhe parregullsi si më poshtë:

Nga ana e Komisionit të inventarizimit:

☞ Raporti për inventarizimin fizik të aktiveve nuk është hartuar në mënyrë të plotë jo në përputhje me UMF Nr.30 datë 27.12.2011 i ndryshuar, pika Nr.85

☞ Nuk është hartuar proces verbali i vlerësimit, në të cilin argumentohen arsyet për vlerësimin e secilit prej tyre, pas verifikimit faktik të të gjitha aktiveve, në moszbatim të pikës Nr.104-105 të UMF Nr.30 datë 27.12.2011 i ndryshuar si dhe relacioni i vlerësimit, i cili përmban procedurën e ndjekur për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, arsyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës, në moszbatim të pikës Nr.106 të UMF Nr.30 datë 27.12.2011 i ndryshuar.

Nga ana e Komisionit për Asgjësimin e materialeve të nxjerra jashtë përdorimit:

☞ nuk është hartuar procesverbali për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve, ku përshkruhet procedura e ndjekur për nxjerrjen jashtë përdorimit (duke ndryshuar formën e tyre fillestare, propozur ose djegur), në moszbatim të pikës Nr.110 të UMF Nr.30 datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar.

Nga ana e Nëpunësit Autorizues:

☞ Mungon gjurma dokumentare sipas së cilës, ka vijuar me ndjekjen dhe monitorimin e realizimit të procesit të nxjerrjes jashtë përdorimit, në moszbatim të UMF Nr.30 datë datë 27.12.2011 e ndryshuar, pika 96 e tij, sipas së cilës “*...Nëpunësi autorizues ngarkohet me ndjekjen dhe monitorimin e realizimit të procesit të nxjerrjes jashtë përdorimit*”.

☒ Procedurat e inventarizimit rezultoi pjesërisht e finalizuar, nuk janë ndjekur plotësisht proceset e vlerësimit të daljes jashtë përdorimit, si dhe asgjësimit për aktivet që nuk kanë destinacion tjetër, veprime këto në kundërshtim me UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 paragrafi Nr. 84.

☒ Nga komisionet e ngarkuara me inventarizimin e aktiveve për vitin 2021-2023 nuk janë hartuar raporte për inventarizimin e aktiveve gjendje në magazinë, (janë përpiluar kartela për aktivet gjendje në magazinë, *egziston informacioni me aktivet gjendje*), si dhe mungon një raport analize, me të dhënat sipas viteve të krijimit të aktivitetit, apo mallrave e materialeve në moszbatim me të UMF Nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar, paragrafi 85/ c,

☒ Komisionet e inventarizimit të vlerave aktive dhe detyrimeve të AK-së nuk kanë mbajtur një procesverbal me përgjegjësin e materialeve për të fiksuar numrin rendor të fletëhyrjes dhe fletëdaljes së fundit, në kundërshtim me Udhëzimin Nr. 30 datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, neni 83.

☒ Komisioni i inventarizimit të vlerave aktive dhe detyrimeve të AK-së nuk kanë përpiluar një relacion në lidhje me inventarizimin fizik të aktiveve për kushtet fizike të ruajtjes së tyre në moszbatim të Udhëzimit Nr. 30 datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, nenin 73

☒ Për v.2022 dhe v.2023 janë parashikuar dhe nxjerrë nga përdorimi aktive me vlerë totale 3,196,058 lekë (respektivisht v.2022 propozuar 9 artikuj me vlerë 490,232 lekë, v.2023 propozuar 27 artikuj me vlerë 2,705,826 lekë). Procesi i nxjerrjes nga përdorimi dhe asgjësimit të aktiveve të propozuara, është bërë në kundërshtim me UMF Nr. 30 datë 27.12.2011, i ndryshuar pika 109, pasi rezultojë mungesë e gjurmës së kryerjes së këtij procesi.

☒ Ngritja e komisionit të vlerësimit për v.2023 është kryer jo në përputhje me UMF 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pika 99.

Pasqyrat financiare viti 2023.

Rregullshmëria e përgatitjes, dorëzimi dhe aprovimi i pasqyrave financiare vjetore.

Plotësimi i pasqyrave financiare, sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financës: janë përfunduar dhe dërguar pasqyrat financiare vjetore në Degën e Thesarit me shkresën Nr.273 prot, datë 28.03.2024 konfirmuar nga dega e thesarit (Nr.prot 1300/194 prot., datë 28.03.2024).

Pasqyrat Financiare të vitit 2023 janë përgatitur dhe dorëzuar në afatin e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë së Financave.

Llogaria vjetore e këtij viti përmban: Pasqyrën e Pozicionit Financiar (aktivi dhe pasiviteti të bilancit kontabël); Pasqyrën e Performancës Financiare (shpenzimeve dhe të ardhurave të ushtrimit); Pasqyrën e Fluksit të mjeteve monetare; Pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto; Pyetëtorin dhe shënimet shpjeguese formati Nr.5; Pasqyrën financiare të investimeve dhe burimeve të financimit formati Nr.6; Pasqyra Gjendja dhe ndryshimet në Aktivet Afatgjata (kosto historike) formati Nr. 7/a; Pasqyra Gjendja dhe ndryshimet në Aktivet Afatgjata (vlera neto) formati Nr. 7/b; Pasqyra e numrit të punonjësve formati Nr.8.

Gjetje 1. Pasqyrat financiare për të tre vitet nuk janë nënshkruar nga Nëpunësi Zbatues, por nga hartuesi i tyre (specialist pranë Drejtorisë së Financës) duke operuar kështu jo në përputhje me Ligjin Nr.10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar Neni 4, pika 24 i cili specifikon se “Nëpunës zbatues” është një nëpunës i nivelit të lartë menaxhues të njësisë, i cili është përgjegjës për zbatimin e rregullave që lidhen me menaxhimin financiar, kontabilitetin dhe përgatitjen e pasqyrave financiare të njësisë, si dhe përgjigjet para nëpunësit autorizues të njësisë”, si dhe neni 12, pikat 2, gërma “b” dhe pika 3, gërma “ë”. Referuar Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, pika 2.2.8 specifikohet se “... NZ i njësisë publike është përgjegjës dhe i raporton NA të njësisë publike për garantimin e cilësisë

së: b) raportimit periodik për vendimmarrjen, në funksion të realizimit të objektivave, si dhe të pasqyrave financiare vjetore të njësisë publike, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe rregullat e miratuara nga Ministri i Financave”.

Nga verifikimi i pasqyrave financiare të vitit 2023 rezultoi:

Paraqitja dhe raportimi i tyre është kryer në përputhje me Udhëzimin e MFE Nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Kapitulli V “Procedurat e paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore”.

1. Pasqyra e pozicionit financiar (F1)

Aktivitet dhe Pasivitet rezultojnë të barabarta në vlerën = 29,726,520 lekë.

I. Aktivitet Afatshkurtra

Aktivitet afatshkurtra më datë 31.12.2023 paraqiten në vlerën 10,231,514 lekë dhe përbëhen nga:

Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, në shumën 923,429 lekë;

Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme”, në shumën 9,308,085 lekë.

Llogaritë e klasës “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhen nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2023	Viti 2022	Diferenca 2023-2022
31	Materiale	600,829	319,497	281,332
32	Inventar i imët	322,600	442,600	(120,000)
	Totali	923,429	762,097	161,332

Sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Autoriteti Konkurrencës në 31.12.2023 llogaritë e klasës 3 “Gjendje Inventari Qarkullues” paraqiten në shumën 923,429 lekë dhe përbehet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 600,829 lekë dhe nga llogaria kontabël 32 “Objekte inventari” në vlerën 322,600 lekë.

Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)”, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 9,308,085 lekë dhe është kundërpartit e shumës së llogarive të mëposhtme:

Emërtimi i llogarive	Vlera
Llogari 401-408	2,257,302
Detyrime ndaj personelit llog 42	4,430,622
Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa llog. 431	658,275
Sigurime shoqërore llog.435	1,655,479
Sigurime shëndetësore llog.436	186,404
Totali	9,188,082

Gjetje 2. Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)” e cila për vitin 2023 pasqyrohet në vlerën 9,308,085 lekë rezulton e nënvlerësuar për diferencën prej 120,003 lekë dhe e mos kuadruar me Llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” në Pasiv të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar, në moszbatim të Udhëzimit Nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar pika 3, ku për nga rëndësia është nivel i mesëm.

II. Aktivet Afatgjata AKTIVET AFATGJATA MATERIALE (AAM)

Llogaritë e Klasës 21 “Aktivet Afatgjata Materiale”, AAM sipas të dhënave të pasqyruara për vitin ushtrimor 2023, vlera kontabël neto paraqitet në shumën 19,495,006 lekë. Në vitin paraardhës 2022, vlera kontabël neto e AAM-ve paraqitet në shumën 17,259,012 lekë, me një shtim të AAM-ve në shumën 1,412,500 lekë.

Nr. Ref. Llog.	Teprica në fillim			Shtesat gjate vitit		Pakësimet gjate vitit		Teprica ne Fund		
	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto	Kosto Historike	Amortizimi	Kosto Historike	Amortizimi	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto
			3	4	5	6	7	8	9	10
II	50,016,592	32,757,580	17,259,012	4,519,160	2,098,591	2,607,625	2,423,050	51,928,127	32,433,121	19,495,006
212	14,658,732	5,190,900	9,467,832	3,500,000	498,307			14,658,732	5,664,292	8,994,440
215	4,801,679	3,374,563	1,427,116	1,019,160	358,279			8,301,679	3,659,986	4,641,693
218	30,556,181	24,192,117	6,364,064	4,519,160	2,098,591	2,607,625	2,423,050	28,967,716	23,108,843	5,858,873

Referuar formatit 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbylljen e vitit ushtrimor 2023 në shumën 51,928,127 lekë dhe në fund të vitit ushtrimor 2022 në shumën 50,016,592 lekë.

Referuar formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” paraqiten në mbylljen e vitit ushtrimor 2023 në shumën 19,495,006 lekë dhe në fund të vitit ushtrimor 2022 në shumën 51,928,127 lekë.

Llogaritë do të analizohen si më poshtë:

Llogaria 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione”, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën neto 8,994,440 lekë dhe në fund të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën prej 14,658,732 lekë.

Analitiku i llogarisë 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione” përbëhet nga Ndërtesa e Autoritetit të Konkurrencës (kati i IV) me kosto historike në shumën 14,658,732 lekë, si edhe pakësimet për shkak të amortizimit. Vlera e amortizimit vjetor është 473,392 lekë.

Llogaria 215 “Mjete transporti”, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën neto 4,641,693 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën neto 4,801,679 lekë.

Gjatë vitit ushtrimor 2023, ka patur shtesa prej 3,500,000 lekë si rrjedhojë e blerjes së një automjeti, tip Tuscon, sipas Fletë Hyrjes Nr.28 datë 10.11.2023.

Analitiku i llogarisë 215 “Mjete transporti”.

Përshkrimi	Data e Hyrjes	Kosto Historike	Vlera Kontabël Neto 31.12.2022	Amortizimi Vjetor	Amortizimi i Akumuluar	Vlera Kontabël Neto 31.12.2023
Autoveturë Hynday Sonata TR 4941 R	2008	2,350,000	171,856	34,371	2,212,515	137,485
Autoveturë FORD FOKUS AA241 YG	2019	2,451,679	1,255,260	251,052	1,447,471	1,004,208
Autoveturë Hynday Tucson AB 225 KO	2023	3,500,000	0	0	0	3,500,000
Totali		8,301,679	1,427,116	285,423	3,659,986	4,641,693

Të gjitha mjetet në përdorim nga Institucioni janë amortizuar me normë amortizimi 20% mbi vlerën kontabël neto në fund të vitit 2022.

Vlera e amortizimit vjetor është në shumën 285,423 lekë.

Llogaria 218 “Inventar ekonomik”, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën neto 5,858,873 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën neto 6,364,064 lekë.

Llogaria 218 “Inventar Ekonomik”, gjatë vitit ushtrimor 2023 ka patur shtesa në shumën 1,019,160 lekë. Shtesat kryesisht janë kompjutera, ups, scanner, të cilat janë kryer nëpërmjet fletë hyrjes Nr.32 date 06.12.2023.

Gjatë vitit ushtrimor 2023 kemi pakësim të llogarisë për shkak të nxjerrjes jashtë përdorimit në vlerën 2,607,625 lekë, me fletë dalje Nr.113 datë 31.12.2023

Vlera e amortizimit vjetor është në shumën 1,339,776 lekë.

Përlllogaritja e amortizimit të AAM-ve është bërë sipas normave të amortizimit sipas llojit të aktivitetit të përcaktuar në Udhëzimin Nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 36.

Përlllogaritja është bërë mbi vlerën neto në celje të periudhës ushtrimore për cdo aktiv.

Referuar tabelës formati 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata, vlera neto”, totali i amortizimit për vitin 2023, për klasat e aktiveve është përlllogaritur në vlerën (2,098,591) lekë duke debituar llogarinë 1013 “Nga konsumi i AAGJ” (formati 4 “Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto”) në kredi të llogarive 2192 “Amortizimi ndërtesa dhe konstruksione” në vlerën 473,392 lekë, llogarisë 2195 “Amortizim mjete transporti” në vlerën 285,423 lekë dhe i llogarisë 2198 “Amortizim inventar ekonomik”, në vlerën 1,339,776 lekë.

Mbi regjistrin e aktiveve.

Gjetje 3. Në AK nuk ka gjetur zbatim Udhëzimi Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar kapitulli III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, konkretisht pikat 26, 27 dhe 30.

26” .. Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjister kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshirë dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. Regjistri mbahet në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar”.

27 “... Nëpunësi Autorizues i njësisë,..., cakton nëpunësin zbatues për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit”.

30” ... Format i regjistrit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjate apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, lidhen me: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia”. AK këtë e ka në formën e një dokumenti excel me të dhëna pjesore për aktivet.

PASIVET (DETYRIMET).

Pasivet Afatshkurtra

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Autoritetit të Konkurrencës më 31.12.2023, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2023, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2023, etj., si më poshtë:

Llogaritë	Përshkrimi	Viti 2023	Viti 2022	Diferenca/ndryshimi
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	2,257,302	1,044,500	1,212,802
42	Detyrime ndaj personelit	4,430,622	3,566,892	863,730
431	Detyrime ndaj shtetit tatim taksa	658,275	496,025	162,250
435	Sigurime shoqërore	1,655,479	1,354,107	301,372
436	Sigurime shëndetësore	186,404	168,376	18,028
	Gjendja më fund të periudhës	9,188,082	6,629,900	2,558,182

Llogaritë e detyrimeve afatshkurtëra, shtuar këtë vit me vlerën prej 2,558,182 lekë si më poshtë:

Llogaria 401- 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, është shtuar këtë vit me 1,212,802 lekë Vlera e këtij detyrimi lidhet me likuidimin nga buxheti te faturave te fund vitit, të cilat nga thesari realizohen në fillim të muajit janar të vitit tjetër.

Llogaria 42 “Personeli e llogari të lidhura me to-paga”, është shtuar këtë vit me 863,730 lekë si rrjedhojë e rritjes së pagave me VKM Nr.325 date 31.5.2023 "Per miratimin e struktures së pagave, niveleve të reja të pagave dhe shtesave të tjera, mbi pagë të zv.minsitrit, funksionare të kabineteve.....,etj" dhe shtimit të numrit të punonjësve me Vendimin e Kuvendit Nr.42/2023 datë 08.6.2023.

Llogaria 431 “Detyrime ndaj Shtetit për tatim-taksa” përfaqëson detyrimet e Institucionit ndaj drejtorisë së tatimeve dhe është shtuar këtë vit me vlerën 162,250 lekë për shkak të rritjes së pagave sikundër sipërcituar.

Llogaria 435 “Sigurime shoqërore” është shtuar këtë vit me 301,372 lekë për shkak të rritjes së pagave sikundër sipërcituar.

Llogaria 436 “Sigurime shëndetësore” është shtuar këtë vit me 18,028 lekë, për shkak të rritjes së pagave sikundër sipërcituar.

Fondi i Konsoliduar

Në mbyllje të vitit ushtrimor 2023 paraqitet në vlerën 20,538,438 lekë, ndërsa në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën 18,021,112 lekë.

Fondi i Konsoliduar është i barabartë me fondet neto. Gjendja e fondit të konsoliduar rezulton nga diferenca e shumës së aktiveve në vlerën 29,726,520 lekë me pasivet në vlerën prej 9,188,082 lekë.

33	D	FONDI I KONSOLIDUAR:	20,538,438	18,021,112
34	101	Teprica (Fondi I akumuluar)/Deficit i Akumuluar	20,257,106	18,238,793
35	12	Rezultatet e mbartura		
36	85	Rezultati I Veprimtarisë Ushtrimore	281,332	(217,681)
37	111	Rezerva		
38	115	Nga Fondet e veta të Investimeve		
39	15	Shuma të parashikuara për rreziqe dhe zhvlerësime		
40	105	Teprica e Granteve kapitale të brendshme		
41	106	Teprica e Granteve kapitale të huaja		
42	107	Vlera e mjeteve të caktuar në përdorim		
43	109	Rezerva nga Rivlerësimi I Aktiveve Afatgjata Të tjera		
44	E	TOTALI I PASIVEVE (B+C)	29,726,520	24,651,012

Llogaria 101“Fonde bazë”, është shtuar me 2,517,326 lekë. Këto fonde i përgjigjen pjesës së aktivitetit të bilancit. Kjo llogari përfaqëson tepricën e llogarive shtesa e pakësime të ndodhura gjatë vitit 2023.

Llogaria 85 “Rezultat i veprimtarisë ushtrimore” shtuar nga viti shkuar me vlerën 281,332 lekë dhe përfaqëson ndryshimin e gjendjes së inventarit (llogaria 63) për vitin ushtrimor.

Nga analizimi i Pasqyrës së Performancës Financiare përsa i përket të ardhurave:

Llogaritë e financimit nga buxheti i shtetit për vitin 2023 (grant) paraqitet në shumën prej 93,531,413 lekë.

Llogaritë e shpenzimeve të konstatuara sipas Pasqyrës së Performancës Financiare, sipas natyrës dhe klasifikimit të këtij formati rakordojnë me shumat e rezultuar në llogaritë e shpenzimeve sipas klasifikimit buxhetor me akt rakordimet e thesarit.

Pesha specifike e shpenzimeve pasqyrohet si më poshtë: Shpenzimet për llogarinë 600 “Paga shpërblime të tjera personeli”, në vlerën 53,888,439 lekë janë rreth 76% të totalit të shpenzimeve, shpenzimet për llogarinë 601 “Kontribute të sigurime shoqërore dhe shëndetsore” në vlerën 8,742,749 lekë rreth 12% të totalit të shpenzimeve, shpenzimet për llogarinë 602 “Mallra dhe shërbimet të tjera” në vlerën 7,002,221 lekë rreth 10% e totalit,

shpenzimet në llogarinë 606 “Transferta për buxhete familjare e individë” në vlerën 1,168,391 lekë zënë 2% të totalit të shpenzimeve.

Krahasimi mes pasqyrës së performancës dhe situacionit të shpenzimeve:

Rezultojë se, vlerat e paraqitura në pasqyrën e performancës financiare në total nuk përputhen me vlerat e paraqitura në situacionin me degën e thesarit Tiranë, “Shpenzimet korrente” sipas pasqyrave paraqiten në vlerën 70,801,800 lekë kurse sipas situacionit të shpenzimeve me degën e thesarit vlera e tyre është 71,800,943 lekë, pra me një diferencë prej 999,413 lekë më tepër në situacion.

Diferencë e shkaktuar si rrjedhojë e pasqyrimit në situacion shpenzimi të llogarisë 231 me vlerë 45,519,160 lekë, ndërkohë rezulton në pasqyra financiare e kapitalizuar në llogarinë 218 “Inventar ekonomik” vlera 1,019,160 dhe në llogarinë 215 “Mjete transporti” vlera 3,500,000 lekë; si dhe disa mosrakordime jomateriale në llogarinë 602 “ mallra dhe shërbime të tjera” me vlerë 180 lekë, llogarinë 601 “ kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore” me vlerë 7 lekë.

Pasqyra krahasuese si më poshtë:

Në lekë

Nr. llog.	SHPENZIMET E USHTRIMIT	Pasqyrat financiare	Rakordimi me thesarin	Diferenca
60	I. Shpenzime Korrente			
600	Paga, shpërblime e të tjera personeli	72,001,863	72,001,863	-
601	Kontrib.te sig.shoq.e shendets.	11,195,392	11,195,385	7
602	Mallra dhe shërbime te tjera	9,812,622	9,812,442	180
606	Transferta për buxh. familjare e individë	521,536	521,536	-
231	Investime për AAGJ materiale		4,519,160	4,519,160
	<i>Totali faktik</i>	<i>93,250,081</i>	<i>98,050,386</i>	<i>1,000,057</i>
	<i>Totali sipas Bilancit kontabël</i>	<i>93,250,081</i>		<i>4,800,305</i>

Burimi AK, përpunuar nga Grupi i Auditimit

Në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare nuk specifikohet se çfarë përfshihet në vlerën e rakorduar me thesarin dhe çfarë vlerash përfshihen në pasqyrat financiare dhe përse nuk rakordojnë këto shuma, jo në përputhje me UMF Nr.2, dt. 06.02.2012 “Procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” “Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike” “Rakordimi mujor i shpenzimeve” ku specifikohet:

172. Nëpunësi zbatues rakordon me strukturën përgjegjëse për thesarin deri në datën 5 të çdo muaji, mbi shpenzimet mujore/progresive që ka kryer njësia e qeverisjes së përgjithshme. Formati i raportit përcaktohet nga struktura përgjegjëse për thesarin.

173. Pas rakordimit mujor të shpenzimeve, njësitë e qeverisjes së përgjithshme përgatisin raportet financiare për vendimmarrjen dhe struktura përgjegjëse për thesarin përgatit raportet financiare periodike të konsoliduara të qeverisë, të cilat publikohen nga Nëpunësi i Pare Autorizues në faqen e internetit të Ministrisë së Financave” dhe Udhëzimi MFE Nr. 31, dt. 13.12.2023 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2023” pika 34 “Degët e thesarit ... gjenerojnë ... informacionin financiar disponibël/pasqyrat financiare vjetore për njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Ky informacion shërben si referencë për nëpunësit zbatues gjatë procesit të hartimit të pasqyrave financiare të institucioneve që përfaqësojnë, të dhënat përfundimtare të cilat i pasqyrojnë në sistemin informatik të qeverisë nëpërmjet strukturës përgjegjëse të thesarit në të degë në zbatim të manualeve përkatës”.

Diferencë e shkaktuar si rrjedhojë e pasqyrimit në situacion shpenzimi të llogarisë 231 me vlerë 45,519,160 lekë, ndërkohë rezulton në pasqyra financiare e kapitalizuar në llogarinë 218 “Inventar ekonomik” vlera 1,019,160 dhe në llogarinë 215 “Mjete transporti” vlera 3,500,000 lekë; si dhe disa mosrakordime jomateriale në llogarinë 602 “ mallra dhe shërbime të tjera” me vlerë 180 lekë, llogarinë 601 “ kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore” me vlerë 7 lekë.

Pasqyra krahasuese si më poshtë:

Në lekë

Nr. llog.	SHPENZIMET E USHTRIMIT	Pasqyrat financiare	Rakordimi me thesarin	Diferenca
60	I. Shpenzime Korrente			
600	Paga, shpërblime e të tjera personeli	72,001,863	72,001,863	-
601	Kontrib.te sig.shoq.e shendets.	11,195,392	11,195,385	7
602	Mallra dhe shërbime te tjera	9,812,622	9,812,442	180
606	Transferta për buxh. familjare e individë	521,536	521,536	-
231	Investime për AAGJ materiale		4,519,160	4,519,160
	<i>Totali faktik</i>	<i>93,250,081</i>	<i>98,050,386</i>	<i>1,000,057</i>
	<i>Totali sipas Bilancit kontabël</i>	<i>93,250,081</i>		<i>4,800,305</i>

Burimi AK, përpunuar nga Grupi i Auditimit

Mbi procesin e Inventarizimit:

Për vitin 2023

Me Urdhrin Nr.66 datë 28.12.2023 (protokolluar Nr.745 prot., datë 28.12.2023) “Për krijimin e komisionit të inventarizimit të vlerave materiale të institucionit”, është ngritur grupi për kryerjen e procesit të inventarizimit (V. V, Kryetar, K. Gj. dhe K. K, Anëtarë). Referuar urdhërit, “Inventarizimi do të jetë i plotë dhe do të shoqërojë kartelat e inventarizimit të kryer deri në 31.12.2023. Afati dorëzimit të dokumentacionit së bashku me proces verbalin e materialeve të propozuara për nxjerrje jashtë përdorimit, si material jo në gjendje pune do të jetë data 23.01.2024”.

Me Urdhrin Nr.67 datë 28.12.2023 (protokolluar Nr.745/1 prot., datë 28.12.2023) “Për krijimin e komisionit të vlerësimit për nxjerrjen jashtë përdorimit”, është ngritur Komisioni i Vlerësimit për nxjerrjen jashtë përdorimit (T. K, Kryetar, R. Z, A. Zh, A. K, I. Dh, Anëtarë). Referuar Urdhrit rezulton se “Komisioni pas vlerësimit të materialeve për nxjerrje jashtë përdorimit, të dërgojë për miratim te Nëpunësi Autorizues, pasqyrën përmbledhëse të materialeve të vlerësuara jashtë përdorimit, të cilat nga Komisioni i Asgjësimit do të trajtohen sipas legjislacionit në fuqi”.

Lista e aktiveve të identifikuar për vlerësim.

Në përfundim të periudhës audituese, datë 31.05.2024, në dispozicion të grupit të auditimit u vu shkresa Nr.402 prot., datë 30.05.2024 me lëndë “Informacion për grupin e auditimit lidhur me asgjësimin e vlerave material jashtë përdorimit”, e cila përveç dokumentacionit që grupi auditimit dispononte përmbante “procesverbal për vlerësimin e Aktiveve pronë e AK-së”.

Me shkresën Nr.745/5 prot., datë 26.03.2024 Nëpunësi zbatues i njësisë, në bazë të gjendjes faktike të aktiveve të rezultuar nga inventarizimi, normave të amortizimit, afatit të skadencës, vitit të vënies në punë, vlerës së shtuar ndër vite, mundësitë për riaftësimin e aktiveve në raport me kosto/përfitim për një veprim të tillë, informacionit zyrtar të marrë mbi dobishmërinë e aktiveve nga drejtuesit e programeve buxhetore dhe punonjësit e tjerë të njësisë, përcaktan gjendjen e aktiveve dhe harton listën e atyre që do të vlerësohen.

Dokumentacion ky i hartuar pjesërisht në përputhje me UMF Nr.30 datë 27.12.2011 indryshuar pika 102. Konkretisht, nuk përmban të dhëna për normat e amortizimit, afatin e skadencës (në ato raste kur ka), vitin e vënies në punë për çdo rast, vlerën e shtuar ndër vite, mundësitë për riaftësimin e aktiveve në raport me kosto/përfitim si dhe nënshkrimin e përgjegjësit material.

Referuar UMF Nr.30 datë 27.12.2011 i ndryshuar, pika 95 specifikohet se “...Procesi i vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi, Është një proces që kryhet gjatë ose pas procesit të inventarizimit. Mbi bazën e të dhënave kontabël për vitin e vënies në punë,

kohën e përdorimit, vlerën fillestare, vlerën e mbetur, vlerën e rivënies dhe mbajtjes në punë, vlerësimin kosto-përfitim, bëhet vlerësimi i aktiveve afatgjata dhe afatshkurtra materiale”.

Me Urdhrin Nr.68 datë 28.12.2023 (*protokolluar Nr.745/2 prot., datë 28.12.2023*) “Për krijimin e komisionit për asgjësimin e vlerave materiale, jashtë përdorimit”, është ngritur Komisioni për asgjësimin e materialeve të nxjerra jashtë përdorimit (A. P, Kryetar, B. Ll, P. Gj, Anëtarë)

Gjetje 4. Procedurat e inventarizimit rezultojnë pjesërisht të finalizuara dhe nuk janë ndjekur plotësisht proceset e vlerësimit, të daljes jashtë përdorimit, si dhe asgjësimit për aktivet që nuk kanë destinacion tjetër. Nuk ka një evidentim të plotë të situatës së inventarizimit për çdo llogari, arsyetimi i shkaqeve mbi inventarin jashtë funksionit, qëndrimi i titullarit/disponimi mbi mënyrën se si do te procedohet në vijim, etj. veprime në kundërshtim UMF Nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar, pikat 95, 104-106.

-Nga komisionet e ngarkuara me inventarizimin e aktiveve për vitin 2021-2023, nuk janë hartuar raporte për inventarizimin e aktiveve gjendje në magazinë, në kundërshtim me UMF Nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar, paragrafi Nr. 85/ c.

-Komisionet e inventarizimit të vlerave aktive dhe detyrimeve të AK-së nuk kanë mbajtur një procesverbal me përgjegjësin e materialeve për të fiksuar numrin rendor të fletëhyrjes dhe fletëdaljes së fundit, veprime në kundërshtim me UMF Nr. 30 datë 27/12/2011, i ndryshuar, pika 83, ...“*Para fillimit të inventarit fiksohet numri rendor i flete hyrjes dhe flete daljeve nëpërmjet një proces verbali të mbajtur midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit dhe behet mbyllja dhe dyllosja e magazinës. Hapja dhe mbyllja behet ne prani të komisionit dhe përgjegjësit material”.*

- Komisioni i inventarizimit të vlerave aktive dhe detyrimeve të AK-së, nuk kanë përpiluar një relacion në lidhje me inventarizimin fizik të aktiveve për kushtet fizike të ruajtjes së tyre.

- Nga auditimi i fletëve të inventarit të vlerave aktive dhe detyrimeve të AK-së, rezultoi se fletët kanë të plotësuar vetëm rezultatin e dalë nga inventarizimi. Bazuar në këto fletë rezultoi se nuk është respektuar proceduara e inventarizimit sipas UMF 30 datë 27.12.2011, i ndryshuar por, Komisioni është mjaftuar duke marrë të dhënat nga kontabiliteti pa dalë në një konkluzion në lidhje me gjendjen reale të inventarin pas përlllogaritjes si të amortizimit ashtu dhe mungesave, tepricave të aktiveve, veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin Nr. 30 datë 27/12/2011, i ndryshuar pika 73...“*Inventarizimi i aktiveve është një element i rëndësishëm..., i cili kryhet për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve në një kohë të caktuar si dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe me eficiencë të tyre. Inventarizimi kryhet nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara me këtë udhëzim dhe nga titullari i njësisë publike” dhe me pikën 85“Komisioni i inventarizimit ka përgjegjësinë për:*

a.Verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes së aktiveve në ngarkim/përdorim të personelit të njësisë... dhe pasqyrimin e të dhënave të inventarizimit në procesverbalin përkatës, i cili ruhet gjatë periudhës së inventarizimit.

b.Të bëjë krahasimin e gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat përkatëse të librave që mbahen nga punonjësit me përgjegjësi materiale e që janë të përputhura me sektorin e financës, të llogaritë kompensimet e lejueshme, duke marrë edhe mendimin e specialistëve përkatës dhe, për diferencat që mund të dalin pas kompensimeve, të hartojë procesverbalet.

c.Të përpilojë një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, vlerësim paraprak lidhur me cilësinë dhe kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës, së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t'ia dorëzojë për veprime të mëtejshme nëpunësit autorizues”.

-Vlerësimi i Aktiveve nuk është bërë në përputhje me përcaktimet e paragrafit Nr. 103, të UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

a.kur është plotësuar koha e shfrytëzimit në bazë të normave të amortizimit, afatit të skadencës, nëse ka, dhe nuk mund të riparohen;

b.kur riparimi është i pamundur si pasojë e konsumit dhe kur nuk mund të përshtaten për përdorim tjetër;

c.kur thyhen ose dëmtohen në shkallë të tillë që është e pamundur të kthehen në gjendje pune nëpërmjet riparimit,

d.kur vlera e riparimit ose e përshtatjes për t’i kthyer në gjendje pune është e barabartë ose më e madhe se vlera e tregut për blerjen e një aktivi të ngjashëm.

e.kur ka kaluar afati i vlefshmërisë së tyre dhe nuk mund të përdoren si të zhvleftësuar ose për qëllim tjetër në formën që janë ose në formën tjetër;

f.kur kanë humbur cilësitë e tyre të caktuara në standardet shtetërore ose në kushtet teknike dhe nuk mund të përdoren si të zhvleftësuar a ose për qëllim tjetër në formën që janë ose në formë tjetër, megjithëse nuk ka kaluar afati i vlefshmërisë;

g.kur janë dëmtuar e janë bërë të papërdorshme, si pasojë e fuqisë madhore (tërmet, përmytje, zjarr etj.) ose ndodhive të rastit;

gj.kur si pasojë e ndryshimit të kërkesave teknike, kushteve të punës, misionit të njësisë, objektivave afatmesme ose afatgjate nuk janë gjetur mundësitë e përdorimit për qëllimin e caktuar ose për qëllime të tjera, ashtu siç janë ose edhe me përshtatje.

Nga auditimi mbi procesin e inventarizimit për vitin 2023 rezultoi se:

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion, rezulton prania e një tablele (pa numër protokollit dhe pa datë) të nënshkruar nga komisioni i inventarizimit ku janë listuar materialet e propozuar për nxjerrje jashtë përdorimit. Në të listohen 27 artikuj me vlerë totale prej 2,705,826 lekë. 5 nga këta 27 artikuj, me vlerë totale prej 286,900 lekë rezultojnë pa të dhëna specifike identifikuese të artikullit. (artikujt janë: mikrokamera vëzhgimi, kufje, fshesë korrenti, tablet/laptop, printer color)

Referuar të dhënave të marra nga pasqyrat financiare, vlera e nxjerrjes jashtë përdorimit të inventarit ekonomik rezulton të jetë 2,098,591 lekë.

Me shkresën me Nr.745/6 prot., datë 26.03.2024 nga Nëpunësi Zbatues, në rolin e kryetarit të komisionit të vlerësimit për nxjerrje jashtë përdorimi të aktiveve, është hartuar relacion mbi vlerësimin dhe nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve për vitin 2023. Dokumentacioni i cili i është përcjellë për miratim Nëpunësit Autorizues.

Nëpunësi Autorizues ka dakortësuar (përmes nënshkrimit të tij mbi shkresën sipërcituar) për vijim e procedurës, operuar kështu, jo në përputhje të plotë me UMF 30 datë datë 27.12.2011, pika 96 e tij, sipas së cilës ...Nëpunësi autorizues ngarkohet me ndjekjen dhe monitorimin e realizimit të procesit të nxjerrjes jashtë përdorimit.

Në përfundim të auditimit, datë 31.05.2024, në dispozicion të grupit të auditimit u vendos shkresa Nr.402 prot., datë 30.05.2024 me lëndë “Informacion për grupin e auditimit lidhur me asgjësimin e vlerave material jashtë përdorimit”, e cila përmbante një “akt konstatim” të hartuar nga specialisti i fushës, por pa ekstremite (datë dhe Nr. protokollit), i cili nuk ndryshon konstatimin e KLSH-së në lidhje me procesin e inventarizimit.

Gjetje 5. Për v.2022 dhe v.2023 janë parashikuar dhe propozuar për të nxjerrë nga përdorimi aktive me vlerë totale 3,196,058 lekë (respektivisht v.2022 propozuar 9 artikuj me vlerë 490,232 lekë, v.2023 propozuar 27 artikuj me vlerë 2,705,826 lekë). Procesi i nxjerrjes nga përdorimi dhe asgjësimi të aktiveve të propozuara, është bërë në kundërshtim me UMF Nr. 30 datë 27.12.2011, i ndryshuar pika 109, pasi rezultojë mungesë e gjurmës së kryerjes së këtij procesi “..Aktivet që pas vlerësimit nxirren jashtë përdorimit, kur mund të përdoren si

vjetërsira/mbeturina/materiale të riciklueshme, hiqen nga regjistri i aktiveve në përdorim, bëhen hyrje në magazinë dhe u shiten me ankand ndërmarrjeve që i grumbullojnë (me përjashtim të rasteve kur sipas rregullave të shëndetësisë duhet të asgjësohen), kurse të tjerat asgjësohen nga komisioni i nxjerrjes nga përdorimi duke ndryshuar formën e tyre fillestare, groposur ose djegur”.

Konkluzion: Nga auditimi mbi analizimin e rezultateve të inventarizimit të aktiveve dhe nxjerrjen jashtë përdorimit dhe asgjësimin e tyre, rezultoi se ka mangësi në kryerjen e proceduarave të inventarizimit, nuk janë përfshirë të gjithë elementet e aktiveve, në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar Kapitulli V, Sistemi i Kontrollit Periodik të Aktiveve, Inventarizimi i Aktiveve, pika 74.

2.3 Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe të pagave.

Në zbatim të pikës 2.3 “Auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe të pagave” u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

-Struktura organike miratuar me Vendimin Nr.27/2021 të Kuvendit të Shqipërisë ndryshuar me Vendimin Nr.42/2023;

-Planifikimi rekrutimeve dhe procedurat e ndjekura,

-Largimet nga puna dhe zbatimi i vendimeve gjyqësore për gjyqëfituesit.

Auditimi iu referua akteve ligjore e nënligjore në vijim:

-Ligji Nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar;

-VKM Nr.108, datë 26.2.2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”;

-VKM Nr.242, datë 18.03.2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” i ndryshuar,

-Urdhri i Kryeministrit Nr.5151, datë 28.10.2015 “Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil”.

Auditimi u fokusua në respektimin e strukturës organike, rekrutimin e punonjësve, plotësimin e vendeve të lira/vakante si dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore për punonjësit e larguar nga puna.

Struktura organike e Autoritetit të Konkurrencës (AK) për periudhën objekt auditimi (01.01.2021 deri me datë 31.12.2023) është miratuar me Vendimin Nr.27, datë 08.03.2021, të Kuvendit të Shqipërisë me numër total punonjësish 46 deri në ndryshimet e bëra në Vendimin Nr.42, datë 08.06.2023 i ndryshuar, ku numri i punonjësve është shtuar (+3) duke shkuar në total 49.

Gjetja 1. Për vitin 2021-2023 rezulton se AK nuk ka në strukturë, njësinë e Auditit të Brendshëm, pasi nuk plotësohen kriteret e përcaktuara në VKM Nr. 83, datë 03.02.2016 “Për Miratimin e Kritereve të Krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, pika 1 (numri i punonjësve në organikë është 49 (i ulët), si dhe nuk ka varësi nga ndonjë organ epror).

Bazuar në Ligjin Nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar në nenin 10, pika 1, germa “b”, përcaktohet në mënyrë eksplicite se “Të gjitha njësitë publike, të përfshira në nenin 3, të këtij ligji, sigurojnë shërbimin e auditimit të brendshëm sipas njërës prej formave të përcaktuara në vijim: ...kryerja e shërbimit të auditimit të brendshëm nga njësia e Auditimit të Brendshëm e institucionit epror, ose nga njësia e Auditimit të Brendshëm e një

njësie tjetër publike, në bazë të një marrëveshje ndërmjet titullarëve të njësive publike përkatëse. Marrëveshja miratohet paraprakisht nga ministri përgjegjës për financat...”.

Autoriteti i Konkurrencës, në përmbushje të këtij detyrimi ligjor ka lidhur marrëveshje për kryerjen e shërbimit të auditit të brendshëm nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit Nr.7017 prot (MTM) datë 02.11.2016, me afat nga 01.12.2016 deri me 01.12. 2019. Në vijim nuk rezultom të jetë lidhur ndonjë marrëveshje për realizimin e shërbimit të auditit të brendshëm, megjithëse ka një korrespondencë në vijim deri në vitin 2019 me MTM dhe MFE, duke mbetur i pa mbuluar ky shërbim. Shkak për mungesën e njësisë së auditit të brendshëm është mos veprimi nga strukturat kooptente për mbulimin me shërbim, e cila për nga rëndësia e riskut është e mesme.

-Për vitin 2021, numri i vendeve të lira/vakante është 1 (një) dhe për vitin 2023 është 1(një).

Planifikimi rekrutimeve dhe procedurat e ndjekura për rekrutimin e punonjësve në shërbimin civil.

Në zbatim të Ligjit Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe VKM Nr. 108, datë 26.2.2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”, neni 18, për vitin 2021-2023, është hartuar dhe miratuar plani vjetor i rekrutimeve të pranimit në shërbimi civil, me shkresat respektive Nr.174 prot., datë 30.03.2021, Nr. 336 prot., datë 20.05.2022 dhe Nr. 422 prot., datë 24.07.2023.

Në lidhje me mbikëqyrjen e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil, nga Komisioneri i Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil është ushtruar kontroll dhe janë dhënë rekomandimet përkatëse përcjellë me shkresën Nr.140/7 prot., datë 06.09.2022 bashkëlidhur raporti përfundimtar dhe vendimi i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Rekrutimet për nëpunës civil janë kryer duke ndjekur procedurat ligjore që me publikimin në portal të njoftimeve për vendet e lira/vakante rast pas rasti dhe deri në shpalljen e njoftimit të fituesit. Për zhvillimin e procedurave të pranimit, me urdhërat respektivë është ngritur komiteti i pranimit për pozicionet e publikuara, janë shpallur njoftimet për fituesit dhe është bërë emërimi konform njoftimit të fituesit.

Konkretisht:

Për vitin 2021, janë zhvilluar 8 procedura konkurrimi për 9 pozicione, ku janë shpallur fitues 8 (mbetur vakant 1 vend).

Për vitin 2022, janë zhvilluar 6 procedura konkurrimi për 6 pozicione, ku janë shpallur fitues 6.

Për vitin 2023, janë zhvilluar 5 procedura konkurrimi për 6 pozicione, ku janë shpallur fitues 5 (mbetur vakant 1 vend).

- Ekzekutimi i Vendimeve gjyqësore për punonjësit e larguar nga puna.

Referuar Urdhrit Nr.5151, datë 28.10.2015 “Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil”, të Ministrisë të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Kreu II, pika 1, njësitet e burimeve njërezore të “njësive debitoare” në kuptim të këtij urdhri, kanë detyrimin të krijojnë bazën e të dhënave gjyqësore, që përfshin: informacionin mbi numrin dhe datën e vendimit gjyqësor, palët ndërgjyqëse, objektin, dispozitivin e vendimit, aktin e largimit ose lirimit të nëpunësit nga shërbimi civil, fakte dhe rrethana të lidhura, në lidhje me pozicionin e punës, pas dhënies së vendimit gjyqësor të formës së prerë etj.

Gjetja 2. Në funksion të zbatimit të detyrimit të sipërm ligjor, në Autoritetin e Konkurrencës nuk është krijuar “baza e të dhënave gjyqësore” për gjyqëfituesit e larguar nga puna, jo në

përputhje me Urdhrin Nr.5151, datë 28.10.2015, Kreu II, pika 1, si dhe nuk është krijuar Komisioni i Posaçëm, me qëllim uljen e riskut dhe koston shtesë të pagesave të vonuara për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, pranë çdo institucioni/njësie publike, jo në përputhje me Kreu IV, pika 1, i cili kryen këto detyra; “-shqyrtimin e fakteve dhe rrethanave të reja të lindura pas marrjes së vendimeve gjyqësore të formës së prerë, në favor të kreditorit gjyqëfitues,-shqyrtimin e rasteve kur urdhërimet e gjykatës përcaktojnë zbatimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, nëpërmjet zgjidhjeve alternative për njësitë debitoare, ... -shqyrtimin e mundësisë së sistemimit të gjyqëfituesit në një pozicion të rregullt në shërbimin civil...”. Mos veprimi për krijimin e bazës së të dhënave gjyqësore si dhe mos ngritjen e Komisionit të Posaçëm për administrimin e bazës së të dhënave gjyqësore për gjyqëfituesit, ka sjellë i pasojë mungesën e bazës së të dhënave për gjyqëfituesit, e cila për nga rëndësia është e nivelit të mesëm.

Për punonjësit e larguar gjyqëfitues, nga Sektori i Financës është bërë ekzekutimi i vendimeve gjyqësore për detyrimet që rrjedhin prej tyre si më poshtë:

Për vitin 2021, kemi largime nga puna me masë disiplinore për 3 punonjës si dhe mbartur procesi gjyqësor nga vitet e mëparshme për 1 punonjës, nga të cilët:

-likuiduar (1)gjyqëfitues, në vlerën 1,404,283 lekë, me vendim të formës së prerë, ekzekutimi i të cilit është bërë nëpërmjet përmbaruesit gjyqësor privat.

-në 2 raste, personat e larguar kanë hapur procese gjyqësore ndaj AK të cilat janë në proces,

-në 1 rast, nuk është ndjekur gjyqësisht nga personi i larguar.

Për vitin 2022, ka largim nga puna me masë disiplinore për 1 punonjës, i cili është në proces gjyqësor.

Për vitin 2023, ka largim nga puna me masë disiplinore për 1 punonjës, i cili është në proces gjyqësor.

Për vitin 2021, përveç punonjësve të miratuar në strukturë, nga AK është kontraktuar 1-punonjës jashtë shërbimit civil në pozicionin “punonjës Arkiv/Dokumentacioni” bazuar në VKM Nr.1151, datë 24.12.2020 “Për caktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2021”, ndërsa për vitin 2023, është kontraktuar 1-punonjës jashtë shërbimit civil në pozicionin “Teknik mirëmbajtje” bazuar në VKM Nr.56, datë 01.02.2023 “Për caktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2023.”

Punonjësit me shërbim civil janë trajtuar me pagë bazuar në VKM Nr.187, datë 08.03.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civile/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike” i ndryshuar deri me datë 31.03.2023, ndërsa punonjësit mbështetës dhe të tjerë janë trajtuar bazuar në VKM 326, datë 31.05.2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”.

Me hyrjen në fuqi të VKM Nr.325, datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civile/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike” punonjësit janë trajtuar me pagë bazuar në këtë VKM.

Kryetari i Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës dhe anëtarët e Komisionit të Konkurrencës/Komisionerët janë trajtuar me pagë deri me datë 29.05.2023, bazuar në Ligjin Nr.9584, datë 17.07.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj” i ndryshuar, ndërsa në vijim janë trajtuar me pagë në zbatim të Ligjit Nr.34/2023 “Për disa ndryshime në Ligjin Nr.9584, datë 17.07.2006 “Për pagat ,shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj” i ndryshuar.

Konkluzion:

Nga auditimi mbi strukturën organike për periudhën objekt auditimi (01.01.2021 deri 31.12.2023) rezultoi:

☞ struktura organike funksion në zbatim të Vendimit Nr.27, datë 08.03.2021 të Kuvendit të Shqipërisë ndryshuar me Vendimin Nr.42, datë 08.06.2023 i ndryshuar, ku numri i punonjësve është shtuar (+3) duke shkuar në total 49 nga 46;

☞ për vitin 2021-2023, AK nuk ka në strukturë, njësinë e Auditit të Brendshëm, si dhe nuk ka varësi nga ndonjë organ epror, pasi nuk plotësohen kriteret e përcaktuara në VKM Nr. 83, datë 03.02.2016 “Për Miratimin e Kriërve të Krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, pika 1;

☞ rekrutimi i punonjësve me shërbim civil është bërë në përputhje me zhvillimin e procedurave për plotësimin e pozicioneve të lira në shërbimin civil;

☞ për vitin 2021, rezultoi i likuiduar (1) gjyqëfitues, 2 raste janë në proces gjyqësor me AK dhe për 1 rast, nuk është hapur proces gjyqësor, për vitin 2022, rezultoi 1 rast në proces gjyqësor për largim nga puna dhe për vitin 2023, ka një rast për largim nga puna me masë disiplinore që është në proces gjyqësor;

☞ nuk është krijuar “baza e të dhënave gjyqësore” për gjyqëfituesit e larguar nga puna, jo në përputhje me Urdhrin Nr.5151, datë 28.10.2015, Kreu II, pika 1, të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike.

2.4 Zbatimi i dispozitave ligjore mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.

Në zbatim të pikës 2.4 të programit të auditimit Nr. 506/1, datë 15.04.2024”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Rregjistrat e parashikimeve
- Rregjistrat e Realizimeve
- Urdhrat e ngritjes së komisioneve
- Praktika me zgjedhje blerjesh me vlera të vogla.

Auditimi i këtij drejtimi u bazua në:

- Ligji Nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar.
- Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, ndryshuar dhe Ligji Nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar,
- VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar dhe VKM Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar
- Udhëzim Nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar.
- Udhëzim Nr.5 datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar
- Udhëzim Nr.3 datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar

Për vitin 2021-2023, auditimi i procedurave të prokurimit “blerje me vlerë të vogël”, u bazua në vlerësimin e riskut duke përzgjedhur si kampion për auditim, dosjet e procedurave për kontratat e lidhura me vlerën më të lartë nga numri total i procedurave të realizuara.

Nga auditimi i këtyre procedurave trajtuar rast pas rasti më poshtë, rezultoi se:

☒ Në v.2021-2023 ka tërheqje/mosparaqitje të operatorëve ekonomikë të shpallur fitues me vlerën më të ulët, duke vijuar me operatorin e renditur pas tij, konform legjislacionit për prokurimin publik, Udhëzimi Nr. 3 datë 08.01.2018 “*Mbi përdormimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike*”, i ndryshuar, pika 15.

☒ Në procedurën “*Blerje pajisje zyre*”, v.2021 pas tërheqjes së operatorit të parë me ofertë më të ulët është vijuar përzgjedhja deri në operatorin e 11 (njëmbëdhjetë), jo në përputhje me Udhëzimin Nr. 3 datë 08.01.2018 i ndryshuar, pika 15.

☒ Operatorët ekonomikë fitues v.2021-2023 në çdo rast kanë paraqitur dokumentacionin fizik pranë AK i cili pasi është verifikuar nga Komisioni me dokumentacionin e hedhur në sistemin elektronik të prokurimeve (SEP) është bërë pjesë e dosjes së prokurimit, në përputhje me Ligjin Nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar.

☒ Në 1 rast, “*Blerje kuti dhe dosje për arkivim dokumentacioni*” v.2021, minikontratë (MK) nuk është hedhur në SPE, jo në përputhje me Ligjin Nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, neni 56.

☒ Dosjet fizike v.2021-2023 për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, nuk janë të pajisura me inventarin e brendshëm të dosjes, duke mbartur riskun e humbjes ose tjetërsimit të gjurmës së auditimit, në kundërshtim me Ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*”, i ndryshuar dhe Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, si dhe Legjislacionit për arkivat, nenet 21, 59, 60 të normave tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë.

☒ Në 2 raste v.2021 procedura prokurimi “*Mirëmbajtje e pajisjeve të instaluar IT e të tjera*” dhe “*Shërbim infrastrukturor për komunikimin on line*”, kriteret e veçanta nuk janë argumentuar teknikisht, duke sjellë si pasojë kufizimin e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm, jo në përputhje me Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar, neni 7 dhe VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar neni 41, pika 2.

☒ Në 2 raste v.2021-2022, procedurat e prokurimit “*Karburant*”, nuk është përcaktuar marzhi i fitimit por është operuar me çmim fiks të përcaktuar si kriter vlerësimi jo në përputhje me VKM-së Nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar, neni 31, pika 3, që përcakton elementët përbërës të çmimit.

-në 2 raste “*Blerje materiale Kancelarike dhe Tонера*” viti 2022-2023, specifikimet teknike përfshijnë markën në kundërshtim me Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 i ndryshuar, neni 36.

-në 1 rast “*Pjesëmarrje në aktivitetin Dita Ndërkombëtare e Konkurrencës*” v.2022, nuk argumentohet metoda e përzgjedhur për përlogaritjen e vlerës së prokurimit, jo në përputhje me VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 për “*Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, neni 76.

-Në shumicën e rasteve v.2021-2023, në Urdhër prokurim është specifikuar vlera e fondit limit, jo në përputhje me Udhëzimin Nr.5 datë 26.04.2021 pika 8 paragrafi 2.

☒ Në administrimin e dokumentave justifikuese bashkëlidhur urdhër shpenzimeve mbi bazën e të cilave kryhen pagesa, u evidentua se dokumentacioni në disa raste përshkruhet në kolonën përkatëse të urdhër shpenzimit por nuk administrohej bashkëlidur praktikës dhe në disa raste të tjera dokumentacioni as nuk përshkruhet në urdhër shpenzim dhe as nuk administrohej, jo në përputhje me UMF Nr.30 datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik*” i ndryshuar, pika 35, germa “b”.

☒ Evidentohet mungesa e gjurmës së dërgimit të regjistrimit të parashikimeve në APP dhe degën e thesarit në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” neni 4 pika 1 dhe VKM Nr.285 datë 19.05.2021 i ndryshuar, neni 1 dhe 3 pika 3; pika 4, paragrafi 3 ku specifikohet se “*...Një kopje e regjistrimit të parashikimeve i vihet*

në dispozicion degës së thesarit dhe institucionit qendror, që vë në dispozicion fondet buxhetore, në rastin kur ka një të tillë”.

☞ Hartimi i kërkesave dhe planifikimi i nevojave, nuk është dokumentuar nga sektorët përkatës, i cili shërben për hartimin e regjistrit të parashikimit për periudhën janar – dhjetor 2021, në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar neni 4 dhe VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar nenit 3, pikat 1 dhe 2.

☞ Mungon gjurma e raportimit të realizimeve të prokurimit publik (mbi blerjet e vogla nën 100,000 lekë) në regjistrin e realizimeve në sistemin e prokurimit elektronik në kundërshtim me nenin 7 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar dhe nenin 4 të VKM Nr.285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar kompetencë e personit të ngarkuar me hedhjen e të dhënave në SPE sipas VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar neni 57.

- në shumicën e rasteve v.2022-2023, në procedurat “sistem dinamik blerje bileta avioni”, në ftesën për ofertë vendoset kriteri “eksperienca në treg prej 10 vite. .. si dhe të ketë në stafin e tij jo më pak se 5 punonjës nga të cilët 3 të jenë të pajisur me Certifikata IATA”, i cili kufizon pjesëmarrjen e biznesit të mesëm dhe të vogël, jo në përputhje me Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020, i ndryshuar, neni 2, 3 dhe 36, si dhe VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 i ndryshuar, neni 41.

-në shumicën e rasteve “sistem dinamik blerje bileta avioni” v.2022-v.2023, afati i realizimit të procedurës bëhet brënda një kohe të shkurtër me datën e udhëtimit, pasi procedurat fillojnë me vonesë (nga momenti i dërgimit të ftesës për pjesëmarrje në event jashtë vendit deri në daljen e urdhër prokurimit), duke sjellë si pasojë, riskun e përzgjedhjes së çmimit me të lartë, jo në përputhje me Ligjit Nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm”, i ndryshuar neni 8, pika 1, neni 9, pika 1 dhe neni 12, pika 3, germa a.

Nga verifikimi në sistemin e APP (SPE) për hedhjen në sistem të regjistrit të rezulton se:

Për vitin 2021:

janë hedhur në sistem 5 procedura prokurimi në datë 19.01.2021

janë hedhur në sistem 2 procedura prokurimi në datë 16.11.2021

është hedhur në sistem 1 procedur prokurimi në datë 07.12.2021.

Për sa i përket modifikimit të regjistrit të parashikimeve rezultoi se ndryshimi bëhet rast pas rasti duke shtuar nga një procedurë prokurimi dhe është ndryshuar 3 herë për vitin 2021.

Në një rast procedura “Promovimi i strategjisë për advokacinë e konkurrencës” rezulton dy herë e hedhur “në seksionin e realizuar” edhe më datë 19.11.21 edhe më datë 07.12.21 me argumentimin se, *hidhet ky zë për shkak të mosrealizimit me sukses të prokurimit herën e parë* Në dy rastet e tjera për shkak të mosrealizimit të procedurës së bileta avioni për udhëtime jashtë vendit, si rrjedhojë e pandemisë janë kryer rialokime sipas nevojave të institucionit.

Nga auditimi rezulton se *nuk ka gjurmë të jenë dërguar rregjistrat në Degën e Thesarit* në kundërshtim me nenin 4 të Vendimit Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe pikën 7 të nenit 3 “Regjistri i parashikimeve të procedurave të prokurimit publik” të Vendimit Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” për periudhën vijuese.

Nga auditimi:

“Mirëmbajtje e pajisjeve të instaluar IT e të tjera - Mirëmbajtje pajisje IT” me të dhënat si më poshtë:

-Urdhër Prokurimi Nr.490 prot., datë 22.11.2021

- Fondi Limit (pa TVSH) 333,333 lekë;
- Komisioni per blerje e vogla A.P. (përgjegjës),V. V., P. Gj.
- Operatori fitues “P” me vlerën 319,800 lekë (pa tvsh).

“Përlllogaritja e Fondit Limit dhe hartimi i specifikimeve teknike”-Me Procesverbalin datë 19.11.2021 është bërë hartimi i specifikimeve teknike dhe përlllogaritja e fondit limit duke u bazuar në testimin e tregut dhe në bazë të prokurimeve të mëparshme, për të marrë tregues për cmimet e këtij shërbimi, e cila është llogaritur në vlerën 333,333 lekë pa TVSH, në përputhje me VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 i ndryshuar, neni 76, pika 2.

Nga ana e AK në Urdhër Prokurim është specifikuar vlera e fondit limit, jo në përputhje me Udhëzimin Nr.5 datë 26.04.2021 pika 8 paragrafi 2 ku citohet “ ...Në këtë urdhër nuk do të përcaktohet fondi limit për objektin konkret”, kompetencë e personit përgjegjës për prokurimin, bazuar në VKM Nr. Nr. 285, datë 19.05.2021 i ndryshuar Neni 74, pika 3, germa “c”.

“Argumentimi dhe Hartimi i Kritereve”-Në përcaktimin e kritereve të kualifikimit mungon një shpjegim teknik si dhe referenca si janë identifikuar këto kërkesa në raport me softëare apo database që institucioni disponon. Mungesa e një argumentimi teknik sjell si pasojë vendosje të kritereve të cilat kufizojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, referuar Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 i ndryshuar neni 7 dhe VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 i ndryshuar neni 41, pika 2 i cili përcakton se: *“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës”*.

“Shqyrtimi dhe Vlerësimi i ofertave”-Në datën e zhvillimit të procedurës në SPE kanë shfaqur interes dhe paraqitur oferta 7 Operatorë Ekonomikë. Operatori “O”, me vlerën më të ulët i kualifikuar në vend të parë është tërhequr nga lidhja e kontratës, duke vijuar kërkesën për lidhje kontrate deri te operatori i renditur në vend të pestë “P” me vlerë 319,800 lekë pa TVSH, i cili është likujduar me Urdhër shpenzimin Nr.303 datë 13.12.2021 me vlerë 383,760 lekë me TVSH.

“Shërbim infrastrukturor për komunikimin online”

- Urdhër Prokurimi Nr.512 prot., datë 07.12.2021
- Fondi Limit (pa TVSH) 333,333 lekë;
- Komisioni per blerje e vogla A. P. (përgjegjës),V. V., P. Gj.
- Operatori fitues “P” me vlerën 326,900 lekë (pa tvsh).

“Përlllogaritja e Fondit Limit dhe hartimi i specifikimeve teknike”-Me Procesverbalin datë 06.12.2021 është bërë hartimi i specifikimeve teknike dhe përlllogaritja e fondit limit duke u bazuar në testimin e tregut dhe në bazë të prokurimeve të mëparshme, për të marrë tregues për cmimet e këtij shërbimi, e cila është llogaritur në vlerën 333,333 lekë pa TVSH në përputhje me VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 i ndryshuar, neni 76, pika 2.Në Urdhër Prokurim është specifikuar vlera e fondit limit, jo në përputhje me Udhëzimin Nr.5 datë 26.04.2021 pika 8 paragrafi 2 ku citohet “ ...Në këtë urdhër nuk do të përcaktohet fondi limit për objektin konkret”, kompetencë e personit përgjegjës për prokurimin, bazuar në VKM Nr. Nr. 285, datë 19.05.2021 i ndryshuar Neni 74, pika 3, germa “c”.

“Argumentimi dhe Hartimi i Kritereve”-Në përcaktimin e kritereve të kualifikimit mungon një shpjegim teknik si dhe referenca si janë identifikuar këto kërkesa në raport me software apo database që institucioni disponon. Mungesa e një argumentimi teknik sjell si pasojë vendosje të kritereve të cilat kufizojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, referuar Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 i ndryshuar neni 7 dhe VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 i ndryshuar neni 41, pika .

“Shqyrtimi dhe Vlerësimi i ofertave”-Në datën e zhvillimit të procedurës në SPE ka shfaqur interes dhe paraqitur ofertë vetëm Operatori Ekonomik “P”, me vlerë 326,900 lekë pa TVSH,

i cili është likuajduar me Urdhër shpenzimin Nr.307 datë 16.12.2021 me vlerë 392,280 lekë me TVSH.

“Promovim i Strategjisë për Advokacinë e Konkurrencës”.

-Urdhër Prokurimi Nr.517 prot., datë 09.12.2021

-Fondi Limit (pa TVSH) 500,000 lekë;

- Komisioni për blerje e vogla A. P. (përgjegjës), V. V., P. Gj.

-Operatori fitues “B” me vlerën 498,000 lekë (pa TVSH).

“Përlllogaritja e Fondit Limit dhe hartimi i specifikimeve teknike”-Me Procesverbalin datë 07.12.2021 është bërë hartimi i specifikimeve teknike dhe përlllogaritja e fondit limit duke u bazuar në prokurimet e mëparshme për të marrë tregues për cmimet e këtij shërbimi, e cila është llogaritur në vlerën 500,000 lekë, në përputhje me VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 i ndryshuar, neni 76, pika 2. Në Urdhër Prokurim është specifikuar vlera e fondit limit, jo në përputhje me Udhëzimin Nr.5 datë 26.04.2021 pika 8 paragrafi 2, kompetencë e personit përgjegjës për prokurimin, bazuar në VKM Nr. Nr. 285, datë 19.05.2021 i ndryshuar Neni 74, pika 3, germa “c”.

“Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve”-Nga ana e Komisionit në përcaktimin e kritereve të kualifikimit/kriteret e kapacitetit teknik, janë përshkruar nevojat për realizim nga ana sasiore, por mungojnë të dhëna teknike të detajuara. Pavarësisht se në hartimin e kritereve Komisioni shprehet se *“...nisur nga natyra e objektit të prokurimit, vendosja e disa kritereve të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese të OE për përmbushjen me sukses të procedurës... ”*, kritere të cilat nuk gjejnë pasqyrim në dokumentet standarde, jo në përputhje me VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar neni 41.

“Shqyrtimi dhe Vlerësimi i ofertave”-Datën e zhvillimit të procedurës në SPE kanë shfaqur interes dhe paraqitur oferta 3 Operatorë Ekonomikë. Një është s’kualifikuar për objekt veprimtarie të ndryshëm nga ai i prokurimit. Operatori “O”, me vlerën më të ulët i kualifikuar në vend të parë është tërhequr duke vijuar kërkesën për realizim shërbimi deri te operatori i renditur në vend të tretë “B” me vlerë 480,000 lekë pa TVSH, i cili është likuajduar me Urdhër shpenzimin Nr.311 datë 28.12.2021 me vlerë 597,600 lekë me TVSH.

“Blerje pajisje zyre”.

-Urdhër Prokurimi Nr.137 prot., datë 11.03.2021

-Fondi Limit (pa TVSH) 750,000 lekë;

-Komisioni për blerje e vogla A. P. (përgjegjës), P. Gj. ,V. V.

-Operatori fitues “D” me vlerën 736,000 lekë (pa tvsh).

“Përlllogaritja e Fondit Limit dhe hartimi i specifikimeve teknike”-Me Procesverbalin datë 10.03.2021 është bërë hartimi i specifikimeve teknike dhe përlllogaritja e fondit limit duke u bazuar në testimin e tregut dhe në bazë të prokurimeve të mëparshme, për të marrë tregues për cmimet e këtij shërbimi, e cila është llogaritur në vlerën 750,000 lekë pa TVSH në përputhje me VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 për *“Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”*, neni 76, pika 2.

“Argumentimi dhe Hartimi i Kritereve”-Kriteret e kualifikimit janë hartuar duke ju përmbajtur VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar.

“Vlerësimi i ofertave”-Në datën e zhvillimit të procedurës në SPE kanë shfaqur interes dhe paraqitur oferta 12 Operator Ekonomik. Operatori “R” me vlerën më të ulët i kualifikuar në vend të parë është tërhequr nga kryerja e shërbimit duke vijuar kërkesën për lidhje kontrate deri te operatori i renditur në vend të 11 (njëmbëdhjetë) “D” me OE 736,000 lekë, i cili është likuajduar me Urdhër shpenzimin Nr.67 datë 07.04.2021 me vlerë 883,200 lekë.

“Blerje kuti dhe dosje për ruajtje të përhershme”-minikontratë/Marrëveshje kuadër

-Urdhër Prokurimi Nr.547 prot., datë 07.10.2020

-Fondi Limit (pa TVSH) 750,000 lekë;

-Komisioni per blerje e vogla DPA

-Operatori fitues “K”

-Vlera e faturës 159,800 lekë me TVSH

Praktika nuk rezulton të jetë publikuar në SPE jo në përputhje me Ligjin Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, neni 56.

Me Urdhërin Nr.45 datë 18.01.2021 të NA ish Sekretar i Përgjithshëm është përcaktuar nëpunësi i autorizuar përgjegjës për prokurimet e vitit 2021, që do të kryej veprimet në SPE.

Me Urdhërin Nr.44, datë 18.01.2021 është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim të materialeve që kryhen nëpërmjet procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe mbikqyrjes së kontratës. OE është likujduar në zbatim të kontratës.

Me shkresën Nr.323/1 prot., datë 15.09.2020 i është kërkuar Drejtorisë së Përgjithshme të arkivave specifikimi i dosjeve dhe kutive për ruajtje të përhershme të dokumentacionit të arkivit.

Bashkangjitur praktikës së urdhër shpenzimit dokumentacioni:

- Urdhër shpenzimi Nr.121, datë 21.05.2021

- Urdhër prokurimi DPA Nr.547 datë 07.10.2020 për blerje të përqëndruar

- Procesverbal marrje në dorëzim datë 10.05.2021

- Faturë Nr.56/2021 datë 10.05.2021

- Kontratë furnizim malli Nr.221 datë 23.04.2021

- Marrëveshje kuadër me Arkiven dhe OE fitues Nr.212 ak dt 23.12.2020

- Fletë hyrje *pa numër dhe datë*

Nga auditimi i dokumentacionit të kësaj procedure rezultoi:

-Procesverbali i marrjes në dorëzim mbante datë 29.04.2021 (jo 10.05.2021 sikundër në urdhër shpenzim cituar) me vlerë totale 286,700 lekë pa TVSH.

-Administrohen dy fatura bashkalidhur praktikes, (Faturë Nr.56/2021 datë 10.05.2021 me vlerë 191,760 lekë dhe (Faturë Nr.48/2021 datë 14.06.2021 faturë korrigjuese me vlerë (344,040 lekë)

-Fletë hyrja në magazinë e grisur dhe nuk verifikoheshin dot ekstremitetet si data dhe numri i saj.

-Në korrespondencën me email mbajtur me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave rezulton se, nga ana e DPA i është dërguar më datë 02.10.2020 ora 14:12 email ku i specifikohet “... Në vijim të kërkesës suaj për dërgimin e nevojave për kuti dhe dosje për ruajtje të përhershme për v.2021 ju bëjmë me dije se informacioni i dërguar nuk është i plotë. Duhet ridërguar sasi të dhe fondi limit sipas çmimeve të dërguara nga DPA si Organ Qendror Blerës. Brenda datës 05.10.2020 ora 12:00 në rrugë elektronike shkresën e skanuar si dhe me postë...”

-Mungesë e shkresës së ridërguar sipas specifikimeve të vendosura dhe kërkuara nga DPA.

-Në draft Marrëveshje Kuadër për punë/mallra/shërbime Nr.6371/56 prot., datë 29.12.2020 mes DPA dhe OE “K” neni 1, paragrafi II veç të tjerash citohet “... AK të cilat lidhin marrëveshje kuadër: Organi Qendror Blerës, DPA në emër dhe për llogari të 212 Autoriteteve Kontraktore... 45.Autoriteti Konkurrencës me vlerë fondi limit 172,480 lekë pa TVSH”.

-Kontratë e furnizimit Nr.221 datë 23.04.2021 mes AK dhe OE “K” neni 18 çmimi i kontratës parashikon “..çmimi i kontratës është në vlerën 191,760 lekë me TVSH”, konkretisht:

Nr.	Emërtimi	Sasi (copë)	Çmimi/njësi	Çmimi total
1	Kuti për ruajtje të përhershme (40*28*18)	20	1,700	34,000
2	Kuti për ruajtje të përhershme amza (40*55*18)	20	2,380	47,600
3	Kuti për ruajtje të përhershme (40*70*9)	20	3,580	71,600

4	Dosje për ruajtje të përhershme (37*26)	20	330	6,600
	Çmimi Neto			159,800
	TVSH 20%			31,960
	Çmimi total me TVSH			191,760

-Akt Dorëzimi nga OE tek AK më datë 29.04.2021 specifikon sasitë respektive të marra por jo çmimin për njësi, konkretisht:

Nr.	Emërtimi	Sasi (copë)
1	Kuti për ruajtje të përhershme (40*28*18)	50
2	Kuti për ruajtje të përhershme amza (40*55*18)	20
3	Kuti për ruajtje të përhershme (40*70*9)	20
4	Dosje për ruajtje të përhershme (37*26)	250

“Pjesëmarrje në aktivitetin Dita Ndërkombëtare e Konkurrencës”.

-Urdhër Prokurimi Nr.496/2 prot., datë 01.12.2021

-Fondi Limit (pa TVSH) 300,000 lekë;

-Komisioni për blerje e vogla A. P. (përgjegjës), P. Gj, V. V.

-Operatori fitues “V” me vlerën 300,000 lekë (pa TVSH).

“Përlllogaritja e Fondit Limit dhe hartimi i specifikimeve teknike”-Me Procesverbalin datë 01.12.2021 është bërë hartimi i specifikimeve teknike dhe përlllogaritja e fondit limit në vlerën 300,000 lekë pa TVSH, por mungon testimi i tregut në kundërshtim me VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar neni 76, pika 2. Në Urdhër Prokurim është specifikuar vlera e fondit limit, jo në përputhje me Udhëzimin Nr.5 datë 26.04.2021 pika 8 paragrafi 2, kompetencë e personit përgjegjës për prokurimin, bazuar në VKM Nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar Neni 74, pika 3, germa “c”.

“Argumentimi dhe Hartimi i Kritereve” - Nga ana e Komisionit të prokurimit me vlera të vogla janë përcaktuar kriteret e kualifikimit për praninë në procedurë. Kriteret janë argumentuar teknikisht, duke përmblusur dispozitave të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 i ndryshuar, neni 7 dhe VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 neni 41, pika 2.

“Shqyrtimi dhe Vlerësimi i ofertave”-Në datën e zhvillimit të procedurës në SPE ka shfaqur interes dhe paraqitur ofertë 1 Operatorë Ekonomikë. Operatori “V” me vlerën 300,000 lekë, i cili është likuaduar me Urdhër shpenzim Nr.304 datë 14.12.2021 me vlerë 300,000 lekë.

“Karburant”.

-Urdhër Prokurimi Nr.82/2 prot., datë 02.02.2021

-Fondi Limit (pa TVSH) 520,833 lekë;

-Komisioni për blerje e vogla A. P. (përgjegjës), P. Gj, V. V.

-Operatori fitues “Kastrati” me vlerën 488,000 lekë (pa TVSH).

“Përlllogaritja e Fondit Limit dhe hartimi i specifikimeve teknike” -Me Procesverbalin datë 26.01.2021 është bërë përlllogaritja e fondit limit në vlerë 520,833 lekë pa TVSH. Theksojmë se mënyrat në lidhje me përlllogaritjen e fondit limit përcaktohen në VKM-së Nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar neni 59 pika 2.

“Argumentimi dhe Hartimi i Kritereve”-Në këtë procedurë, në mënyrë të gabuar njësia e prokurimit ka vendosur si kriter për shpalljen e ofertës fituese atë të *“oferta ekonomisht më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët”* duke nënkuptuar me vlerë fikse, e duke mos zbatuar VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar, neni 31 pika 3 i cili përcakton elementët përbërës të çmimit, ku citohet *“...Për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, në rastet kur oferta ekonomisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët, ky i fundit përlllogaritet bazuar në: a) çmimin e bursës, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili dërgohet për publikim çdo javë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në Buletinin e Njoftimeve*

Publike; b) elementet fiskale; c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës”.

Nga ana e komisionit nuk është përcaktuar marzhi i fitimit por është operuar me një çmim fiks të përcaktuar, në devijim nga baza ligjore i cili mbart risk të lart në vetvete. Si konkluzion, kriteri i sipërcituar përbën një risk të shtuar për AK pasi luhatjet e çmimeve të karburanteve eventualisht mund të ndikojnë negativisht në Buxhetin e Shtetit.

Nga ana e AK në Urdhër Prokurim është specifikuar furnizimi me benzinë ppm në sasinë 3,000 litër dhe diesel 10 ppm në sasinë 1,000 litra.

“Shqyrtimi dhe Vlerësimi i ofertave”-Me procesverbalin datë 02.02.2021 është përcaktuar data e zhvillimit të tenderit 02.02.2021 ora 11:00. Për këtë procedurë kanë paraqitur oferta 4 Operatorë Ekonomik, ku janë kualifikuar 3 (tre) dhe s’kualifikuar 1 (një) për shkak të ofertës ekonomike më të lartë se fondi limit (procedurë e cila është anuluar).

Për këtë procedurë kanë paraqitur oferta 7 OE, ku janë kualifikuar 6 (gjashtë) dhe skualifikuar 1 (një) për shkak të ofertës ekonomike më të lartë se fondi limit. Në datën e zhvillimit të procedurës në SPE kanë shfaqur interes dhe paraqitur oferta 6 Operatorë Ekonomikë. Operatori “G” me vlerën më të ulët i kualifikuar në vend të parë është s’kualifikuar dhe është vijuar lidhja e kontratës deri te operatori i renditur në vend të pestë “K” me vlerë 488,000 lekë pa TVSH, i cili është likuiduar me Urdhër shpenzimin Nr.44 datë 09.03.2021 mbështetur në kontratën e furnizimit Nr.82/6 prot., datë 15.02.2021, me vlerë 585,600 lekë me TVSH.

Për Vitin 2022

Për vitin 2022 janë nxjerrë urdhrat respektive për ngritjen e komisioneve si më poshtë:

Urdhër Nr.45, datë 18.01.2022 “Për Krijimin e Komisionit të Blerjeve nën 100,000 lekë”.

Urdhër Nr.42, datë 18.01.2022 “Për Krijimin e Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël”.

Urdhër Nr.44, datë 18.01.2022 “Për Krijimin e Komisionit të Marrjes në Dorëzim të Materialeve”.

Urdhër Nr.44/1, datë 06.06.2022 “Për Një ndryshim në Krijimin e Komisionit të Marrjes në Dorëzim të Materialeve që Kryhen nëpërmjet procedurës së Prokurimit me Vlerë të Vogël dhe Mbikëqyrjen e Kontratës”.

Për vitin 2022 janë realizuar gjashtë procedura me fond limit pa tvsh 2,520,001 lekë, me vlerë të kontratave të lidhura dhe të likuiduara me urdher shpenzimet përkatëse në vlerën 2,262,719 lekë me TVSH.

Nga auditimi:

“Blerje materiale Kancelarike dhe Tonera” me të dhënat si më poshtë:

Urdhër Prokurimi Nr.88 Prot, datë 03.02.2022;

Fondi Limit (pa TVSH) 250,000 lekë

Komisioni blerjeve të vogla: A. P. (përgjegjës), P. Gj. dhe V. V. -anëtarë.

Operatori fitues “InfoSoft Office” me vlere me ulet te ofertës 187,000 lekë pa TVSH.

“Përlllogaritja e Fondit Limit dhe hartimi i specifikimeve teknike”

Gjetje 1. Me Procesverbalin datë 01.02.2022 është bërë hartimi i specifikimeve teknike duke specifikuar markën në kundërshtim me Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publike” i ndryshuar, neni 36. Përlllogaritja e fondit limit është bazuar në testimin e tregut duke marrë oferta nga tre operatorë në përputhje me VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 i ndryshuar, neni 76.

“Shqyrtimi dhe Vlerësimi i ofertave”-Në datën e zhvillimit të procedurës në SPE kanë shfaqur interes dhe paraqitur oferta 19 Operatorë Ekonomikë, fitues Operatori “I”, me vlerën më të

ulët 187,000 lekë pa VSH likuiduar me Urdhër Shpenzimin Nr.26 datë 14.02.2022 me vlerë 224,400 lekë me TVSH.

“Pajisje Kompjuterike, Informatike”

Urdhër Prokurimi Nr.695 Prot, datë 30.11.2022 ;

Fondi Limit (pa TVSH) 236,667 lekë ;

Komisioni blerjeve të vogla A. P. (përgjegjës), P. Gj. dhe V. V.-anëtarë.

Operatori i renditur në vend të parë me vlerën me ulët të ofertës 189,900 lekë pa TVSH, është skualifikuar për shkak të mos përmbushjes së specifikimeve të kërkuar nga AK, në këtë mënyrë është kaluar tek OE i renditur në vend të dytë “A” me vlerë oferte 200,000 lekë pa TVSH.

“Përlllogaritja e Fondit Limit dhe hartimi i specifikimeve teknike” -Me Procesverbalin datë 25.11.2022 është bërë hartimi i specifikimeve teknike dhe përlllogaritja e fondit limit duke u bazuar në prokurimet e mëparshme për të marrë tregues për çmimet e këtij shërbimi, e cila është llogaritur në vlerën 236,667 lekë, në përputhje me VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 i ndryshuar, neni 76.

“Shqyrtimi dhe Vlerësimi i ofertave”-Datën e zhvillimit të procedurës në SPE kanë shfaqur interes dhe paraqitur oferta 19 Operatorë Ekonomikë. OE i renditur në vend të parë është skualifikuar për mos përmbushjes së specifikimeve të kërkuar nga AK dhe është kaluar tek OE në vend të dytë “A” me vlerë oferte 200,000 lekë pa TVSH, i cili është likuiduar me Urdhër shpenzimin Nr.245 datë 30.12.2022 me vlerë 192,000 lekë me TVSH.Me proces verbalin datë 09.12.2022 është kryer marrja në dorëzim e mallit të prokuruar.

“Pjesëmarrje në aktivitetin Dita Ndërkombëtare e Konkurrencës 2022”.

Urdhër Prokurimi Nr. 678 Prot, datë 17.11.2022;

Fondi Limit (pa TVSH) 675,000 lekë;

Komisioni blerjeve të vogla A. P (përgjegjës), P. Gj. dhe V. V.-anëtarë.

Operatori fitues “T” me vlerën 425,000 lekë

“Përlllogaritja e Fondit Limit dhe hartimi i specifikimeve teknike”

Gjetje 2. Me Procesverbalin datë 17.11.2022 është bërë hartimi i specifikimeve teknike dhe përlllogaritja e fondit limit në vlerën 675,000 lekë pa TVSH, por mungon metoda e perzgjedhur për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit, jo në përputhje me VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 për “Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 76.

“Shqyrtimi dhe Vlerësimi i ofertave”-Në datën e zhvillimit të procedurës në SPE ka shfaqur interes dhe paraqitur ofertë dy Operatorë Ekonomikë. Operatori “T” me vlerën 425,000 lekë dhe Operatori “S” me vlerën 954,876 lekë, ky i fundit është skualifikuar për shkak se është paraqitur me vlerë më të lartë se fondi limit. OE fitues është likuiduar me Urdhër Shpenzim Nr.234 datë 15.12.2022 me vlerë 509,999 lekë me TVSH.

“Karburant 2022”.

Urdhër Prokurimi Nr.64/2 Prot, datë 27.01.2022 ;

Fondi Limit (pa TVSH) 525,000 lekë;

Komisioni blerjeve të vogla A. P. (përgjegjës), P. Gj. dhe V. V.-anëtarë.

Operatori fitues “K” me vlerën 523,600 lekë.

“Përlllogaritja e Fondit Limit dhe hartimi i specifikimeve teknike” :

Gjetje 3. Me Procesverbalin datë 27.01.2022 është bërë përlllogaritja e fondit limit vlerë 525,000 lekë pa TVSH. Në këtë procedurë, në mënyrë të gabuar njësia e prokurimit ka vendosur si kriter për shpalljen e ofertës fituese *“oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët”* pra vlerë fikse, jo në përputhje me VKM Nr. 258, datë 19.05.2021, i ndryshuar neni 45 pika 2 i cili përcakton elementët përbërës të çmimit *“ Për furnizimin me*

karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, në rastet kur oferta ekonomisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët, ky i fundit përlllogaritet bazuar në:

a) çmimin e bursës, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili dërgohet për publikim çdo javë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në Buletinin e Njoftimeve Publike;

b) elementet fiskale;

c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës”.

Komisioni i përlllogaritjes së fondit limit specifikon çmimin mesatar të ditës pa TVSH për benzinë 154.3 lekë dhe naftë 154.0 lekë për litër, duke mos përcaktuar marzh fitimi, por çmim fiks të përcaktuar, në devijim nga baza ligjore e sipërcituar. Një përcaktim i tillë mbart risk, pasi luhatjet e çmimeve të karburanteve mund të ndikojnë negativisht në Buxhetin e Shtetit.

“Shqyrtimi dhe Vlerësimi i ofertave”-Në datën e zhvillimit të procedurës në SPE kanë shfaqur interes dhe paraqitur oferta 8 OE. Me procesverbalin datë 31.01.2022 rezulton se nga Komisioni janë skualifikuar 5 OE për shkak se nuk kanë patur si objekt të veprimtarisë tregtimin e karburantit dhe/ose janë paraqitur me vlerë më të lartë se fondi limit. Operatori “A” me vlerën më të ulët i kualifikuar në vend të parë dhe Operatori “O” i kualifikuar në vend të dytë nuk janë paraqitur pranë AK për të dorëzuar dokumentacionin, kështu që është vijuar me Operatorin “K” i renditur i treti me vlerën 523,600 lekë për të lidhur kontratën e furnizimit Nr 64/4 datë 07.02.2022 i cili është likuiduar me Urdhër Shpenzimin Nr.25 datë 14.02.2022 në vlerën 628,320 lekë me TVSH.

“Blerje pajisje zyre 2022”

Urdhër Prokurimi Nr.321 Prot, datë 18.05.2022

Fondi Limit (pa TVSH) 166,667 lekë;

Komisioni blerjeve të vogla A. P. (përgjegjës), P. Gj. dhe V. V.-anëtarë.

Operatori fitues “S” me vlerën 160,000 lekë (pa tvsh).

“Përlllogaritja e Fondit Limit dhe hartimi i specifikimeve teknike” -Në Procesverbalin datë 17.05.2022 është pasqyruar hartimi i specifikimeve teknike dhe përlllogaritja e fondit limit duke u bazuar në testimin e tregut, për të marrë tregues për çmimet e këtij shërbimi, i llogaritur në vlerën 166,667 lekë pa TVSH, në përputhje me VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 për “Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 76.

“Vlerësimi i ofertave”-Në datën e zhvillimit të procedurës në SPE kanë shfaqur interes dhe paraqitur oferta 20 OE nga ana e Komisionit me procesverbalin datë 19.05.2022 rezulton të jenë skualifikuar 11 OE për shkak se, nuk kanë patur si objekt të veprimtarisë tregtimin e karburantit dhe/ose janë paraqitur me vlerë më të lartë se fondi limit. Nga 9 Operatorët e mbetur në garë, 5 OE nuk janë paraqitur pranë AK për të dorëzuar dokumentacionin, kështu që është vijuar me operatorin “S” i renditur i gjashti me vlerën 160,000 lekë i cili është likuiduar me Urdhër Shpenzimin Nr.108 datë 20.06.2022 në vlerën 192,000 lekë me TVSH.

“Blerje Pajisje Informatike 2022”

Urdhër Prokurimi Nr.410 Prot, datë 09.06.2022

Fondi Limit (pa TVSH) 666,667 lekë;

Komisioni blerjeve të vogla A. P. (përgjegjës), P. Gj. dhe V. V.-anëtarë.

Operatori fitues “Atom” me vlerën 430,000 lekë (pa TVSH).

“Përlllogaritja e Fondit Limit dhe hartimi i specifikimeve teknike”- Në Procesverbalin datë 07.06.2022 është pasqyruar hartimi i specifikimeve teknike dhe përlllogaritja e fondit limit duke u bazuar në testimin e tregut për të marrë tregues për çmimet e këtij shërbimi, e cila është llogaritur në vlerën 666,667 lekë, në përputhje me VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 i ndryshuar, neni 76.

“Shqyrtimi dhe Vlerësimi i ofertave”-Në datën e zhvillimit të procedurës në SPE kanë shfaqur interes dhe paraqitur oferta 19 OE nga ana e Komisionit, referuar procesverbalit datë

10.06.2022 janë skualifikuar 6 OE për shkak se nuk kanë patur si objekt të veprimtarisë tregtimin e karburantit dhe/ose janë paraqitur me vlerë më të lartë se fondi limit. Nga 13 Operatorët e mbetur në garë, 5 nuk janë paraqitur pranë AK për të dorëzuar dokumentacionin, kështu që është vijuar me Operatorin "A" i renditur i gjashti me vlerën 160,000 lekë i cili është likuiduar me Urdhër Shpenzimit Nr.114 datë 07.07.2022 në vlerën 516,000 lekë me TVSH.

Për vitin 2022 nëpërmjet sistemit dinamik të blerjeve për blerje bileta avioni janë shpenzuar 1,305,211 lekë për nevojat e institucionit dhe janë kryer 14 procedura në sistemin SPE. Në vlerësimin e riskut u përzgjedhën 7 procedura prej tyre me vlerën më të lartë trajtuar më poshtë:

1. Urdhër Shpenzimi Nr.45, datë 09.03.2022 me vlerë 74,221 lekë likuiduar OE F, fitues i tenderit për blerje biletë avioni me itinerar Tirane-Vjene-New York; New York-Mynih-Tirane (copë një). Pjesëmarrës në tender 6 OE, kualifikuar në vend të parë operatori F me vlerën më të ulët 605 lekë.

Gjetje 4. Nga USH rezulton se OE, është likuiduar në vlerën 74,221 lekë, pra 73,616 lekë me shumë se oferta e paraqitur nga ai.

Nga auditimi i dokumentacionit, bashkëlidhur urdhër shpenzimit rezulton se fatura elektronike e OE është firmosur nga KP me vlerë të vogël (A. P., P. Gj., V. V.) për vlerën 74,221 lekë ndërkohë që, në procesverbalin e vlerësimit të prokurimit, komisioni ka nënshkruar ofertën e paraqitur nga OE F në vlerën 605 lekë. Subjekti i audituar për këtë konstatim, argumenton se vlera e ofruar nga operatori është në euro dhe duke e konvertuar rezulton vlera prej 74,221 lekë, për të cilën ka nënshkruar dhe faturën e sjellë nga subjekti dhe nuk ka observuar për këtë konstatim të KLSH-së. Grupi i auditimit shprehet se në SPE, oferta e gjeneruar nga sistemi shprehet në lekë dhe jo në monedhë të huaj, në këto kushte, është marrë e mirëqënë vlera prej 605 lekë që gjeneron sistemi elektronik i prokurimeve. Me këtë vlerë është bërë krahasimi me vlerën e faturës së paraqitur nga OE. Për pasojë, vlera prej 73,616 lekë përbën dëm për buxhetin e AK, përfituar padrejtësisht nga OE F.

Për sa sipër, nga subjekti është bërë observacion ndaj Projektraportit, me shkresën Nr.311/14, prot., datë 30.08.2024, protokolluar në KLSH me shkresën Nr. 506/16 prot., datë 06.09.2024.

Pretendimi subjektit : "... Në lidhje me Projekt Raportin e Auditimit dërguar nga ana juaj me shkrën Nr 506/5 prot, datë 29.07.2024, ju paraqesim observacion si më poshtë:

-Në pikën 1.2.II, të Projekt Raportit, në paragrafin "Përmbledhje Ekzekutive", nga ana juaj është evidentuar një dem ekonomik në vlerë 73,616 lekë në lidhje me operatorin "OE F. Nisur nga dokumentacioni dhe nga shpenzimi i kryer, ju sqarojmë se vlera e ofertuar për biletë avioni nga operatori "OE F ka qënë në masën 605 euro dhe jo në masën 605 lekë. Për shkak të lapsusi në vlerën e ofertuar është krijuar një diferencë midis vlerës së ofertuar dhe asaj të shpenzuar e cila nuk ka sjellë asnjë dëm ekonomik real. Për sa më sipër lutemi të merret në konsideratë ky observacion".

Qëndrimi i grupit të auditimit : *Grupi i Auditimit, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga subjekti vlerësoi se nuk ka dokumentacion tjetër shtesë nga ai i paraqitur gjatë auditimit por, shprehet vetëm për një lapsus në veprimet e kryera nga komisioni, për këtë arsye observacioni nuk merret në konsideratë. Nëse i referohemi kualifikimit të bërë nga SPE, vlera e ofertuar nga OE i renditur në vend të dytë 'L' është në vlerën 72,590 lekë, pra është më e ulët se vlera e OE fituese. Pretendimi i subjektit se është lapsus nuk qëndron, pasi në SPE oferta publikohet në monedhën "lekë".*

2. Me Urdhër Prokurimin Nr 181, datë 09.03.2022 ka filluar procedura e prokurimit për blerje bileta avioni (SDB) me destinacion Tirane-Roma-Lisbona-Salvator, Salvator-Lisbona-Roma-Tirane, në date 28.03.2022 per 2 (cope) bileta avioni.

Gjetje 5. Në ftesën për ofertë është kërkuar ndër të tjera që “*OE duhet te jetë i certifikuar me IATA,... të ketë 10 vite eksperiencë në treg .. si dhe të ketë në stafin e tij jo më pak se 5 punonjës nga të cilët 3 të jenë te pajisur me Certifikata IATA*”. Kriteret e përcaktuara nga AK kufizojnë pjesëmarrjen e biznesit të mesëm dhe të vogël, dhe janë jo në përputhje me Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020i ndryshuar, neni 2, 3 dhe 36, si dhe VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 i ndryshuar, neni 41. Me Procesverbalin e mbajtur në datë 09.03.2022 nga KSDB është kualifikuar si fitues OE “O” i renditur i pari me vlerën më të ulët të ofruar 452,600 lekë pa TVSH, i cili është likuiduar me Urdhër Shpenzimin Nr.48, datë 15.03.2022.

3.Me Urdhër Prokurimin Nr 647, datë 04.11.2022 ka filluar procedura e prokurimit për blerje bileta avioni (SDB) për destinacionin Tirane-Stamboll-Tibilisi, Tibilisi-Stamboll- Tirane, në date 15.11.2022 per 1 (cope) bileta avioni.

Gjetje 6. Ne ftesën për ofertë është kërkuar ndër të tjera që “*OE duhet te jetë i certifikuar me IATA,... të ketë 10 vite eksperiencë në treg .. si dhe të ketë në stafin e tij jo më pak se 5 punonjës nga të cilët 3 të jenë te pajisur me Certifikata IATA*”. Kriteret e përcaktuara nga AK kufizojnë pjesëmarrjen e biznesit të mesëm dhe të vogël, dhe janë jo në përputhje me Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 i ndryshuar, neni 2, 3 dhe 36, si dhe VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 i ndryshuar, neni 41.Me Procesverbalin e mbajtur në datë 04.11.2022 nga KSDB është kualifikuar si fitues OE “O” i renditur i katërti me vlerën 110,950 lekë pa TVSH, pasi OE e tjerë me vlerë më të ulët nuk kanë dorëzuar rezervimin e biletës ose nuk kanë dërguar itinerarin e udhëtimit sipas ftesës për ofertë. Likuiduar me Urdhër Shpenzimin Nr.221, datë 05.12.2022.

4.Me Urdhër Prokurimin Nr 686, datë 22.11.2022 ka filluar procedura e prokurimit për blerje bileta avioni (SDB) për destinacionin Tirane-Viena-Paris, Paris-Frankfurt-Tirane, në date 30.11.2022 per 3 (cope) bileta avioni.

Gjetje 7. Ne ftesën për ofertë është kërkuar ndër të tjera që “*OE duhet te jetë i certifikuar me IATA,... të ketë 10 vite eksperiencë në treg .. si dhe të ketë në stafin e tij jo më pak se 5 punonjës nga të cilët 3 të jenë te pajisur me Certifikata IATA*”. Kriteret e përcaktuara nga AK kufizojnë pjesëmarrjen e biznesit të mesëm dhe të vogël, dhe janë jo në përputhje me Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020i ndryshuar, neni 2, 3 dhe 36, si dhe VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 i ndryshuar, neni 41. Me Procesverbalin e mbajtur në datë 22.11.2022 nga KSDB është kualifikuar si fitues OE “D” i renditur i pari me vlerën më të ulët të ofruar 105,300 lekë pa TVSH, i cili është likuiduar me Urdhër Shpenzimin Nr.229, datë 06.12.2022.

5. Me Urdhër Prokurimin Nr 284, datë 26.04.2022 ka filluar procedura e prokurimit për blerje bileta avioni (SDB) për destinacionin Tirane-Viene-Bruksel, Bruksel-Tirane, në date 04.05.2022 per 2 (cope) bileta avioni.

Gjetje 8. Ne ftesën për ofertë është kërkuar ndër të tjera se OE “*duhet te jetë i certifikuar me IATA dhe të ketë 10 vite eksperiencë në treg me Certifikata IATA*”. Kriteri i përcaktuar nga AK kufizojnë pjesëmarrjen e biznesit të mesëm dhe të vogël, dhe janë jo në përputhje me Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020i ndryshuar, neni 2, 3 dhe 36, si dhe VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 i ndryshuar, neni 41. Me Procesverbalin e mbajtur në datë 26.04.2022 nga KSDB është kualifikuar si fitues OE “A” i renditur i treti me vlerën 76,130 lekë pa TVSH, pasi OE e tjerë me vlerë më të ulët nuk kanë dorëzuar rezervimin e biletës ose nuk kanë dërguar itinerarin e udhëtimit sipas ftesës për ofertë, i cili është likuiduar me Urdhër Shpenzimin Nr.90, datë 18.05.2022.

6.Me Urdhër Prokurimin Nr 473, datë 12.07.2022 ka filluar procedura e prokurimit per blerje bileta avioni (SDB) për destinacionin Tirane-Geneva, Geneva-Tirane, në date 19.07.2022 per 1 (cope) bileta avioni.

Gjetje 9. Ne ftesën për ofertë është kërkuar nder të tjera që “*OE duhet te jetë i certifikuar me IATA,... të ketë 10 vite eksperienc në treg .. si dhe të ketë në stafin e tij jo më pak se 5 punonjës nga të cilët 3 të jenë te pajisur me Certifikata IATA*”. Kriteret e përcaktuara nga AK kufizojnë pjesëmarrjen e biznesit të mesëm dhe të vogël, dhe janë jo në përputhje me Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020i ndryshuar, neni 2, 3 dhe 36, si dhe VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 i ndryshuar, neni 41. Me Procesverbalin e mbajtur në datë 12.07.2022 nga KSDB është kualifikuar si fitues OE “O” i renditur i pari me vlerën më të ulët të ofruar 58,130 lekë pa TVSH, i cili është likuiduar me Urdhër Shpenzimin Nr.187, datë 26.10.2022.

7. Me Urdhër Prokurimin Nr 421, datë 15.06.2022 ka filluar procedura e prokurimit per blerje bileta avioni (SDB) për destinacionin Tirane-Athine, Athine-Tirane, në date 28.06.2022 per 1 (cope) bileta avioni.

Gjetje 10. Ne ftesën për ofertë është kërkuar nder të tjera që “*OE duhet te jetë i certifikuar me IATA,... të ketë 10 vite eksperienc në treg .. si dhe të ketë në stafin e tij jo më pak se 5 punonjës nga të cilët 3 të jenë te pajisur me Certifikata IATA*”. Kriteret e përcaktuara nga AK kufizojnë pjesëmarrjen e biznesit të mesëm dhe të vogël, dhe janë jo në përputhje me Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020i ndryshuar, neni 2, 3 dhe 36, si dhe VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 i ndryshuar, neni 41.Me Procesverbalin e mbajtur në datë 09.03.2022 nga KSDB është kualifikuar si fitues OE “O” i renditur i pari me vlerën më të ulët të ofruar 68,400 lekë pa TVSH, i cili është likuiduar me Urdhër Shpenzimin Nr.120, datë 07.07.2022.

Për Vitin 2023.

Për vitin 2023 janë nxjerrë urdhrat respektive për ngritjen e komisioneve si me poshtë:
Urdhër Nr.760/3, datë 27.12.2022 “Për Krijimin e Komisionit të Marrjes në Dorëzim të Materialeve”.

Urdhër Nr.149, datë 02.03.2022 “Për Krijimin e Komisionit të Sistemit Dinamik të Biletave të Transportit Ajror Ndërkombëtar ”.

Urdhër Nr.760/4, datë 27.12.2022 “Për Krijimin e Komisionit të Blerjeve nën 100,000 lekë” .
Urdhër Nr.760/1, datë 27.12.2022 “Për Krijimin e Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël”

Për vitin 2023 janë realizuar gjashtë procedura me fond limit pa TVSH 2,302,166 lekë, me vlere te kontratave te lidhura dhe te likuiduara me urdher shpenzimet perkatese ne vleren 2,218,654 lekë me TVSH.

Nga auditimi:

“Blerje materiale Kancelarike dhe Tонера” me të dhënat si më poshtë:

Urdhër Prokurimi Nr.06 Prot, datë 08.02.2023;

Fondi Limit (pa TVSH) 333,333 lekë

Komisioni blerjeve të vogla A. P. (përgjegjës), O. N dhe P. Gj-anëtarë.

Operatori fitues “I” me vlere me ulet te ofertës 213,000 lekë pa TVSH.

“Përlllogaritja e Fondit Limit dhe hartimi i specifikimeve teknike”

Gjetje 1. Me Procesverbalin datë 06.02.2023 është bërë hartimi i specifikimeve teknike duke specifikuar markën në kundërshtim me Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 i ndryshuar, neni 36. Përlllogaritja e fondit limit është bazuar në testimin e tregut duke marre oferta nga tre operatorë në përputhje me VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 i ndryshuar, neni 76.

“Shqyrtimi dhe Vlerësimi i ofertave”-Në datën e zhvillimit të procedurës në SPE kanë shfaqur interes dhe paraqitur oferta 21 Operatorë. Me procesverbalin datë 09.02.2023, rezulton se Operatori “I” është renditur i treti me vlerën 213,000 lekë i cili është shpallur fitues, pasi 2 OE nuk janë paraqitur për të dorëzuar dokumentacionin. OE fitues është likuiduar me Urdhër Shpenzimin Nr.61 datë 20.03.2023 në vlerën 255,600 lekë me TVSH.

“Aktivitetet për 20 Vjetorin e Ligjit Nr.9121 per vitin 2023”.

Urdhër Prokurimi Nr. 64 Prot, datë 21.12.2023;

Fondi Limit (pa TVSH) 675,000 lekë;

Komisioni blerjeve të vogla I. K (përgjegjës), O. N dhe K. K - anëtarë.

Operatori fitues “Xh” me vlerën 232,499 lekë

“Përlllogaritja e Fondit Limit dhe hartimi i specifikimeve teknike”- Në Procesverbalin datë 17.11.2023 është pasqyruar hartimi i specifikimeve teknike dhe përlllogaritja e fondit limit në vlerën 241,183 lekë pa TVSH, duke u bazuar në testimin e tregut për të marrë tregues për çmimet e këtij shërbimi në përputhje me VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 i ndryshuar, neni 76.

“Shqyrtimi dhe Vlerësimi i ofertave”-Në datën e zhvillimit të procedurës në SPE kanë shfaqur interes dhe paraqitur oferta 2 OE, nga ana e Komisionit, me procesverbalin datë 13.12.2023, rezulton se Operatori “Xh” është renditur i pari me vlerën 232,499 lekë dhe është shpallur fitues i cili është likuiduar me Urdhër Shpenzimin Nr.317 datë 21.12.2023 në vlerën 278,999 lekë me TVSH.

“Konferencë nderkombetare me temë “20 vjetori i Ligjit Nr.9121 datë 28.07.2003 Për mbrojtien e konkurrencës 2023”.

Urdhër Prokurimi Nr. 55 Prot, datë 14.11.2023;

Fondi Limit (pa TVSH) 675,000 lekë;

Komisioni blerjeve të vogla A. P (përgjegjës), P. Gj dhe O.N-anëtarë.

Operatori fitues “G” me vlerën 425,000 lekë

“Përlllogaritja e Fondit Limit dhe hartimi i specifikimeve teknike” :

Gjetje 2. Procesverbali për përlllogaritjen e fondit limit është mbajtur datë 13.2.2023, ndërkohë që procesverbali i vlerësimit të ofertave është mbajtur datë 16.11.2023, gabim material (në datë) i cili nuk ndikon në rezultatin e vlerësimit të ofertave apo në llogaritjen e fondin limit. Hartimi i specifikimeve teknike dhe përlllogaritja e fondit limit në vlerën 708,333 lekë pa TVSH, është bazuar në testimin e tregut, ku janë marrë tregues për çmimet e këtij shërbimi në përputhje me VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 i ndryshuar, neni 76.

“Shqyrtimi dhe Vlerësimi i ofertave”

Gjetje 3. Në datën e zhvillimit të procedurës në SPE kanë shfaqur interes dhe paraqitur oferta 3 OE, nga ana e Komisionit, me procesverbalin datë 16.11.2023, rezulton se Operatori “H” është renditur i pari me vlerën 430,000 lekë.

Në praktiken bashkëlidhur nuk ka gjurmë të tërheqjes nga lidhja kontratës të këtij operatori dhe kalimin tek OE “G” i klasifikuar i dyti, i cili është likuiduar me Urdhër Shpenzimin Nr.289 datë 05.12.2023 në vlerën 610,500 lekë me TVSH, jo në përputhje me nenin 56 VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 për “Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

“Dizenjimi i faqes web të AK”.

Urdhër Prokurimi Nr. 17 Prot, datë 05.05.2023;

Fondi Limit (pa TVSH) 158,500 lekë;

Komisioni blerjeve të vogla A. P (përgjegjës), P. Gj dhe O.N-anëtarë.

Operatori fitues “V” me vlerën 149,000 lekë pa TVSH

“Përlllogaritja e Fondit Limit dhe hartimi i specifikimeve teknike”-Me relacionin Nr.197/1 Prot, datë 03.04.2023 është bërë hartimi i specifikimeve teknike dhe përlllogaritja e fondit limit

në vlerën 158,500 lekë pa TVSH duke u bazuar në testimin e tregut për të marrë tregues për çmimet e këtij shërbimi, në përputhje me VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 i ndryshuar, neni 76. **“Shqyrtimi dhe Vlerësimi i ofertave”**-Në datën e zhvillimit të procedurës në SPE kanë shfaqur interes dhe paraqitur oferta 7 OE. Bazuar në procesverbalin datë 08.05.2023, rezulton se Operatori “F” i renditur i pari me vlerën 148,499 lekë është skualifikuar pasi nuk ka paraqitur dokumentacion origjinal ose fotokopje të noterizuara, si dhe është vijuar me OE “V” i renditur i dyti vlerën 149,000 lekë pa TVSH. Likuiduar me Urdhër Shpenzimit Nr.225 datë 20.09.2023.

“Karburant 2023”.

Urdhër Prokurimi Nr.7 Prot, datë 08.02.2023 ;

Fondi Limit (pa TVSH) 666,667 lekë;

Komisioni blerjeve të vogla A. P (përgjegjës), P. Gj dhe O.N-anëtarë.

Operatori fitues “K” me vlerën 660,000 lekë.

“Përlogaritja e Fondit Limit dhe hartimi i specifikimeve teknike” -Me Procesverbalin datë 07.02.2023 është bërë përlogaritja e fondit limit vlerë 666,667 lekë pa TVSH në përputhje me vendimet e bordit të transparencës datë 04.02.2023 i cili shprehet se çmimi i diesel-it është 190 lekë/litri dhe çmimi i benzinës 185 leke/litri.

“Shqyrtimi dhe Vlerësimi i ofertave”-Lidhur me procedurën e blerjes karburant rezultoi se, në datën e zhvillimit të procedurës në SPE kanë shfaqur interes dhe paraqitur oferta 4 OE nga ana e komisionit të prokurimit me vlera të vogla, me procesverbalin datë 09.02.2023 janë skualifikuar 2 OE për shkak se nuk kanë patur si objekt të veprimtarisë tregtimin e karburantit dhe/ose janë paraqitur me vlerë më të lartë se fondi limit. Operatori “E” me vlerën më të ulët i kualifikuar në vend të parë nuk është paraqitur pranë AK për të dorëzuar dokumentacionin, kështu që është vijuar me Operatorin “K” i renditur i dyti, me vlerën 660,000 lekë pa TVSH për të lidhur kontratën e furnizimit Nr 104/2 date 14.02.2023.Likuiduar me Urdhër Shpenzimit Nr.62 datë 20.03.2023 në vlerën 791,805 lekë me TVSH.

“Konferencë Nderkombetare me teme “20 vjetori i Ligjit Nr.9121 datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Gjetje 4. Me Urdhër Shpenzimit Nr.299 datë 18.12.2023 në vlerën 132,750 lekë me TVSH në bazë të urdhër pagesës Nr.711 Prot, datë 15.12.2023 është likuiduar OE “S” PF.

Shpenzimi i sipërm nuk është kryer me prokurim jo në përputhje me VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 i ndryshuar, neni 56 si dhe nuk rezulton të jete hedhur në SPE si procedurë, jo në përputhje me Ligjin Nr.162/2020 **“Për Prokurimin Publik”** i ndryshuar, neni 41, pika 2 dhe neni 56.

Për vitin 2023 nëpërmjet sistemit dinamik të blerjeve për blerje bileta avioni janë shpenzuar 2,152,804 lekë për nevojat e institucionit dhe janë kryer 11 procedura në sistemin SPE. Bazuar në vlerësimin e riskut u përzgjedhën 6 procedura prej tyre me vlerën më të lartë si më poshtë:

1.Me Urdhër Prokurimit Nr 19, datë 02.06.2023 ka filluar procedura e prokurimit për blerje bileta avioni (SDB) për destinacionin Tirane-Athine-Rodos dhe kthimin Rodos-Athine-Tirane në datat 23,29,30 qershor për 11 (cope) bileta avioni.

Me Procesverbal vlerësimin e mbajtur në datë 02.06.2023 nga KSDB është kualifikuar si fitues OE “D” i renditur i pari me vlerën më të ulët të ofruar 599,500 lekë pa TVSH, i cili është likuiduar me Urdhër Shpenzimit Nr.147, datë 13.06.2023.

2. Me Urdhër Prokurimit Nr 52, datë 13.11.2023 ka filluar procedura e prokurimit për blerje bileta avioni (SDB) për destinacionin Armeni-Tirane-Armeni, Budapest-Vien Tirane, Ankara-

Tirane-Ankara,Tblisi-Tirane-Tbilisi,Gjeneve-Tirane-Gjeneve,Bilbao-Tirane-Bilbao, Gjeneve-Tirane-Gjeneve në datat 22,23,22 nentor per 8 (cope) bileta avioni.

Gjetje 5. Ne ftesën për ofertë është kërkuar nder të tjera që “OE duhet të jetë i certifikuar me IATA,... të ketë 10 vite eksperiencë në treg .. si dhe të ketë në stafin e tij jo më pak se 5 punonjës nga të cilët 3 të jenë te pajisur me Certifikata IATA”. Kriteri i përcaktuar nga AK kufizojnë pjesëmarrjen e biznesit të mesëm dhe të vogël, dhe janë jo në përputhje me Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020i ndryshuar, neni 2, 3 dhe 36, si dhe VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 i ndryshuar, neni 41.Me Procesverbalin e mbajtur në datë 13.11.2023 nga KSDB është kualifikuar si fitues OE “D” i renditur i pari me vlerën më të ulët të ofruar 515,300 lekë pa TVSH, i cili është likuiduar me Urdhër Shpenzimin Nr.285, datë 04.12.2023.

3. Me Urdhër Prokurimin Nr 8, datë 08.02.2023 ka filluar procedura e prokurimit për blerje bileta avioni (SDB) për destinacionet Tiranë-Zyrich-Bruksel dhe kthimin Bruksel-Viena-Tiranë në datat 05,9 mars per 8 (cope) bileta avioni.

Gjetje 6.Ne ftesën për ofertë është kërkuar nder të tjera që “OE duhet te jetë i certifikuar me IATA,... të ketë 10 vite eksperienc në treg .. si dhe të ketë në stafin e tij jo më pak se 5 punonjës nga të cilët 3 të jenë te pajisur me Certifikata IATA”. Kriteri i përcaktuar nga AK kufizojnë pjesëmarrjen e biznesit të mesëm dhe të vogël, dhe janë jo në përputhje me Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020i ndryshuar, neni 2, 3 dhe 36, si dhe VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 i ndryshuar, neni 41.Me Procesverbalin e mbajtur në datë 08.02.2023 nga KSDB , OE “A” i renditur i pari me vlerën më të ulët të ofruar 52,648 lekë pa TVSH, nuk është paraqitur pasi kishte nje gabim ne përllogaritjen e vlerës, dhe eshte vijuar me OE “D” me vlerë 372,800 i cili është likuiduar me Urdhër Shpenzimin Nr.63, datë 20.03.2023.

4. Me Urdhër Prokurimin Nr 51, datë 10.11.2023 ka filluar procedura e prokurimit per blerje bileta avioni (SDB)për destinacionet Viene-Tirane-Viene, Budapest-Tirane-Budapest, Londer-Tirane-Athine, Madrid-Tirane-Madrid per 4 (cope) bileta avioni më datat 22.11.2023.

Gjetje 7. Ne ftesën për ofertë është kërkuar ndër të tjera që “*OE duhet te jetë i certifikuar me IATA,... të ketë 10 vite eksperienc në treg .. si dhe të ketë në stafin e tij jo më pak se 5 punonjës nga të cilët 3 të jenë te pajisur me Certifikata IATA*”. Kriteri i përcaktuar nga AK kufizojnë pjesëmarrjen e biznesit të mesëm dhe të vogël, dhe janë jo në përputhje me Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020i ndryshuar, neni 2, 3 dhe 36, si dhe VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 i ndryshuar, neni 41.Me Procesverbalin e mbajtur në datë 10.11.2023 nga KSDB , OE “E” i renditur i pari me vlerën më të ulët të ofruar 189,000 lekë pa TVSH, është tërhequr nga procedura, dhe eshte vijuar me OE “O” me vlerë 206,800 i cili është likuiduar me Urdhër Shpenzimin Nr.287, datë 04.12.2023.

5.Me Urdhër Prokurimin Nr 10, datë 16.03.2023 ka filluar procedura e prokurimit per blerje bileta avioni (SDB për destinacionin Tirane-Frankfurt-Washington dhe kthim Detroit-Chicago-Frankfurt-Tirane per 1 (cope) bileta avioni më datat 20.03.2023.

Gjetje 8. Ne ftesën për ofertë është kërkuar nder të tjera që “OE duhet te jetë i certifikuar me IATA, të ketë 10 vite eksperienc në treg si dhe të ketë në stafin e tij jo më pak se 5 punonjës nga të cilët 3 të jenë te pajisur me Certifikata IATA”. Kriteri i përcaktuar nga AK kufizojnë pjesëmarrjen e biznesit të mesëm dhe të vogël, dhe janë jo në përputhje me Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020i ndryshuar, neni 2, 3 dhe 36, si dhe VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 i ndryshuar, neni 41.Me Procesverbalin e mbajtur në datë 20.02.2023 nga KSDB , OE “A” i renditur i pari me vlerën më të ulët të ofruar 165,880 lekë pa TVSH, nuk u paraqit pranë AK për të dërguar rezervimin e biletës dhe protokollimin e dokumentacionit, dhe eshte vijuar me OE “O” me vlerë 198,000 i cili është likuiduar me Urdhër Shpenzimin Nr.80, datë 07.04.2023.

6. Me Urdhër Prokurimin Nr 50, datë 03.11.2023 ka filluar procedura e prokurimit për blerje bileta avioni (SDB për destinacionin Tiranë-Tbilisi dhe kthim Tbilisi-Tiranë për 1 (copë) bileta avioni më datat 15.11.2023. Me Procesverbal datë 03.11.2023, rezulton se OE "D" është renditur i pari me vlerën më të ulët të ofruar 90,000 lekë pa TVSH. Likuiduar me Urdhër Shpenzimin Nr.269, datë 13.11.2023.

Veprimet e kryera nëpërmjet bankës viti 2021.

Për këtë drejtim të auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Dokumentet bazë të kontabilitetit si: fletëhyrje, fletëdalje, faturë, urdhër-shpenzim.
- Transaksionet e llogarive bankare.
- Pagesa për shërbime e mallra/shërbime, të ndara në disa kontrata me disa grup mallrash apo shërbimesh të ngjashme.

Auditimi i këtij drejtimi u bazua në:

- *Ligjin Nr.10 296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar.*
- *Udhëzim Nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar.*
- *Mandat pagesat dhe mandat arkëtime bashkë me dokumentacionin justifikues të muajve për vitin 2021*
- *Urdhër shpenzimet për të verifikuar veprimet me bankën*

Për vitin 2021, auditimi i veprimeve të kryera nëpërmjet bankës u krye mbi bazë risku duke përzgjedhur si kampion transaksionet financiare me vlerën më të lartë/muaj.

Nga auditimi rezultoi:

Mbi ligjshmërinë dhe saktësinë e plotësimit të dokumentacionit bazë të kontabilitetit (fletëhyrje, fletëdalje, faturë, urdhër shpenzim, etj.) të realizuara nga Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Buxhetit, rezultoi se, veprimet janë kryer konform kërkesave të Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr. 8, datë 9.3.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*" i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr.30, date 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*" i ndryshuar, Ligjit 83/2019 "*Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë"*.

☞ Dokumentacioni i bankës është mbajtur dhe kontabilizuar konform rregullave të kontabilitetit si dhe udhëzimit për menaxhimin financiar dhe kontrollin.

☞ Urdhër-shpenzimet janë bazuar në dokumentacionin justifikues (*si faturat, kontratat e lidhura për blerjet e shërbimeve, procesverbalet dhe aktet e marrjes në dorëzim të mallrave apo shërbimeve*) dhe në çdo rast kanë nënshkrimin e personit të autorizuar në Degën e Thesarit.

☞ Veprimet ekonomike që kryhen nga njësia si dhe faktet që kanë sjellë ose mund të sillnin ndryshime në pasurinë që ato kanë në administrime ruajtje, pasqyrohen me dokumentet përkatëse dhe menjëherë pasi kryhet veprimi.

☞ Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit është bazuar në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim Dokumentet autorizues, Dokumente vërtetues, Dokumente të kontabilitetit, etj.

☞ AK nuk ka pasur detyrime të prapambetura, në kuptim të VKM Nr.50, date 05.02.2014 "*Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit*", përveç një rasti i cili nuk përbën fenomen të përhapur trajtuar në drejtimin e auditimit mbi respektimin e strukturës organizative.

☒ Në 1 rast, rezultoi shkelje e disiplinës buxhetore, konkretisht Urdhër Shpenzimi Nr.174, datë 28.07.2021 ku është tejkualuar afati ligjor parashikuar prej 30 ditë, në likuidimin e faturës, jo në përputhje me Ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e Sistemit Buxhetor” i ndryshuar neni 52 si dhe Ligji Nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” neni 7, i cili nuk është fenomen i përhapur.

☒ Pagesat e realizuara për telefoni celulare, janë kryer në mbështetje të VKM Nr.864 datë 23.07.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë, publikë” pika 1, limiti mujor për likuidim është 13,300 lekë.

☒ Pagesat e realizuara për bonus transporti, janë kryer në mbështetje të Ligjit Nr.10160 datë 15.10.2009 “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë”, të ndryshuar, neni 2, pika 2.

☒ Pagesat e realizuara për komisionet ad hoc, janë kryer në mbështetje të VKM Nr.242 datë 18.03.2015 ndryshuar me VKM Nr.748 datë 19.12.2018, pika 19 sipas të cilës “...Ekspertët pjesëmarrës në KPND shpërblehen me shumën prej 5,000 (pesë mijë) lekë për çdo pjesëmarrje”.

☒ Dokumentacioni justifikues bashkangjitur urdhër shpenzimeve i pasqyruar me datë dhe numër protokollit në to, rast pas rasti nuk administrohej fizikisht në praktikat e audituara, jo në përputhje me Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. Për pagesat për telefoni celulare, në 18 raste mungonte urdhër pagesa, në 3 raste rezultonte vetëm prania e faturës tatimore, në 5 raste praktika nuk përmbante faturën tatimore, në dy raste, (Urdhër shërbim Nr. 175 datë 28.07.2021 dhe Nr. 271 datë 02.11.2021) vlera e përfituar është më e lartë se fatura bashkangjitur, në total 2,100 lekë paguar më tepër për llogari të I. R.

☒ Në 2 raste “Shërbime riparim dere” dhe “Shpenzime për mirëmbajtje të mjeteve të transportit”, pagesa me vlerë totale 238,288 lekë, rezultoi në mungesë mbi argumentimin e nevojës për kryerjen e shërbimit, jo në përputhje me UMF 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar ku specifikohet ...54.Për hyrjet që bëhen nga blerjet me fondet buxhetore, strukturat pergjegjese per financat duhet te kontrollojne ne se fletehyrja ka te bashkelidhur dokumentacionin justifikues perkatës qe verteton marrjen ne dorezim te aktiveve sipas kushteve te kontrates si proces verbal i firmosur nga komisioni, fatura e furnitorit, situacione te shpenzimeve per investimet, fletë hyrje origjinale, proces-verbal i marrjes në dorëzim të mallit, etj.

☒ Pagesa për “Shërbime për sistemimin e dokumentacionit të përpunuar dhe dorëzimi në DPA”, në vlerë fikse 102,000 lekë për kontratë, ka mungesë analize për përcaktimin e vlerës.

☒ Pagesat e kryera për bonus transporti në 4 raste, urdhër shërbimet përmbanin vetëm Urdhër pagesën Nr.66 prot., dt 25.01.2021. Në asnjë rast, nuk bashkangjitej faturë karburanti.

☒ Pagesa kryer për komisionet Ad Hoc, në 3 raste rezultoi se mungonte shkresa drejtuar NA për shpërbimin e ekspertëve pjesëmarrës në procedurë konkurimi.

☒ Pagesat për dieta brenda vendit, janë kryer në reference të VKM Nr.997 datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar. Në një 3 raste në total mungonte urdhër shërbimi (1 rast), autorizimi (1 rast) dhe autorizimi pa ekstremitete (1 rast pa numër protokollit dhe datë).

☒ Në procedurat e blerjeve kryer me bankë me vlerë nën 100.000 lekë, në procesverbalet për marrjen në dorëzim të mallit apo për kryerjen e shërbimit nuk evidentohet specifika e kërkuar, jo në përputhje me Udhëzimin MFE Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pikat 36, 42 dhe 47 ku;

Titullari i njësisë miraton urdhrin për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim te aktiveve te furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe te dokumentacionit shoqërues.

Ne çdo rast komisioni mban një procesverbal në të cilin detajon të dhënat e verifikuara dhe mospërputhjet....

Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato te vlerës, personat që kane urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe te tjera te dhëna te nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative.

Shënim: Gjatë periudhës objekt auditimi, u evidentua problematikë (mungesë dokumentacioni bashkëlidhur urdhër shpenzimeve) në administrimin e dokumentave justifikuese mbi bazën e të cilave është kryer pagesa.

-Janë audituar 23 praktika të pagesave për të rimbursimitin e shërbimit të telefonisë celulare.-

-Janë audituar 5 praktika të pagesave të rimbursimit për bonus transporti.

-Janë audituar 8 praktika të pagesave të kryera për Komisionet Ad Hoc

-Janë audituar 8 praktika të pagesave të kryera për dieta brenda vendit.

Me urdhër shpenzimet respektive Nr. 40 datë 04.03.2021, Nr. 69 datë 07.04.2021, Nr. 172 datë 28.07.2021, Nr. 258 datë 08.10.2021, dhe Nr. 281 datë 17.11.2021 **“Blerje kafeje për pritje përcjellje”**, në total për zërin pritje përcjellje janë shpenzuar 84,000 lekë.

Procesverbali i marrjes në dorëzim nuk përmban detaje dhe nuk evidentohet asnjë e dhënë për këto specifika, duke e bërë të paqartë se me çfarë specifikimesh apo kriteresh bëhet krahasimi në momentin e marrjes në dorëzim të tyre, por deklarohet vetëm se shërbimi/malli është sipas specifikave të kërkuara. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me pikat 36, 42 dhe 47 të Udhëzimit Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar ku specifikohet **“Titullari i njësisë miraton urdhrin për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim te aktiveve te furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe te dokumentacionit shoqërues. Ne çdo rast komisioni mban një procesverbal në të cilin detajon të dhënat e verifikuara dhe mospërputhjet....Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato te vlerës, personat që kane urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe te tjera te dhëna te nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative”**.

“Shërbime riparim dere”.

Procesverbali i marrjes në dorëzim, pa datë dhe pa specifikuar shërbimin e kryer nuk specifikohet shërbimi/prodkti i marre, sikundër as në faturën tatimore nuk rezulton detajim për të kuptuar se për çfarë është kryer kjo pagesë konkretisht. (Komisioni i përbërë nga I. Dh, K. K, K. Q.)

Likujduar me Urdhër Shpenzimi Nr.170 datë 28.07.2021 me vlerë 87,200 lekë.

Bashkangjitur Urdhër Shpenzimit:

-Procesverbal të marrjes në dorëzim datë 13.07.2021

-Urdhër pagesë 356 datë 26.07.2021

-Faturë Nr.10/20221 datë 13.07.2021

Mungon argumentimi nevojës së kryerjes së shërbimit dhe po ashtu nga ana e grupit të marrjes në dorëzim të shërbimit apo mallit është hartuar procesverbali më tepër në trajtë formale për marrjen në dorëzim, në të cilat deklarohet se shërbimi/malli është sipas specifikave të kërkuara dhe nuk evidentohet asnjë e dhënë për këto specifika, duke e bërë të pa qartë se me çfarë specifikimesh apo kriteresh bëhet krahasimi në momentin e marrjes në dorëzim të tyre.

Veprimet e mësipërme kryhen në kundërshtim me pikat 36, 42 dhe 47 të Udhëzimit Nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”

“Larje dhe Parkim Automjeti”.

Procesverbali i marrjes në dorëzim, pa datë. (Komisioni i përbërë nga I.Dh., K. K, K. Q)
Likujduar me Urdhër Shpenzimi Nr.173 datë 03.08.2021 me vlerë 120,000 lekë.

Urdhër Pagesë Nr.358 prot., datë 26.07.2021

Kërkesa, drejtuar komisionit të blerjeve të vogla, mbi nevojat për larje automjeti dhe parkim për v.2021

Referuar praktikës dokumentare, rezultojë se

-procesverbali marrjes në dorëzim është vetëm për shërbimin “larje automjeti”

-urdhër pagesa referon edhe larje automjeti edhe parkim.

-fatura tatimore referon biznesin me objekt veprimtarie “Lavazh” që nënkupton kryerjen e vetëm shërbimit të larjes së automjetit.

“Blerje pajisje informatike”.

Procesverbali i marrjes në dorëzim, pa datë. (Komisioni i përbërë nga I.Dh, K. K, K. Q).

Likujduar me Urdhër Shpenzimi Nr.174 datë 28.07.2021 me vlerë 100,000 lekë.

-Urdhër Pagesë Nr.359 prot., datë 26.07.2021

-Fletë Hyrje Nr.14 me korrigjim date, nga data 26.06.2021 në 06.07.2021

-Fatura tatimore Nr.34/2021 datë 06.07.2021

Referuar praktikës dokumentare, rezultojë se

-Fletë hyrja në dokumentat e cituara si bashkangjitur urdhër shpenzimit rezultonte pa datë.

Konstatim: Fatura është lëshuar më datë 15.06.2021 me afat maturimi 06.07.2021 dhe pagesa është kryer më 28.07.2021 duke kaluar afatin 30 ditor, por për të nuk është marr penalitet.

Nga grupi për marrjen në dorëzim të shërbimit/mallit është hartuar procesverbali pa evidentuar asnjë të dhënë specifike, duke e bërë të pa qartë se me çfarë specifikimesh apo kriteresh bëhet krahasimi në momentin e marrjes në dorëzim të tyre, por vetëm deklarohet se shërbimi/malli është sipas specifikave të kërkuara.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me pikat 36, 42 dhe 47 të Udhëzimit Nr. 30, datë 27.12.2011 i ndryshuar.

“Shpenzime për mirëmbajtje të mjeteve të transportit fokus”.

Totali për shërbimin e mirëmbajtjes së mjeteve të transportit rezulton në 151,088 lekë

Nga ana e AK ky shërbim është kryer në mënyrë të veçantë për të dy automjetet dhe në dy periudha të ndryshme

Dhjetor 2021:

Automjeti Focus

Praktika dokumentare shoqëruese e urdhër shpenzimit Nr.263 datë 08.10.2021 me vlerë 28,368 lekë përmban:

-Procesverbali i marrjes në dorëzim, datë 29.09.2021 (nënshkruar nga shoferi), pa specifikuar llojin e shërbimit të kryer

-Urdhër Pagesë Nr.187/7 prot., datë 07.10.2021

-Faturë Nr.1904/2021 datë 29.09.2021

Automjeti Hyndai

Praktika dokumentare shoqëruese e urdhër shpenzimit Nr.312 datë 28.12.2021 me vlerë 95,000 lekë përmban:

-Procesverbali i marrjes në dorëzim, pa datë. (nënshkruar nga 2 nga 3 anëtarët e komisionit të marrjes në dorëzim dhe shoferi)

-Urdhër Pagesë Nr.548 prot., datë 28.12.2021

-Faturë Nr.1/2021 datë 24.12.2021 (faturë përmbledhëse (ndërrim testate, vaj, filtra) e padetajuar vlera për çdo shërbim të kryer).

Prill 2021:

Automjeti Focus

Praktika dokumentare shoqëruese e urdhër shpenzimit Nr.70 datë 07.04.2021 me vlerë 19,560 lekë përmban:

-Procesverbali i marrjes në dorëzim, pa datë
-Urdhër Pagesë Nr.187 prot., datë 06.04.2021
-Faturë Nr.1256/2021 datë 24.03.2021 ku detajohen në zëra shërbimi i kryer
Automjeti Focus

Praktika dokumentare shoqëruese e urdhër shpenzimit Nr.252 datë 14.09.2021 me vlerë 8,160 lekë përmban:

-Procesverbali i marrjes në dorëzim, pa datë, blerë më datë 27.07.2021 vaji motori
-Urdhër Pagesë Nr.417 prot., datë 13.09.2021
-Faturë Nr.162/2021 datë 27.07.2021 ku detajohet produkti vaji motorri

Pagesë e kryer rezulton në muajin shtator 14.09.2021, fatura e lëshuar në muajin korrik 27.07.2021. Kaluar afati 30 ditor.

Sa i takon shpenzimeve të kryera për mirëmbajtje të mjeteve të transportit rezulton se, mungon argumentimi nevojës së kryerjes së shërbimit dhe dokumentimi i shërbimit të kryer.

Nga ana e grupit të marrjes në dorëzim të shërbimit apo mallit është hartuar procesverbali më tepër në trajtë formale për marrjen në dorëzim, në të cilat deklarohet se shërbimi/malli është sipas specifikave të kërkuara dhe nuk evidentohet asnjë e dhënë për këto specifika, duke e bërë të pa qartë se me çfarë specifikimesh apo kriteresh bëhet krahasimi në momentin e marrjes në dorëzim të tyre.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me pikat 36, 42 dhe 47 të Udhëzimit Nr. 30, datë 27.12.2011 i ndryshuar.

“Shërbime për sistemin e dokumentacionit të përpunuar dhe dorëzimi në DPA”.

Marrëveshja për shërbimin e përpunimit të dokumentacionit për arkivë lidhur më 14.04.2021, janë lidhur 3(tre) kontrata shërbimi të ndryshme të cilat kanë objekt përpunimi dokumentacionin e viteve të ndryshme kështu:

1. Kontrata Nr.23 prot., datë 13.01.2021 për përpunimin e dokumentacionit të vitit 2008,
2. Kontrata Nr.23/2 prot., datë 14.04.2021 për përpunimin e dokumentacionit të vitit 2009,
3. Kontrata Nr.23/3 prot., datë 01.07.2021 për përpunimin e dokumentacionit të vitit 2010.

në kontratë shërbimit neni 1 *Qëllimi i Kontratës* është specifikuar veç të tjerash *...përpunimi tekniko shkencor i dokumenteve, inventarizimi i tyre, dorëzimi i dokumentave RHK të vitit 2010 në AQSH.*

Pagesa e përcaktuar si vlerë fikse 102,000 lekë për kontratë, së cilës i ndalet TAP.

Për kryerjen e këtij shërbimi përgjatë vitit 2021 janë kryer 3 pagesa me vlerë totale sipas kontratës dhe urdhër shpenzimeve prej 306,000 lekë. Referuar praktikës dokumentare vendosur në dispozicion rezultojë se:

-Likujdim kryer me Urdhër Shpenzimi Nr.205 datë 03.09.2021 me vlerë 102,000 lekë mbi bazë të kontratës 23/3 datë 01.07.2021

-Likujdim kryer me Urdhër Shpenzimi Nr.71 datë 13.04.2021 me vlerë 102,000 lekë mbi bazë të kontratës 23 datë 13.01.2021

-Likujdim kryer me Urdhër Shpenzimi Nr.142 datë 08.06.2021 me vlerë 102,000 lekë mbi bazë të kontratës 23/2 datë 14.04.2021

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, funksionon sektori i Protokoll arkivës.

- Me Autorizimet respektive Nr.220/3 prot., datë 15.06.2021, Nr.394/3 prot., datë 26.10.2021 dhe Nr.478/3 prot., datë 11.01.2022, nga Sekretari i Përgjithshëm, është autorizuar znj. E. K, me detyrë specialiste e sekretari arkivës, të dorëzojë në Arkivin Qendror të Shtetit dokumentet me rëndësi historike kombëtare (RHK) të vitit 2008, 2009 dhe 2010.

Konstatim: Nga auditimi rezultojë mungesë e përcaktimit të vlerës 102,000 lekë si pagesë për shërbimin e ofruar nëse do ta trajtonim si fond limit.

Gjithashtu ka problematikë në administrimin e dokumentacionit justifikues të pagesave. Për këto raste auditimi u krye duke marrë dokumentat nga arkiva e institucionit.

Urdhër Shpenzimet e përzgjedhura u audituan në funksion të Udhëzimit të Ministrisë së Financave (UMF) Nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik*” i ndryshuar, veçanërisht sa i takon regjistrimit të veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazuar në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim si; *Dokumentet autorizues, Dokumente vërtetues, Dokumente të kontabilitetit, etj.*

Në kuptimin e VKM Nr.50, date 05.02.2014, detyrime të prapambetura konsiderohen detyrimet e përcaktuara në një ligj/marrëveshje/vendim gjykatë të formës së prerë që mbeten të papaguara 30 ditë pas datës së specifikuar në kontratë apo ligj.

Nga auditimi rezulton se, nuk ka pasur detyrime të prapambetura nga ana e Autoritetit të Konkurrencës, përveç një rasti i cili nuk përbën fenomen të përhapur dhe cdo veprim është kryer në afatet e parashikuara sipas ligjit.

Në këtë kuptim, grupi i auditimit me zgjedhje kreu testimet për të identifikuar pagesat e kryera për periudhën janar - dhjetor për vitet 2021-2023 me datën e urdhër shpenzimit mbi 30 ditë, nga data e lëshimit të faturës së furnitorit, bazuar në Ligjin Nr.48/2014 “*Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare*” neni 7, afatet për autoritet publike, pika a) *parashikon që kalimi i likuiditetit tek kreditori duhet të bëhet brenda 60 ditëve kalendarike, duke parashikuar dhe 30 ditë për procedurat e aprovimit në njësinë shpenzuese dhe 30 ditë për procedurat e miratimit dhe procesimit të pagesës në degën e thesarit*”.

Konkluzion: Nga auditimi me përzgjedhje i veprimeve të kryera nëpërmjet bankës rezultoi se në mënyrë të përsëritur për vitin 2021, dokumentacioni justifikues i cili duhet ti bashkangjitet urdhër shpenzimeve, i pasqyruar me datë dhe numër protokoll në kolonën përkatëse, nuk ishte bashkëlidhur praktikave, veprime në kundërshtim legjislativonin tatimor dhe Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave (UMF) Nr. 30, datë 27.12.2011 i ndryshuar.

Anekse-aneksi Nr.2/1” Veprimet e kryera me arkë për pagesën e dietave jashtë vendit v.2022.

Per vitin 2022, veprimet e kryera me arkë, për pagesat e dietave jashtë vendit në valute (total 790,850 leke e konvertuar) bëhen me urdhër shpenzimet përkatëse pasqyruar në seksionin “Anekse-aneksi Nr.2/1”, bashkëlidhur Raport auditimit.

Me autorizimin për dorëzim valute Nr.764 Prot, datë 30.12.2022 (K. Gj) ka depozituar diferencën në valutë për shkak të mbylljes së gjendjes së arkës më datë 31.12.2023 shumën e 286 Euro me konvertim në lekë 31,803 (diferencë pas veprimeve të kryera me cash për pagesën e dietave jashtë vendit.

Konkluzion: Të gjitha pagesat e kryera nëpërmjet arkës në valutë gjatë vitit 2022 për mbulimin e shpenzimeve për pjesëmarrjen në aktivitete jashtë vendit, janë kryer në përputhje me VKM 870, datë 14.12.2011 “*Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit*” dhe Udhëzimin Nr.22, datë 10.07.2013 “*Mbi Zbatimin e VKM 870, datë 14.12.2011 Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit*”, duke kryer sipas rastit, paradhënie apo kthim shume.

Anekse-aneksi Nr.2/2” Veprimet e kryera me arkë për pagesën e dietave jashtë vendit v.2023”

Per vitin 2023, veprimet e kryera me arkë, për pagesat e dietave jashtë vendit ne valute (total 2,144,360 leke e konvertuar) bëhen me urdhër shpenzimet përkatëse pasqyruar në seksionin “Anekse-aneksi Nr.2/2”, bashkelidhur Raport auditimit.

Me autorizimin për dorëzim valute Nr.734 Prot, datë 26.12.2023 z.K.Gj. ka depozituar diferencën në valutë per shkak të mbylljes së gjendjes së arkës më datë 31.12.2023 shumën e 525 Euro me konvertim në lekë 52,920 (diferencën pas veprimeve të kryera me cash për pagesën e dietave jashtë vendit).

Konkluzion: Të gjitha pagesat e kryera nëpërmjet arkës në valutë gjatë vitit 2023 për mbulimin e shpenzimeve për pjesëmarrjen në aktivitete jashtë vendit, janë kryer në përputhje me VKM 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit” dhe Udhëzimit Nr.22, datë 10.07.2013 “Mbi Zbatimin e VKM 870, datë 14.12.2011 Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit” duke kryer sipas rastit paradhënie apo kthim shume.

2.5 Auditimi i procedurave të prokurimit publik.

Në zbatim të pikës 5 të programit të auditimit Nr. 506/1, datë 15.04.2024, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

-Dosjet e prokurimit për periudhën 2021-2023.

-Sistemi elektronik i prokurimeve (SPE) në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik.

Auditimi i këtij drejtimi u bazua në:

-Ligjin Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe të gjitha aktet e dala në zbatim të tij (VKM, udhëzime APP-së etj.)

Në Autoritetin e Konkurrencës për vitet 2021-2023, në zbatim të detyrimit ligjor përcaktuar në legjislacionin e prokurimit publik, për çdo viti buxhetor me urdhër të titullarit të autoritetit kontraktor, ngrihet njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit/Njësia e Prokurimit, pasi nuk ka një strukturë të mirëfilltë të Sektorit të Prokurimeve.

Për periudhën objekt auditimi, nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti si dhe nga auditimi në SPE i regjistrit të realizimeve të procedurave të prokurimit paraqitet rezulton:

Për vitin 2021, janë realizuar 6 procedura prokurimi (*blerje me vlerë të vogël*), me vlerë totale të kontratave të realizuara 3,202,440 lekë me TVSH dhe fond limit 2,373,499 lekë pa TVSH, (sipas të dhënave në Tabelën 1.

Tabela 1

Viti 2021

Në lekë

Nr. proc.	Lloji procedurës prokurimit	Fondi limit pa TVSH	Vlera kontratës pa TVSH	Vlera kontratës me TVSH
6	Blr.të vogël	2,373,499	2,668,700	3,202,440
6	Totali	2,373,499	2,668,700	3,202,440

Burimi: AK(të dhënat nga regjistrat e realizimit të prokurimeve dhe SPE)

Për vitin 2022, janë realizuar 9 procedura prokurimi (*blerje me vlerë të vogël dhe system dinamik blerje bileta avioni*), me vlerë totale të kontratave të realizuara 2,555,930 lekë me TVSH dhe fond limit 4,865,000 lekë pa TVSH.

Procedurat sipas llojit paraqiten në Tabelën 2.

Tabela 2**Viti 2022***Në lekë*

Nr.proc.	Lloji procedurës prokurimit	Fondi limit pa TVSH	Vlera kontratës pa TVSH	Vlera kontratës me TVSH
6	Blr.të vogël	2,520,001	1,925,600	2,310,720
3	sistem dinamik blerje	2,344,999	245,210	245,210
9	Totali	4,865,000	2,170,810	2,555,930

Burimi: AK (të dhënat nga regjistrat e realizimit të prokurimeve dhe SPE)

Për vitin **2023**, janë realizuar 12 procedura prokurimi, me vlerë totale të kontratave të realizuara 7,147,860 lekë me TVSH dhe fond limit 10,589,722 lekë pa TVSH.

Procedurat sipas llojit dhe realizimit jepen në Tabelën 3.

Tabela 3**Viti 2023***Në lekë*

Nr.proc.	Lloji procedurës prokurimit	Fondi limit pa TVSH	Vlera kontratës pa TVSH	Vlera kontratës me TVSH
6	Blr.të vogël	2,302,166	1,848,249	2,217,899
4	sistem dinamik blerje	4,120,889	410,800	410,800 (pa TVSH)
2	T,Hapur i thjeshtuar	4,166,667	3,765,967	4,519,161
12	Totali	10,589,722	6,025,016	7,147,860

Burimi: AK (të dhënat nga regjistrat e realizimit të prokurimeve dhe SPE)

Gjetja 1. Regjistri i realizimeve për prokurimet publike hartuar nga AK për periudhën objekt auditimi, nuk jep të dhëna të plota në lidhje me realizimin e procedurave të prokurimit me vlerë nën 100,000 lekë, jo në përputhje me VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit public” i ndryshuar neni 11, pika 3, paragrafi 1, por pasqyron vetëm realizimin e procedurave që gjeneron sistemi elektronik i prokurimeve deri te procedurat me blerje të vogël, kompetencë kjo e personit përgjegjës për prokurimet. Pavarësisht se këto lloj prokurimesh (blerje nën 100,000 lekë) nuk i nënshtrohen prokurimit, planifikimi i tyre dhe vlerat përkatëse, duhet të pasqyrohen në regjistrin e parashikimeve dhe të realizimeve. Mos veprimi nga personi përgjegjës për prokurimin në zbatim të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 neni 74, pika 3, germa”a”, ka sjellë që regjistri i realizimeve të ketë të dhëna jo të plota për realimin e prokurimeve me vlerë nën 100,000 lekë, e cila për nga niveli i rëndësisë është e ulët.

Viti 2023.

Nga auditimi i njëpasnjëshëm i procedurave të prokurimit (T. Hapur i thjeshtuar) me vlerën më të lartë të kontratave të lidhura 4,519,160.4 lekë me TVSH u konstatua:

Tenderi me objekt “**Blerje pajisje zyrash dhe informatike për nevoja të AK**”, me të dhënat:

Procedura e Prokurimit “Blerje pajisje zyrash dhe informatike për nevoja të AK”		
1.Urdhër Prokurimit: Nr.31, dt 21.08.2023	3.HDT/Njësia e prokurimit: Urdhri Nr.31, dt 21.08.2023 A. P. O. N. P. Gj. Urdhri Nr.413, dt 20.07.2023 (për llogaritjen e fondit limit) A. K., M. K. K. Gj.	4.KVO Urdhër Nr.32, date 21.08.2023 M. Y. V. S. V. V.
2.Lloji i Procedurës së Prokurimit: T.H. Thjeshtuar		
5.Fondi Limit Total (pa TVSH) 1,250,000 lekë	6.Oferta fituese (pa TVSH) 849,300 lekë pa TVSH/	7.Diferenca me fondin limit

		400,700 lekë pa TVSH
8. Data e hapjes së tenderit 08.09.2023 ndryshuar 08.10.2023	9.Fonde të Buxhetit Shtetit	10. OE/ Pjesëmarrës 8. (fitues) “E” 1,019,160 lekë me TVSH

Burimi: Të dhënat AK dhe sistemi elektronik i prokurimeve (SPE)

Planifikimi i nevojave për prokurim- Planifikimi i nevojave për prokurim është parashikuar në hartimin e kërkesave buxhetore PBA 2021 si dhe në regjistrin e parashikimeve për vitin 2023.

Llogaritja e fondit limit-Me Urdhërin Nr. 413, datë 20.07.2023 është ngritur grupi i punës për llogaritjen e fondit limit i cili i është referuar studimit paraprak të tregut në përputhje me Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 34 dhe 35 si dhe VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit public” i ndryshuar neni 12,13 dhe 76, duke marrë oferta nga 3 operatorë ekonomikë dhe llogaritur mesataren e tyre. Në procesverbalin datë 25.07.2023 për llogaritjen e fondit limit, vërehen gabime materiale në përcaktimin e referencës ligjore pasi i referohen nenit 59 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar dhe jo nenit 12. Gabimi material në bazën ligjore nuk ka ndikuar në vlerësimin e metodës së përzgjedhur për përllogaritjen e fondit limit. (*Grupi për llogaritjen e fondit limit: A. K, M. K dhe K. Gj.*)

Nxjerrja e urdhër prokurimit-Në zbatim të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 i ndryshuar, neni 77, VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar neni 73, pika 1,2 dhe 76, titullari i AK/personi i autorizuar (*Drejtor i Drejtorisë së Analizës dhe metodologjisë së Tregjeve Dh.S.*) ka nxjerrë Urdhër Prokurimin Nr.31, datë 21.08.2023 për zhvillim e procedurës së prokurimit “Tender i Hapur i thjeshtuar” me objekt “Blerje pajisje zyrash dhe informatike për nevoja të AK”, me fond limit 1,250,000 lekë pa TVSH, për të cilën është ngarkuar Njësia e Prokurimit për ndjekjen dhe zbatimin e procedurës.

Hartimi i dokumenteve të tenderit/kriteret e veçanta për kualifikim-Njësia e prokurimit ka hartuar DT/kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim duke iu referuar VKM Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar. (*Procesverbali datë 07.09.2023.*)

Gjetja 2. AK ka zgjedhur si procedurë prokurimi “Tender të Hapur të Thjeshtuar”, por në vendosjen e kriterëve nuk janë mbajtur në konsideratë kriteret e thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm.

Për kriterin 2.2 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” është kërkuar: *-kopje e bilanceve të viteve 2021 dhe 2022 të konfirmuar nga Administrata Tatimore” dhe “kopje të deklaratave të xhiros vjetore për vitet 2021 dhe 2022 me vlerë minimalisht sa 90% e fondit limit të kontratës që prokurohet për secilin vit”,* kriteret jo në përputhje me VKM Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar neni 55, pika 5, pasi kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i tyre mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës.Kjo ka sjellë kufizim të pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm, që për nga rëndësia është e nivelit të mesëm.

Në lidhje me DT të publikuar në faqen zyrtare të APP, OE “B” ka bërë ankim pranë AK dhe KPP në lidhje me kriteret e vendosura. Në përfundim AK, me Vendimin Nr.1, datë 18.09.2023 ka vendosur të marrë në konsideratë ankesën duke bërë ndryshimet në shtojcën 7, pika 2.2, si dhe KPP me Vendimin Nr.952/2023 datë 22.09.2023 ka vendosur të mbyllë çështjen për

ankesën e paraqitur nga OE, AK të publikojë shtojcën për ndryshime në DT në përputhje me vendimin Nr.1, datë 18.09.2023 të zyrtarit të autorizuar të AK.

Vlerësimi i Ofertave-Në hapjen publike të ofertave në sistemin elektronik të prokurimit (SEP) rezulton të kenë shpallur interes dhe paraqitur oferta 8 OE:

-M	me vlerë 792,000 lekë pa TVSH
-E	me vlerë 849,300 lekë pa TVSH
-El	me vlerë 881,000 lekë pa TVSH
- R	me vlerë 937,600 lekë pa TVSH
-O	me vlerë 1,030,000 lekë pa TVSH
-A	me vlerë 1,062,500 lekë pa TVSH
-X	me vlerë 1,078,000 lekë pa TVSH
-B	me vlerë 1,444,500 lekë pa TVSH

Nga KVO pas shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave të paraqitura, ka skualifikuar 5 nga 8 operatorë. Ofertat: *E-849,000 lekë, O-1,030,000 lekë dhe A-1,062,500 lekë*, për të cilat ka vijuar me verifikimin nëse kanë gabime aritmetike dhe nëse rezulton të ketë oferta anomalisht të ulta, në përputhje me nenin 92 dhe 93 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 i ndryshuar dhe VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar neni 82, pika 3 dhe 4. Në përfundim, është kualifikuar në vend të parë oferta me vlerën më të ulët E -849,300 lekë pa TVSH nga 3 ofertat e kualifikuara. Në lidhje me afatin e dorëzimit të ofertave nga OE “B” është bërë ankim pranë AK dhe KPP për shtyrje të afatit të dorëzimit të ofertave. AK ka refuzuar ankesën me Vendimin Nr.2, datë 17.10.2023 si dhe KPP me Vendimin Nr.1074, datë 25.10.2023 ka vendosur të lejojë AK për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit. Në datën e hapjes publike të ofertave në SEP, ky operator nuk kishte ngarkuar në system ofertë.

Në dosje nuk rezulton të ketë Formular të njoftimit të fituesit, jo në përputhje me VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar neni 83, kompetencë e personit përgjegjës për prokurimet në zbatim të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar neni 74, pika 1.

Lidhja dhe zbatimi i kontratës-Me OE “E” fitues me vlerë oferte më të ulët është lidhur kontrata Nr.413/32, datë 22.11.2023 me vlerë 849,000 lekë pa TVSH/1,019,160lekë me TVSH, me afat 30 ditë nga nënshkrimi i kontratës.

Me Urdhërin Nr.413/33, datë 04.12.2023 të titullarit të AK (person i autorizuar) është ngritur Komisioni (A. K, K. Gj dhe K. K) për marrjen në dorëzim të mallrave dhe mbikqyrjen e zbatimit të kontratës. Komisioni me procesverbalin Nr.413/34, datë 14.12.2023 ka konfirmuar se mallrat objekt kontrate janë sipas sasisë, vlerës dhe specifikimeve teknike të DT si dhe janë bërë hyrje në magazinë me fletë hyrje Nr.32, datë 06.12.2023 duke u likuaduar operatori.

Tenderi me objekt “**Blerje autoveture e re për nevojat e Autoritetit të Konkurrencës**”, me të dhënat:

Procedura e Prokurimit “Blerje autoveture e re për nevojat e Autoritetit të Konkurrencës”		
1.Urdhër Prokurimit: Nr.14, dt 05.05.2023	3.HDT/Njësia e prokurimit: Urdhri Nr.14, dt 05.05.2023 A. P. O. N. P. Gj. Urdhri Nr.255, datë 20.04.2023 për llogaritjen e fondit limit G. D. B. Y. O. N.	4.KVO-Urdhër Nr.15, datë 05.05.2023 V. V. D. Ll. K. Q.
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: T.H. Thjeshtuar		
5.Fondi Limit Total (pa TVSH) 2,916,667 lekë	6.Oferta fituese (pa TVSH) 2,900,000 lekë	7.Diferenca me fondin limit 16,667 lekë

8. Data e hapjes së tenderit 05.06.2023	9.Fonde të Buxhetit Shtetit	10. OE/ Pjesëmarrës 1. A(fitues) 2,900,000 lekë/3,480,000 lekë me TVSH
---	-----------------------------	--

Burimi: Të dhënat AK dhe sistemi elektronik i prokurimeve (SPE)

Planifikimi i nevojave për prokurim-Planifikimi i nevojave për prokurim është parashikuar në hartimin e kërkesave buxhetore PBA 2021 si dhe në regjistrin e parashikimeve për vitin 2023.

Llogaritja e fondit limit-Me Urdhrin Nr.255 prot., datë 20.04.2023 të ish Sekretarit të Përgjithshëm në cilësinë e titullarit të AK (*deleguar me autorizimin Nr.46, prot., datë 18.01.2022 të Kryetarit të AK*) është ngritur grupi i punës për llogaritjen e fondit limit dhe hartimin e specifikimeve teknike.

Gjetja 3. Emërimi i kryetarit të grupit për llogaritjen e fondit limit nuk është në përputhje me VKM-në Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar neni 74, pika 2 dhe 4, pasi nuk është me arsim të lartë (shofer), si dhe specialisti i fushës B.Y. (i jashtëm) me detyrë inxhinier, nuk rezulton të ketë marrë pjesë në hartimin e specifikimeve teknike e për pasojë, nuk ka nënshkruar procesverbalin përkatës datë 03.05.2023.Në këto kushte grupi ka funksionuar me 2 anëtarë dhe jo me numër tek anëtarësh, jo në përputhje me VKM-në Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar neni 74, pika 2, *veprime të cilat janë kompetencë e ish Sekretarit të Përgjithshëm në cilësinë e titullarit të AK, bazuar në VKM-në Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar neni 73, pika 1.*

-Llogaritja e fondit limit nuk është argumentuar nga grupi i punës (*Procesverbali datë 03.05.2023*), si dhe nuk është pasqyruar metoda e përzgjedhur në përlllogaritjen fondit, jo në përputhje me VKM-në Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar neni 13, pika 1,2 si dhe neni 12, pika 4 dhe neni 76, ku përcaktohet qartë se *”1.Përpara se të nisë një procedurë prokurimi, autoriteti/enti kontraktor mund të studiojë tregun, me qëllim që të përgatisë prokurimin, të përditësojë të dhënat që ka përdorur për hartimin e buxhetit dhe regjistrave të parashikimit, si dhe të informojë operatorët ekonomikë për planet dhe kërkesat e tyre për prokurim.*

-*“Studimi i tregut ka për qëllim përlllogaritjen e një vlere reale të kontratës dhe të shmangë dështimin e procedurës për vlere që nuk përputhen me vlerat reale të tregut”.* Në dosje nuk ka gjurmë të marrjes ofertave nga operatorët minimumi 3, veprim ky në kompetencë të grupit për llogaritjen e fondit limit. Komisioni në procesverbal është shprehur se *“...i është referuar çmimeve të tregut. Nisur nga fondi limit i vënë në dispozicion, vlere e kontratës nuk mund të tejkalojë këtë fond.... Si fond limit i kontratës do të merret vlere e disponueshme prej 2,916,667 lekë pa TVSH”* si dhe neni 12. Veprimt e sipërme për nga rëndësia janë të nivelit të mesëm.

Nxjerrja e urdhër prokurimit-Në zbatim të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 i ndryshuar, neni 77, VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar neni 73, pika 1,2 dhe 76, titullari i AK/ish SP ka nxjerrë Urdhër Prokurimin Nr.14, datë 05.05.2023 për zhvillim e procedurës së prokurimit *“Tender i Hapur i thjeshtuar”* me objekt *“Blerje autoveture e re për nevojat e Autoritetit të Konkurrencës”*, me fond limit 2,916,667 lekë pa TVSH, për të cilën është ngarkuar Njësia e Prokurimit për zbatim.

Hartimi i dokumenteve të tenderit/kriteret e veçanta për kualifikim-Njësia e prokurimit ka hartuar DT/kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim duke iu referuar VKM Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar. (*Procesverbali datë 17.05.2023*).

Gjetja 4. AK ka zgjedhur si procedurë prokurimi *“Tender të Hapur të Thjeshtuar”*, por në vendosjen e kriterëve nuk janë mbajtur në konsideratë kriteret të thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm.

Për kriterin 2.2 "Kapaciteti ekonomik dhe financiar" është kërkuar -kopje e bilanceve të viteve 2021 dhe 2022 të konfirmuar nga Administrata Tatimore" dhe "kopje të deklaratave të xhiros vjetore për vitet 2021 dhe 2022 me vlerë minimalisht sa 90% e fondit limit të kontratës që prokurohet për secilin vit", jo në përputhje me VKM Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar neni 55, pika 5, pasi kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i tyre mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës. Vendosija e kriterëve jo të thjeshtuara në DT ka sjellë si pasojë mos nxitje të pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm, që për nga rëndësia janë të nivelit të mesëm.

Vlerësimi i Ofertave-Në hapjen publike të ofertave në sistemin elektronik të prokurimit (SEP) rezultoi të ketë shpallur interes dhe paraqitur ofertë vetëm 1 OE: A, me ofertë 2,900,000 lekë pa TVSH.

Gjetja 5. Në procesverbalin Nr.2, datë 05.06.2023, të KVO mbi shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave, vërehen gabime materiale në pasqyrimin e vlerës së ofertës fituese. KVO është shprehur se "Nga dokumentet e shkarkuar për këtë operator ekonomik (A), ...Ofertë ekonomike 2,916,667,00 lekë", ndërkohë që në SPE, rezultoi oferta e paraqitur nga OE datë 18.09.2023 me vlerë 2,900,000 pa TVSH/3,480,000 me TVSH.

Gabimi material në vlerë i pasqyruar në këtë procesverbal është mbartur dhe në të gjithë aktet e tjera të mbajtura nga KVO si në:

-Vendimin Nr.1, datë 05.06.2023 të KVO për vlerësimin e ofertave dhe shpalljen përfundimtare;

-Raportin përmbledhës Nr.255/8, datë 07.06.2023 mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit paraqitur për miratim të zyrtari i autorizuar i AK;

-Formulari i njoftimit të fituesit datë 06.06.2023;

-Formulari i publikimit të njoftimit të kontratës së nënshkruar Nr.255/9, datë 14.06.2023;

-Buletin Njoftimeve Publike Nr.55 datë 19.06.2023;

-Kontrata Nr.255/10, datë 15.06.2023.

Gabimet materiale pasqyruar në dokumentet e sipërme kanë sjellë dëm për buxhetin e AK, në vlerën 20,000 lekë (3,500,000 vlera me TVSH-3,480,000 vlera me TVSH e likuiduar).

Me vendimin Nr.1, datë 05.06.2023, KVO ka kualifikuar ofertën e vetme të paraqitur të OE A.

Nga auditimi në SPE dhe dosjes fizike të procedurës së tenderit rezultoi:

Gjetja 6. OE nuk ka përmbushur kriterin 2.3.10 "për punësimin minimum 2 inxhinier mekanikë për periudhën 2022-2023 duhet të paraqesë kontratë pune, CV dhe diplomat respective", pasi për 1 inxhinier (E.E.) ka paraqitur kontratë pune datë 02.11.2020 në SPE, e cila ka për objekt punësimin si "këshilltar shërbimi pas shitjes", ndërkohë diploma e nivelit "Bachelor në inxhinieri mekanike" është lëshuar datë 16.05.2023, (kontrata është lidhur 3 vjet më parë se marrja e diplomës dhe jo për pozicionin inxhinier mekanik). Gjithashtu në dokumentet fizike të paraqitura nga operatori pas shpalljes si fitues, kontrata datë 02.11.2020, nuk ka të përcaktuar pozicionin e punësimit. Nga krahasimi mes tyre kontratat nga objekti nuk janë të njëjta dhe përbëjnë kusht për skualifikim të tij. Për pasojë, tenderi duhet të ishte anuluar, bazuar në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 i ndryshuar neni 98, pika 1, germa "b".

-Formulari i njoftimit të fituesit datë 06.06.2023 nuk është i nënshkruar nga ish SP, jo në përputhje me Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 i ndryshuar neni 97 dhe VKM Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar neni 83, por njoftimi i fituesit është botuar në Buletin e Njoftimeve

Publike Nr.55 datë 19.06.2023 konform nenit 74, pika 3, germa” d”, duke vazhduar më tej procesi i zhvillimit të tenderit.

-Raporti përmbledhës mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit bashkëlidhur shkresës së Kryetarit të KVO Nr.255/8, datë 07.06.2023 për miratimin e procedurës së prokurimit, nuk figuron i miratuar nga titullari i AK/ish SP, jo në përputhje me Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 i ndryshuar neni 97 dhe VKM Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar neni 84.

-Formulari i publikimit të njoftimit të kontratës Nr. 255/9 prot., datë 14.06.2023 nuk është i nënshkruar nga titullari i AK/ish SP, jo në përputhje me VKM Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar neni 85, *kompetencë e ish Sekretarit të Përgjithshëm në cilësinë e titullarit të AK, bazuar në VKM-në Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar neni 73, pika 1 dhe neni 84, pika 1.* Nga shqyrtimi jo i plotë i dokumentacionit të OE nga KVO, ka sjellë që vlerësimi i ofertës së OE fitues, të jetë jo i plotë, që për nga rëndësia është i nivelit të mesëm.

Lidhja dhe zbatimi i kontratës-Me OE “A” fitues është lidhur kontrata Nr.255/10, datë 15.06.2023 me vlerë 2,900,000 lekë pa TVSH/3,480,000 lekë me TVSH, me afat 30 ditë nga nënshkrimi i kontratës. Kontrata është lidhur me datë 15.06.2023, ndërkohë që është nënshkruar nga titullari i AK me datë 31.10.2023.

Nga OE me shkresën Nr.255/11 prot., datë 11.07.2023 është kërkuar shtyrje e afatit të dorëzimit të mallit (autoveturë) me 5-6 ditë për shkak të bllokimit të mjeteve të transportit në kufi (Beograd-Tiranë). Me Urdhrin Nr.25, datë 13.07.2023 është ngritur Komisioni (G. D, K. K dhe A. Zh) për marrjen në dorëzim të mallit (autoveturë).

Meqënëse ish SP, nuk është paraqitur për nënshkrimin e dokumentacionit të listuar, SP (i komanduar) me Urdhrin Nr.36, datë 14.09.2023 ka urdhëruar kthimin e mjetit pranë shitësit dhe përpilimin e procesverbalit për gjendjen fizike të mjetit.Me procesverbalin datë 15.09.2023 të shitësit, protokolluar Nr.509/1, datë 15.09.2023 automjeti është marrë në dorëzim nga shitësi deri në likuidimin e plotë të pagesës në llogarinë e shitësit.

Gjetja 7. Në dosje nuk figuron procesverbali i marrjes në dorëzim të mjetit pas rikthimit të tij tek shitësi me shkresën datë 15.09.2023 protokolluar Nr.509/1, datë 15.09.2023 dhe as nuk është mbajtur procesverbal nga subjekti për këtë kalim.

-Me Urdhër Shpenzimin Nr.267, datë 10.11.2023 është likujduar OE “A” në vlerën 3,500,000 lekë me TVSH. Bazuar në ofertën e OE vlera e saj rezulton 2,900,000 lekë pa TVSH/3,480,000 lekë me TVSH. Nga mbartja e gabimeve materiale në vlerë, në aktet e KVO mbi vlerësimin e ofertës deri në lidhjen e kontratës është krijuar dëm për buxhetin e AK në vlerën 20,000 lekë, përfituar padrejtësisht nga OE fitues pasi, Kontrata Nr.255/10, datë 15.06.2023 me OE është lidhur në vlerën 3,500,000 lekë me TVSH dhe jo 3,480,000 lekë me TVSH sipas ofertës së paraqitur, kompetencë e KVO bazuar në VKM Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar neni 75, pika 4, që për nga rëndësia është i nivelit të mesëm.

Shqyrtimi i procedurës së prokurimit nga Komisioni i Konkurrencës.

Procedura e sipërme është marrë në shqyrtim nga Komisioni i Konkurrencës ku me Urdhrin Nr.35, datë 13.09.2023 të titullarit të Autoritetit të Konkurrencës z.D.B, bazuar në kërkesën e Komisionit të Konkurrencës i mbledhur me datë 13.09.2023, ndër të tjera është diskutuar dhe informacioni dërguar Kryetarit të Komisionit Konkurrencës nga Nëpunësi Zbatues dhe personi përgjegjës i prokurimit (A.P.), në lidhje me akte të pafirmosura nga ish SP. Për këtë qëllim është ngritur komisioni për marrjen në shqyrtim të procedurës së prokurimit (*përbërë nga Dh.S në cilësinë e SP i komanduar, Th.K dhe R.C*), të dokumentacionit përkatës si dhe vlerësimit të problematikës respektive.

Komisioni i ngarkuar me shqyrtimin e procedurës së prokurimit me shkresën Nr.509/2, datë 20.09.2023 i ka drejtuar Komisionit të Konkurrencës relacionin përkatës. Komisioni vë në

dukje se me shkresën Nr.359/42 prot., datë 11.09.2023 i është kërkuar ish SP që me datë 12.09.2023, të paraqitet për të përmbushur detyrimet në lidhje me nënshkrimin e akteve të pa nënshkruara nga ajo. Meqënëse ish SP nuk është paraqitur për nënshkrimin e dokumentacionit të listuar, SP (i komanduar) me Urdhrin Nr.36, datë 14.09.2023 ka urdhëruar kthimin e mjetit pranë shitësit dhe përpilimin e procesverbalit për gjendjen fizike të mjetit. Me procesverbalin datë 15.09.2023 të shitësit, protokolluar Nr.509/1, datë 15.09.2023 automjeti është marrë në dorëzim nga shitësi deri në likuidimin e plotë të pagesës në llogarinë e shitësit. Komisioni vlerëson të drejtën e nënshkrimit të dokumenteve përkatëse nga titullari i AK, si person përgjegjës me qëllim shmangien e pasojave financiare. Në vijim, Komisioni me shkresën Nr.509/4 prot., datë 20.10.2023 ka bërë disa shtesa në lidhje me materialin Nr.509/2, datë 20.09.2023 ku ndër të tjera shprehet se *“për të shmangur situata të tilla në të ardhmen rekomandojmë marrjen e masave disiplinore ndaj personave përgjegjës (përveç znj. D. ndaj të cilës është marrë kjo masë)”*.

Në zbatim të këtij rekomandimi të shprehur nga Komisioni i ngarkuar me shqyrtimin e procedurës së prokurimit, për Komisionin e Konkurrencës, për znj. A.P. është dhënë masë disiplinore dhe njoftuar nga eprori direkt me shkresën Nr.638 prot., datë 13.11.2023, ndërsa për ish SP (D. D) ishte dhënë më parë Vendimi Nr.1003, datë 18.07.2023 i Komisionit të Konkurrencës me objekt *“largimin nga funksioni dhe përfundimin e marrëdhënies së punës si Sekretare e Përgjithshme ...”*, vendim i cili është ndjekur gjyqësisht nga ish SP-ja dhe është në proces gjyqësor.

Sa më sipër arrihet në konkluzion:

Nga auditimi i procedurave të prokurimit për vitin 2023 u konstatuan parregullësi në:

☞ emërimin e kryetarit të grupit për llogaritjen e fondit limit (*“Blerje autoveture e re për nevojat e Autoritetit të Konkurrencës”*) nuk është në përputhje me VKM-në Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar neni 74, pika 2 dhe 4, pasi nuk është me arsim të lartë, si dhe specialisti i fushës B.Y. (i jashtëm) me detyrë inxhinier, nuk rezulton të ketë marrë pjesë në hartimin e specifikimeve teknike e për pasojë nuk ka nënshkruar procesverbalin përkatës. Në këto kushte grupi ka funksionuar me 2 anëtarë, jo me numër tek anëtarësh, jo në përputhje me VKM-në Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar neni 74, pika 2;

☞ nuk është argumentuar llogaritja e fondit limit dhe mënyra përzgjedhjes së metodës për përlllogaritjen e tij, jo në përputhje me VKM-në Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar neni 76;

☞ hartimin e dokumenteve të tenderit/kriteret e veçanta, pika 2.2 (*“Blerje autoveture e re për nevojat e Autoritetit të Konkurrencës”* dhe *“Blerje pajisje zyresh dhe informatike për nevoja të AK”*) nuk janë mbajtur në konsideratë kritere të thjeshtuara pranimi pasi tenderi është i llojit *“tender i hapur ithjeshtuar”*, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm, jo në përputhje me VKM Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar neni 55, pika 5;

☞ në aktet e mbajtura nga KVO në lidhje me pasqyrimin e vlerës së ofertës fituese, ka gabime materiale në vlerë, e cila është mbartur në të gjitha aktet e procedurës si: procesverbali i vlerësimit të ofertave etj. deri në lidhjen e kontratës për tenderin *“Blerje autoveture e re për nevojat e Autoritetit të Konkurrencës”*, duke sjellë si pasojë dëm ekonomik në vlerën 20,000 lekë i cili për nga vlera është nën pragun e materialitetit; (*Kontrata Nr.255/10, datë 15.06.2023 me OE është lidhur në vlerën 3,500,000 lekë me TVSH dhe jo 3,480,000 lekë me TVSH sipas vlerës së ofertës të publikuar nga OE*);

☞ mungon nënshkrimi i ish SP në cilësinë e titullarit të AK në Formularin e njoftimit të fituesit datë 06.06.2023, në Formularin e publikimit të njoftimit të kontratës Nr. 255/9 prot., datë 14.06.2023 dhe në Raportin përmbledhës për miratimin e procedurës së prokurimit (*“Blerje autoveture e re për nevojat e Autoritetit të Konkurrencës”*), jo në përputhje me Ligjin Nr. 162,

datë 23.12.2020 i ndryshuar neni 97 dhe VKM Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar neni 83; neni 97 dhe VKM Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar neni 84.

2.6 Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Në zbatim të pikës 2/6 “*Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit*” të programit të auditimit Nr.506/1, datë 15.04.2024” i ndryshuar , u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Rregullorja “*Për organizimin dhe funksionimin e administratës së Autoritetit të Konkurrencës*”, miratuar me Vendimin Nr.563, date 25.10.2018;
- Deklarata dhe raporti vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm 2021-2023;
- Struktura organike për vitin 2021, miratuar me Vendimin Nr.27, datë 08.03.2021;
- Struktura organike për vitin 2023, miratuar me Vendimin Nr.42, datë 08.06.2023;
- Korrespondenca zyrtare në lidhje me menaxhimin financiar dhe kontrollin.

Auditimi iu referua akteve ligjore e nënligjore në vijim:

- Ligji Nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;
- Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave Nr. 108, datë 17.11.2016, i ndryshuar.

Nga auditimi:

I. Vlerësimi i Mjedisit të Kontrollit.

Mjedisi i kontrollit sipas komponentëve:

1. Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike;

Në zbatim të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave Nr.108, datë 17.11.2016, i ndryshuar, Kap. III, pika 3.1 ku sanksionohet “*Kuadri i sjelljes së menaxherëve dhe stafit duhet të përcaktohen nga titullari i njësisë publike në një Kod të Brendshëm Etike, ose në një Kod Sjelljeje*”, për këtë komponent nga AK është miratuar Kodi i Etikës me Vendimin Nr.69, datë 24.12.2007.

2) Politikat menaxheriale dhe stili i punës;

Në lidhje me politikat menaxheriale dhe stilin e punës një ndër fushat që merr prioritet është mbështetja e titullarit në drejtim të kontrollit të brendshëm dhe monitorimi i zbatimit të tij, krijimi i kushteve për zhvillimin e Auditit të Brendshëm, i cili do të raportojë drejtpërdrejt tek Nëpunësi Autorizues (NA) dhe Titullari i njësisë publike.

Gjetja 1. Për vitin 2021-2023 rezulton se AK nuk ka njësi të Auditit të Brendshëm, kjo pasi nuk plotësohen kriteret e kërkuara në VKM Nr. 83, datë 03.02.2016 “*Për Miratimin e Kritereve të Krijimit të Njësisë të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik*”, pika 1, si dhe nuk kanë varësi nga ndonjë organ epror.

Bazuar në Ligjin Nr. 114/2015 “*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*” i ndryshuar në nenin 10, pika 1, germa “b” përcaktohet “*Të gjitha njësitë publike, të përfshira në nenin 3, të këtij ligji, sigurojnë shërbimin e auditimit të brendshëm sipas njërës prej formave të përcaktuara në vijim: ...kryerja e shërbimit të auditimit të brendshëm nga njësia e Auditimit të Brendshëm e institucionit epror, ose nga njësia e Auditimit të Brendshëm e një njësie tjetër publike, në bazë të një marrëveshje ndërmjet titullarëve të njësive publike përkatëse.Marrëveshja miratohet paraprakisht nga ministri përgjegjës për financat...”.*

Autoriteti i Konkurrencës, në përmbushje të këtij detyrimi ligjor ka lidhur marrëveshje për kryerjen e shërbimit të auditit të brendshëm nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit me Nr.7017 prot., (MTM) datë 02.11.2016 me afat nga 01.12.2016 deri me 01.12. 2019.

Në vijim me shkresën Nr.213, datë 28.05.2020 ka kërkuar nga MFE realizimin e shërbimit të auditimit të brendshëm të kësaj strukture për periudhën 01.01.2017 deri me 31.12.2019, ndërkohë që për këtë periudhë shërbimi i auditit të brendshëm është kryer nga MTM sipas marrëveshjes Nr.7017 prot (MTM) datë 02.11.2016.

2.AK, në plotësimin e pyetësorit të vetëvlerësimit për vitin 2021-2023, dërguar në MFE me shkresat respektive, Nr.139, datë 28.02.2022, Nr. 154/1, datë 28.02.2023, Nr. 210 datë 29.02.2024, është shprehur se “Janë kërkuar opinione nga propozimet e Auditimit të Brendshëm të ushtruar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit sipas një marrëveshje të miratuar midis dy institucioneve me Nr.7017, datë 02.11.2016 dhe kundërfirmuar nga Ministria e Financave” dhe nuk ka evidentuar mungesën e strukturës së auditit të brendshëm si dhe përfundimin e marrëveshjes së lidhur me MTM Nr.7017 prot., (MTM) datë 02.11.2016 për realizimin e këtij shërbimi, duke mos dhënë pasqyrim real të funksionimit të treguesve të MFK, që për nga rëndësia janë nivel i mesëm.

AK ka hartuar dhe miratuar objektivat afatmesëm dhe vjetorë në dokumentin PBA 2021-2023 dhe 2022-2024, ku janë përcaktuar programet buxhetore dhe investimet në përputhje me Ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar neni 9, pika 4, germa “a”, ku përcaktohet:“Nëpunësit autorizues të të gjitha niveleve të njësisë publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto përgjegjësi kryesore:

a)propozimin te nëpunësi autorizues i njësisë publike të sistemit të rregullave dhe procedurave të brendshme të njësisë, të planeve strategjike dhe të objektivave afatmesëm dhe vjetorë, si dhe monitorimin e zbatimit të tyre në njësi....”.

Për vitin 2021, AK nuk ka nxjerrë urdhër për ngritjen e grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) dhe Ekipit të Menaxhimit të Programeve (EMP) jo në përputhje me Ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 9, pika 4.

Për vitin 2022, me Urdhërin Nr.24/3, datë 01.04.2022 është ngritur grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS/EMP), i cili ka funksionuar deri në hyrjen në fuqi të Urdhërit Nr.170/1, datë 13.03.2023,

GMS dhe EMP për vitet 2021-2023 nuk rezulton të ketë pasqyruar sipas një protokolli, mbledhjet e tij, jo në përputhje me Ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar neni 8, pika 8/b.

3) Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit;

Me Vendimin Nr.27, datë 08.03.2021, është miratuar struktura “Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit Nr.43/2017 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Autoritetit të Konkurrencës” me numër punonjësish në total 46, e cila ka qënë ne fuqi deri në datë 15.06.2023. Për vitin 2023, me Vendimin Nr.42, datë 08.06.2023 është miratuar struktura “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në vendimin e Kuvendit Nr. 43/2017 “Për miratimin e strukturës dhe organikës të Autoritetit të konkurrencës”, me numër punonjësish në total 49.

Për periudhën objekt auditimi 2021-2023 vende të lira/vakante për vitin 2021, numri i vendeve të lira/vakante është 1 dhe për vitin 2023 është 1.

Rregullorja e brendshme është miratuar me Vendimin Nr.563, datë 25.10.2018 të Komisionit të Konkurrencës dhe është publikuar në faqen zyrtare të AK-së me qëllim njohjen e saj nga punonjësit.

Rregullorja përcakton ndarjen e detyrave, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit në përputhje me Ligjin Nr.10296 datë 08.07.2010 i ndryshuar, neni 20.

Emërimi i Nëpunësit Autorizues (NA) dhe Nëpunësit Zbatues (NZ) është bërë me shkresën Nr.310/8 prot, datë 19.07.2021, konfirmuar dhe nga MFE me shkresën Nr.367 datë 03.07.2023.

4) Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore;

Politikat e burimeve njerëzore dhe praktikat e ngjashme lidhen me rekrutimin, emërimin, trajnimin, vlerësimin e performancës, ngritjen në detyrë dhe veprimet disiplinore, të cilat përbëjnë një pjesë të rëndësishme të kontrollit të brendshëm.

Burimet njerëzore, referuar strukturës së miratuar menaxhohen nga Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Trainimeve. Sektori mbulon çështjet që kanë të bëjnë me procedurat e rekrutimit, emërimit dhe lirimit nga detyra apo shërbimi civil, procedurat disiplinore, administrimin e dosjeve të personelit, plotësimin e regjistrit qendror të personelit, përgatitjen e përshkrimeve të punës. Në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike administrojnë trajnimet dhe kualifikimet e stafit.

Për periudhën 2021-2022, janë realizuar trainimet për stafin e administratës së AK-së nga ASPA.

Për vitin 2020-2021, AK me shkresën Nr.112/1 prot., datë 04.03.2020, i ka dërguar Shkollës Shqiptare të Administratës Publike, nevojat për trainim/fushat përkatëse.

Për vitin 2022, me shkresën Nr.68 prot., datë 26.01.2022, i ka dërguar Shkollës Shqiptare të Administratës Publike, nevojat për trainim/fushat përkatëse.

Për vitin 2023-2024, me shkresën Nr.632/1 prot., datë 10.11.2023, i ka dërguar Shkollës Shqiptare të Administratës Publike, nevojat për trainim/fushat përkatëse.

5) Aftësitë profesionale të punonjësve.

Aftësitë profesionale të punonjësve janë në dinamikë të vazhdueshme, pasi nga ASPA organizohen trajnime të ndryshme në mënyrë që punonjësit të ngrihen profesionalisht.

II. Menaxhimi i riskut.

Referuar Ligjit Nr.10296, datë 08. 07. 2010 (ndryshuar), neni 8, germa “a” dhe nenin 21, pika 2, përcaktohet:

“Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore: a) miratimin e politikave dhe monitorimin e objektivave të njësive publike që ata drejtojnë, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan-veprimeve për arritjen e objektivave”.

Nga AK është hartuar regjistri i risqeve (*Strategjia e Menaxhimit të Riskut*) për vitin 2020-2022, por nuk është i firmosur nga Sekretari i Përgjithshëm i AK-së.

III. Veprimtaritë e kontrollit.

Me qëllim reduktimin e risqeve për të arritur objektivat e njësisë, vendoset dhe sistemi me dy firma, procedurë e cila kryhet për të vërtetuar saktësinë e të dhënave të përfshira në dokument. Detyrimet financiare të tilla si nënshkrimi i kontratave, urdhër-shërbimet etj. Autorizohen pas hedhjes së firmës nga: Nëpunësi Zbatues (NZ) ose nëpunësi i deleguar/përgjegjës për rregjistrimet në kontabilitet, titullari/Nëpunësi Autorizues (NA), apo një nëpunës tjetër i deleguar, përgjegjës për kryerjen e shpenzimeve dhe mbledhjen e të ardhurave. Sistemi i firmës së dyfishtë jep garancinë se marrja përsipër e detyrimit financiar apo pagesa bëhet nga personi i autorizuar dhe se nuk ka shkelje të disiplinës financiare apo buxhetore.

IV. Informim komunikimi

Shkëmbimi i informacionit realizohet ndërmjet punonjësve të institucionit si horizontalisht ashtu edhe vertikalisht. Në Rregulloren e brendshme janë përshkruar proceset e punës, sjellja e etike gjatë punës, marrëdhëniet me njëri tjetrin, mënyra e raportimit dhe e bashkëpunimit. Komunikimi i informacionit realizohet përmes shkresave zyrtare me institucionet e tjera si dhe përmes postës elektronike/e-mail.

Komunikimi i brendshëm në AK dhe komunikimi me institucionet e tjera, kryhet edhe nëpërmjet rrjetit informatik/postës elektronike, ndërkohë që çdo mbledhje e Këshillit publikohet në faqen zyrtare të AK-së. Komunikimi dhe shkëmbimi i dokumenteve zyrtare nga nëpunësit e administratës së AK-së kryhet gjithmonë duke përdorur postën elektronike të AK-së.

V. Monitorimi

Referuar përcaktimit ligjor të menaxhimit financiar dhe kontrollit “*monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të ofrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë sipas qëllimit për të cilin janë ngritur*”.

Monitorimi i sistemit të MFK nga titullari realizohet nëpërmjet plotësimit të pyetësorit të vetëvlerësimit të kontrollit të brendshëm. Duke ju përgjigjur pyetjeve të pyetësorit të vetëvlerësimit, institucioni bën vlerësimin e zhvillimit të komponentëve të veçantë të kontrollit të brendshëm.

Për sa më sipër, për periudhën e audituar 2021-2023, AK ka përgatitur brenda afatit ligjor në dhe në përputhje me Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar, neni 18, Deklaratën për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe Raportin vjetor për vitin 2021, 2022 dhe 2023 dërguar në MFE(DH/AB) me shkresat respektive: Nr.139 prot., datë 28.02.2022, Nr.154/1 prot., datë 28.02.2023 dhe Nr.210 prot., datë 29.02.2024.

Sa më sipër arrihet në konkluzion:

Në lidhje me funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit për vitet objekt auditimi (2021-2023) u konstatua se:

☞ veprimtaria e Autoritetit të Konkurrencës (AK) bazohet në Rregulloren “*Për organizimin dhe funksionimin e administratës së Autoritetit të Konkurrencës*”, miratuar me Vendimin Nr.563, datë 25.10.2018;

☞ mungon njësia e auditit të brendshëm, pasi nuk plotësohen kriteret e përcaktuara në VKM Nr. 83, datë 03.02.2016 “*Për Miratimin e Kritereve të Krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik*”, jo në përputhje me Ligjin Nr.114/2015 “*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*” i ndryshuar neni 3, germa “a”

☞ për 2021 nuk është ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS) dhe Ekipi i Menaxhimit të Programeve buxhetore (EMP) në përputhje me Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar neni 8, pika 8/b;

☞ numri i vendeve të lira/vakante për vitin 2021 është 1 dhe për vitin 2023 është 1;

☞ monitorimi i sistemit të MFK është finalizuar me plotësimin e pyetësorit të vetëvlerësimit, hartimin e Deklaratës për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe Raportin vjetor për vitin 2021-2022 dhe 2023 dërguar në MFE(DH/AB).

IV. REKOMANDIME

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave duke pasur parasysh:

A.MASA ORGANIZATIVE

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi përgatitjen e PBA-ve 2021-2023 rezultoi se:

-Titullari i institucionit për vitin 2021, nuk ka ngritur Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS), jo në përputhje me Ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar neni 8, pika 8, germa “b” dhe neni 27, si dhe Manualin e MFK-së, pika 2.2.6.

-Takimet e GMS-së për periudhën objekt auditimi nuk janë të dokumentuara jo në përputhje me Ligjin Nr.10 296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar neni 27 pika 1, neni 16, pikat 2 dhe 3, si dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. II, pika 2.2.6.

-Kërkesat buxhetore në kuadër të përgatitjes së PBA 2021-2023, nuk janë diskutuar/trajtuar në mbledhjet e Ekipit të Menaxhimit të Programit jo në përputhje Udhëzimin Nr.7, datë 28.2.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, pika 2.6.

-Autoriteti i Konkurrencës, si njësi shpenzuese, nuk ka hartuar raporte monitorimi 4-8-12 mujore. Konkretisht: për vitin 2021 nuk është përgatitur dhe dorëzuar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë raporti 8-mujor; për vitin 2022, nuk është përgatitur dhe dorëzuar raporti 12-mujor dhe për vitin 2023 nuk është dorëzuar raporti 4-mujor dhe raporti 8 mujor, me qëllim ndjekjen e realizimit të produkteve të buxhetit të saj, garantimin e përmirësimit të procesit të planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit, ndjekjen dhe arritjen e qëllimit dhe objektivave të synuara sipas deklaratës së politikës së programit, si dhe krahasimin e treguesve të planifikuar të performancës me treguesit faktik, jo në përputhje me Ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, i ndryshuar, neni 65 dhe Udhëzimin Nr.22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të Monitorimit në Njësitë e Qeverisjes Qëndrore”, kreu II dhe kreu III, pika 3.2, i ndryshuar.

-Raportet e monitorimit, përshkruajnë/pasqyrojnë veprimtarinë e institucionit si dhe të dhëna në terma sasiorë, por nuk bëjnë një analizë mbi ndryshimet e zërave buxhetore për periudhën raportuese, mosarritjet dhe shkaqet e tyre duke propozuar në të njëjtën kohë masa për përmirësimin e situatës apo mangësitë në lidhje me procesin e zbatimit të buxhetit, jo në përputhje me Udhëzimin Nr.9, datë 20.7.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, pika 267.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 10-20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: Të merren masa nga Titullari i Autoritetit të Konkurrencës për organizimin dhe dokumentimin e aktivitetit periodik të Grupit të Menaxhimit Strategjik lidhur me menaxhimin financiar dhe kontrollin.

-Të merren masa nga Nëpunësi Autorizues dhe Nënpunësi Zbatues për monitorimin e zbatimit të Buxhetit të Shtetit duke hartuar raportet e monitorimit të buxhetit çdo katër muaj për Autoritetin e Konkurrencës, si njësi shpenzuese për produktet e buxhetit të administruara nga ana e tij, me qëllim përmirësimin e procesit të planifikimit dhe monitorimit të buxhetit.

Në vijimësi

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi pasqyrat financiare rezultoi se pasqyrat financiare të llogaridhënies vjetore për aktivitetin e AK për vitet 2021, 2022 dhe 2023, nuk janë nënshkruar nga Nëpunësi Zbatues, por nga hartuesi i tyre (specialist pranë Drejtorisë së

Financës) duke operuar kështu jo në përputhje me Ligjin Nr.10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar Neni 4, pika 24 si dhe neni 12, pikat 2, germa “b” dhe pika 3, germa “ë” dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, pika 2.2.8.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1 Rekomandimi: Nga Autoriteti Konkurrencës, të merren masa që pasqyrat financiare në kuadrin e dokumentacionit financiar të njësisë, të nënshkruhen nga Nëpunësi Zbatues si nëpunës i nivelit të lartë menaxhues, përgjegjës për zbatimin e rregullave që lidhen me menaxhimin financiar, kontabilitetin dhe përgatitjen e pasqyrave financiare të njësisë.

Në vijimësi

3.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi pasqyrat financiare, Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)” e cila për vitin 2023 pasqyrohet në vlerën 9,308,085 lekë rezulton e nënvlerësuar për diferencën prej 120,003 lekë dhe mos kuadruar me Llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” në Pasiv të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar, në moszbatim të Udhëzimit Nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar pika 32.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1 Rekomandimi: Nga Autoriteti Konkurrencës, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemit në kontabilitet të llogarisë 4342 “Operacione me shtetin” dhe kundër partisë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”.

Në mbylljen e pasqyrave vjetore të vitit 2024

4.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit rezultoi se regjistri i aktiveve që zotëron subjekti është në trajtën e një dokumenti i mbajtur në programin “Excel” ku janë pasqyruar të dhëna pjesore për aktivet si: përshkrimi i aktivitetit dhe datën e vendosjes në përdorim ndërkohë që nuk janë pasqyruar të dhëna mbi: vlerën e blerjes, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, veprime që janë në kundërshtim me përcaktimet e pikave 26, 27 e 30, kapitulli III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, të Udhëzimit Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, me qëllim ruajtjen e aktiveve dhe burimeve të tjera kundrejt humbjeve të shkaktuara nga keqadministrimi, si dhe kundrejt parregullsisë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1 Rekomandimi: Të merren masa për të ndërtuar dhe përditësuar regjistrin e aktiveve në vartësi të llojit të tyre afatgjate apo afatshkurtër, grupit përkatës brenda llojit, datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në lidhje me zbatimin e kuadrit nënligjor për menaxhimin e aktiveve rezultoi:

1. Procedurat e inventarizimit nuk janë ndjekur plotësisht (*nga proceset e vlerësimit deri në daljen jashtë përdorimit*) si dhe asgjësimi për aktivet që nuk kanë destinacion tjetër. Nuk ka një evidencim të plotë të situatës së inventarizimit për çdo llogari, arsyetimi i shkaqeve mbi inventarin jashtë funksionit, qëndrimi i titullarit/disponimi mbi mënyrën se si do te procedohet ne vijim, etj. në kundërshtim me UMF Nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar, pika 104-106.

2. Nga komisionet e ngarkuara me inventarizimin e aktiveve, nuk janë hartuar raporte për inventarizimin e aktiveve gjendje në magazinë, në kundërshtim me UMF Nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar, paragrafi Nr. 85/ c.

3. Komisionet e inventarizimit të vlerave aktive dhe detyrimeve të AK-së nuk kanë mbajtur procesverbal me përgjegjësin e materialeve për të fiksuar numrin rendor të fletëhyrjes dhe fletëdaljes së fundit, në kundërshtim me Udhëzimit Nr. 30 datë 27/12/2011, i ndryshuar, pika 83 “Përgjegjësitë për inventarizimin”.

4. Komisioni i inventarizimit të vlerave aktive dhe detyrimeve të AK-së, nuk kanë përpiluar një relacion në lidhje me inventarizimin fizik të aktiveve për kushtet fizike të ruajtjes së tyre.

- Nga auditimi i fletëve të inventarit të vlerave aktive dhe detyrimeve të AK-së, rezultoi se këto fletë kanë të plotësuar vetëm rezultatin e dalë nga inventarizimi dhe nuk është respektuar proceduara e inventarizimit por është mjaftuar duke marrë të dhënat nga kontabiliteti pa dalë në një konkluzion në lidhje me gjendjen reale të inventarit, pas përlogaritjes si të amortizimit ashtu dhe mungesave, tepricave të aktiveve, në kundërshtim me Udhëzimin Nr. 30 datë 27/12/2011 i ndryshuar, pika 73 dhe 85.

5. Vlerësimi i Aktiveve nuk është bërë në përputhje me përcaktimet e pikës 103 e në vijim, të UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 20-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1 Rekomandimi: Të merren masa nga titullari i Autoritetit të Konkurrencës/Sekretari i Përgjithshëm për plotësimin dhe dokumentimin e praktikave të inventarizimit në zbatim të UMF Nr.30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” i ndryshuar.

-Të merren masa nga Autoriteti i Konkurrencës/ Nëpunësi Autorizues për ngritjen e komisioneve të cilat të jenë funksionale në ushtrimin e kontrolleve për menaxhimin e pasurisë, me qëllim sigurimin e informatave të drejta dhe të sakta për pasurinë që posedojnë.

- Nga strukturat drejtuese të AK-së të merren masa që kryerja e inventarëve të aktiveve, nxjerrja jashtë përdorimit dhe asgjësimi i tyre, duhet të shoqërohen me procesverbalet e nxjerrjes jashtë përdorimit dhe asgjësimi të aktiveve, bashkëlidhur me dokumentacionin mbi procedurën e kryer për vlerësimin dhe ndarjen e materialeve sipas destinacionit të tyre, duke e dokumentuar nxjerrjen jashtë përdorimit dhe asgjësimin e materialeve në përputhje me UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave për nxjerrjen jashtë përdorimit dhe asgjësimin e aktiveve rezultoi:

-Për vitet 2022 -2023 janë parashikuar dhe propozuar për të nxjerrë nga përdorimi aktive me vlerë totale 3,196,058 lekë (respektivisht v.2022 propozuar 9 artikuj me vlerë 490,232 lekë, v.2023 propozuar 27 artikuj me vlerë 2,705,826 lekë), për të cilat mungon gjurma e nxjerrjes nga përdorimi dhe asgjësimi të tyre, në kundërshtim me UMF Nr. 30 datë 27.12.2011, i ndryshuar pika 109.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1 Rekomandimi: Autoriteti i Konkurrencës të vlerësojë dhe të analizojë vlerën prej 3,196,058 lekë propozuar për tu nxjerrë nga përdorimi, e cila rezulton pa dokumentacion justifikues ku të përcaktohen shkaqet, arsyet, përgjegjësitë ligjore dhe financiare.

-Të analizohen rezultatet e grupeve të inventarizimit për të formalizuar procesin e vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësinë shpenzuese; listën e aktiveve të identifikuara dhe kriteret për vlerësim, procesverbalin për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve si dhe përgjegjësitë për nxjerrjen nga përdorimi ose tjetërsimin e aktiveve në referencë UMF Nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar.

-Komisionet e Vlerësimit të Aktiveve për nxjerrjen jashtë përdorimit, në përfundim të procesit të inventarizimit të aktiveve të përpilojnë një raport përmbledhës të detajuar mbi procedurën e ndjekur për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, arsyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës.

Menjëherë

7.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimeve të kryera përmes bankës për vitin 2021-2023, lidhur me procedurat e prokurimit “blerje me vlerë të vogël” dhe “sistem dinamik blerje bileta avioni”, rezultoi se:

-procedura “Blerje kuti dhe dosje për arkivim dokumentacioni” v.2021, lekë nuk është hedhur në SPE, jo në përputhje me Ligjin 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, neni 56;

-në 2 procedura “Mirëmbajtje e pajisjeve të instaluar IT e të tjera” dhe “Shërbim infrastrukturor për komunikimin on line” v.2021, kriteret e veçanta nuk janë argumentuar teknikisht, në kundërshtim me Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 7 dhe VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 41, pika 2.

- Në 2 raste, procedurat e prokurimit “Karburant”, v.2021 dhe v. 2022 nuk është përcaktuar marzhi i fitimit por është operuar me çmim fiks të përcaktuar si kriter vlerësimi në kundërshtim me VKM-së Nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar, neni 31, pika 3 dhe VKM Nr. 258, datë 19.05.2021, i ndryshuar neni 45 pika 2, që përcakton elementët përbërës të çmimit.

-në 2 raste “Blerje materiale Kancelarie dhe Tонера” viti 2022-2023, specififikimet teknike përfshijnë markën në kundërshtim me Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 i ndryshuar, neni 36.

-në 1 rast “Pjesëmarrje në aktivitetin Dita Ndërkombëtare e Konkurrencës” v.2022, nuk argumentohet metoda e përzgjedhur për përllogaritjen e vlerës së prokurimit, jo në përputhje me VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 për “Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 76.

- në shumicën e rasteve të testuara nga auditimi për vitet 2022-2023, në procedurat sistem dinamik blerje bileta avioni, në ftesën për ofertë vendoset kriteri “eksperiencë në treg prej 10 vite. .. si dhe të ketë në stafin e tij jo më pak se 5 punonjës nga të cilët 3 të jenë te pajisur me Certifikata IATA”, i cili kufizon pjesëmarrjen e biznesit të mesëm dhe të vogël, jo në përputhje me Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020, i ndryshuar, neni 2, 3 dhe 36, si dhe VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 i ndryshuar, neni 41.

-në shumicën e rasteve të testuara nga auditimi për vitet 2022-2023 sistem dinamik blerje bileta avioni, afati realizimit të procedurës është brenda një kohe të shkurtër me datën e udhëtimit, pasi procedurat fillojnë me vonesë nga momenti i dërgimit të ftesës për pjesëmarrje në event (jashtë vendit), duke sjellë si pasojë, riskun e përzgjedhjes së çmimit me të lartë, jo në përputhje me Ligjin Nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm”, i ndryshuar neni 8, pika 1, neni 9, pika 1 dhe neni 12, pika 3, germa a.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 39-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1 Rekomandimi: Të merren masa nga titullari i AK që në të ardhmen kriteret e veçanta për kualifikim të jenë në përpjesëtim të drejtë dhe të lidhura ngushtë me objektin që prokurohet.

Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë.

-Procedurat e prokurimit “Blerje karburanti” të cilat bazohen në ofertën ekonomikisht më të favorshme, çmimi të përlllogarit bazuar në kriteret e përcaktuara në VKM Nr.258, datë 19.05.2021, neni 45 i ndryshuar.

-Hartimi i dokumentacionit paraprak për fillimin e procedurës së prokurimit me sistem dinamik blerje bileta avioni të përgatitet nga momenti i ardhjes së ftesës për pjesëmarrje në event, me qëllim minimizimin e riskut për rritjen e kostos së blerjes së biletave me çmim më të lartë.

Menjëherë dhe në vijimësi

8.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimeve të kryera përmes bankës për vitin 2021-2023 rezultojë se, administrimi i dokumenteve justifikuese bashkëlidhur urdhër shpenzimeve mbi bazën e të cilave kryhen pagesa, në disa raste përshkruhet në kolonën përkatëse të urdhër shpenzimit, por nuk administrohej fizikisht bashkëlidhur praktikës dhe në disa raste të tjera dokumentacioni justifikues as nuk përshkruhet në urdhër shpenzim dhe as nuk administrohej, jo në përputhje me Udhëzimin e MF Nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik” i ndryshuar.

-Në 2 raste “Shërbime riparim dere” dhe “Shpenzime për mirëmbajtje të mjeteve të transportit”, rezultoi mungesë e argumentimit të nevojës për kryerjen e shërbimit, jo në përputhje me UMF nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pika 54.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 39-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1 Rekomandimi: Të merren masa nga AK, që në të ardhmen dokumentacioni justifikues që shoqëron urdhër shpenzimet, të përshkruhet në kolonën përkatëse të urdhër shpenzimit si dhe ti bashkëngjitet atij.

-Planifikimi i nevojave të argumentohet dhe dokumentohet bazuar në kërkesat reale të përcjellë nga sektorët përkatës shoqëruar me analizën e nevojave.

Menjëherë dhe në vijimësi

9.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik për periudhën 2021-2023, rezultoi se regjistri i realizimeve për prokurimet publike nuk pasqyron të dhëna të plota në lidhje me realizimin e procedurave të prokurimit me vlerë nën 100,000 lekë, jo në përputhje me VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar neni 11, pika 3, paragrafi 1, pasi pasqyron vetëm realizimin e procedurave që gjeneron sistemi elektronik i prokurimeve deri te procedurat me blerje të vogël. Prokurimi i blerjeve nën 100,000 lekë dhe pse nuk i nënshtrohen prokurimit, planifikimi i tyre dhe vlerat përkatëse, duhet të pasqyrohen në regjistrin e parashikimeve dhe të realizimeve.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 61-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

9.1 Rekomandimi: Të merren masa në të ardhmen që realizimi i prokurimeve blerje me vlerë nën 100,000 të pasqyrohet në regjistrin e realizimeve për prokurimet publike, me qëllim pasqyrimin e saktë të të dhënave mbi realizimin e tyre.

Në vijimësi

10.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik viti 2023, rezultoi se në procedurat e prokurimit “Blerje pajisje zyrash dhe informatike për nevoja të AK” dhe “Blerje autoveture e re për nevojat e AK” nuk janë mbajtur në konsideratë kriteret e thjeshtuara pranimit për kriterin “Kapacitetin ekonomik dhe financiar”, jo në përputhje me VKM Nr.285,

datë 19.05.2021 i ndryshuar neni 55, pika 5, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm, pasi AK ka zgjedhur si procedurë prokurimi në dy rastet “Tender të Hapur të Thjeshtuar”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 61-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

10.1 Rekomandimi: Të merren masa nga Autoriteti i Konkurrencës që në të ardhmen në procedurat e prokurimit të llojit “Tender i Hapur i Thjeshtuar”, të merren në konsideratë kritere të thjeshtuara pranimit në hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim.

Në vijimësi

11.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi strukturën organike për vitin 2021-2023 rezulton se Autoriteti i Konkurrencës nuk ka njësinë e Auditit të Brendshëm, pasi nuk plotësohen kriteret e përcaktuara në VKM Nr. 83, datë 03.02.2016 “Për Miratimin e Kriterëve të Krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, pika 1 (numri i punonjësve në organikë është 49 (i ulët), si dhe nuk ka varësi nga ndonjë organ epror).

Bazuar në Ligjin Nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar në nenin 10, pika 1, germa “b”, AK ka lidhur marrëveshje për kryerjen e shërbimit të auditit të brendshëm nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit Nr.7017 prot (MTM) datë 02.11.2016, me afat nga 01.12.2016 deri me 01.12. 2019. Në vijim nuk rezulton të jetë lidhur ndonjë marrëveshje për realizimin e shërbimit të auditit të brendshëm, megjithëse ka një korrespondencë në vijim deri në vitin 2019 me MTM dhe MFE, duke mbetur i pa mbuluar ky shërbim.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 35-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

11.1 Rekomandimi: Autoriteti i Konkurrencës të marrë masa për të siguruar realizimin e shërbimit të auditimit me një njësi Auditimi të Brendshëm të një njësie tjetër publike, në bazë të një marrëveshje mes titullarëve të institucionit me qëllim përmbushjen e kërkesave të Ligjit Nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar dhe VKM Nr.83 datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar.

Në vijimësi

12.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi strukturën organike për vitin 2021-2023 rezulton se Autoriteti i Konkurrencës nuk ka krijuar “bazën e të dhënave gjyqësore” për shlyerjen e detyrimeve monetare që rrjedh nga vendimet gjyqësore të formës së prerë për gjyqëfituesit e larguar nga puna, si dhe nuk ka ngritur Komisionin e Posaçëm, me qëllim uljen e riskut dhe koston shtesë të pagesave të vonuara për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, për punonjësit e larguar nga puna, që janë jo në përputhje me Urdhrin Nr.5151, datë 28.10.2015 e Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Kreu II, pika 1 dhe Kreu IV, pika 1, pasi AK në kuptim të pikës 3 të këtij urdhri, si njësi publike në cilësinë e “njësisë debitore” mbart një detyrim të caktuar sipas një vendimi gjyqësor të formës së prerë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 35-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

12.1 Rekomandimi: Të merren masa nga titullari i institucionit që nga Sektori i Burimeve Njerëzore të krijohet “baza e të dhënave gjyqësore” për shlyerjen e detyrimeve monetare për gjyqëfituesit e larguar nga puna, me qëllim uljen e riskut dhe koston shtesë të pagesave të vonuara për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.

Në vijimësi

B.MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në Ligjin Nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit i ndryshuar, neni 15, germa ”b” dhe “c” si dhe Ligjin Nr.44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar neni 98 e vijues, i rekomandohet titullarit të Autoritetit të Konkurrencës të nxjerrë aktin administrativ për kërkimin e dëmit shkaktuar buxhetit në vlerën totale **93,616 lekë** me TVSH referuar gjetjeve si më poshtë:

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik viti 2023, rezultoi se në procedurën “Blerje autoveture e re për nevojat e AK”, në zbatim të Kontratës Nr.255/10, datë 15.06.2023 është likuiduar OE fitues “A” me Urdhër Shpenzimin Nr.267, datë 10.11.2023 në vlerën 3,500,000 lekë me TVSH. Bazuar në ofertën e paraqitur nga operatori, vlera e saj rezulton 2,900,000 lekë pa TVSH/3,480,000 lekë me TVSH. Nga mbartja e gabimeve materiale në vlerë që nga aktet e KVO mbi vlerësimin e ofertës deri në lidhjen e kontratës, është krijuar dëm për buxhetin e AK në vlerën 20,000 lekë përfituar padrejtësisht nga OE fitues.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 61-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: Të merren masa nga titullari i Autoritetit të Konkurrencës të nxjerrë aktin administrativ për kërkimin e dëmit shkaktuar buxhetit të AK në vlerën **20,000 lekë** përfituar padrejtësisht nga OE “A”, duke ndjekur gjyqësisht kthimin e tij në të gjitha shkallët e gjykimit.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të kryera me sistem dinamik blerje bileta avioni rezultoi se:

-Me Urdhër Shpenzimin Nr.45, datë 09.03.2022 është likuiduar OE F, me vlerë 74,221 lekë ose 73,616 lekë më shumë se oferta e paraqitur (oferta e paraqitur në SPE është shprehur në vlerën 605, që nënkupton monedhën në lekë, pasi sistemi gjeneron vlerat në lekë dhe jo në monedhë të huaj). Fatura elektronike e sjellë nga OE rezulton në vlerën 74,221 lekë dhe është nënshkruar edhe nga Komisioni, ndërkohë që procesverbali i vlerësimit nga Komisioni është nënshkruar për ofertën në vlerën 605 lekë paraqitur nga OE F, duke shkaktuar dëm për buxhetin e AK në vlerën **73,616 lekë**, përfituar padrejtësisht nga OE F.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 39-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1 Rekomandimi: Të merren masa nga titullari i Autoritetit të Konkurrencës të nxjerrë aktin administrativ për kërkimin e dëmit shkaktuar buxhetit të AK në vlerën 73,616 lekë përfituar padrejtësisht nga OE “F”, duke ndjekur gjyqësisht kthimin e tij në të gjitha shkallët e gjykimit.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE

C.1 Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil

Mbështetur në nenin 15, të Ligjit Nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, gjerat (b, c, ç) e nenin 58 “Llojet e masave disiplinore” të Ligjit Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, VKM Nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” **i rekomandohet** Titullarit të institucionit, që nëpërmjet një grupi pune, të bëjë vlerësimin dhe shqyrtimin e shkeljeve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe të cituara më poshtë, sipas përgjegjësisë

individuale të nisë procedurat për dhënien e masave disiplinore sipas shkallës nga “vërejtje” deri në “largim”, për punonjësit si më poshtë:

1. Znj. P. Gj., në cilësinë e anëtarit të Komisionit për procedurën blerje bileta avioni sistem dinamik blerje, si dhe në cilësinë e anëtarit në procesin e nxjerrës jashtë përdorimit.

2. Znj. V. V., në cilësinë e anëtarit të Komisionit për procedurën blerje bileta avioni.

3. Z. B LI., në cilësinë e anëtarit të Komisionit për asgjësimin e materialeve të nxjerra jashtë përdorimit.

-për parregullsitë e konstatuara në procedurën “Tiranë-Vienë-New York; New York-Mynih-Tiranë” (copë një); në pranimin e ofertës së OE F, ku nga mos korrigjimi i gabimeve materiale në ofertën e paraqitur, ka sjellë si pasojë likuidimin e operatorit në vlerën 73,616 lekë më shumë;

-për parregullsitë e konstatuara në procedurën për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve dhe asgjësimin e tyre, pasi nuk është hartuar proces verbali ku përshkruhet procedura e ndjekur për nxjerrjen jashtë përdorimit (*duke ndryshuar formën e tyre fillestare/groposur ose djegur*), në kundërshtim me Udhëzimin e MF Nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 110, rekomandohet masë disiplinore ndaj tyre dhe pse niveli i materialitetit nuk është i konsiderueshëm dhe gabimet nuk janë në përsëritje.

C.2 PËR PUNONJËSIT E LARGUAR

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre. Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara, dobësive në zbatimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, parregullsive në menaxhimin e financave të institucionit, mungesës së monitorimeve mbi performancën buxhetore dhe parregullsive në administrimin e fondeve/aktiveve dhe inventarizimin e pasurisë së institucionit, masa disiplinore do të ishte “vërejtje” për punonjësit e larguar si më poshtë:

1. Znj. A. P., në cilësinë e anëtarit të Komisionit, për parregullsitë e rezultuara për kryerjen e procedurës me sistemin dinamik për blerje bileta avioni në itinerarin “Tiranë-Vienë-New York; New York-Mynih-Tiranë” (copë një), me vlerë 74,221 lekë, në pranimin e ofertës së OE F, nga mos korrigjimi i gabimeve materiale në ofertën e paraqitur, duke sjellë si pasojë likuidimin e operatorit në vlerën 73,616 lekë më shumë; si dhe për parregullsitë e rezultuara në procedurën e prokurimit “Blerje autoveture e re për nevojat e AK”, në cilësinë e personit përgjegjës për prokurimin në lidhje me njoftimin e fituesit botuar në Buletin e Njoftimeve Publike Nr.55 datë 19.06.2023, pa administruar Formularin e njoftimit të fituesit datë 06.06.2023 i cili rezulton pa nënshkrimin e ish Sekretarit të Përgjithshëm (D. D.); si dhe në cilësinë e anëtarit të Komisionit për asgjësimin e materialeve të nxjerra jashtë përdorimit.

2. Znj. D. D., me detyrë ish- Sekretar i Përgjithshëm, për parregullsitë e rezultuara në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor (*deleguar me autorizimin Nr.46, Prot., datë 18.01.2022 të Kryetarit të Autoritetit të Konkurrencës*), në procedurën e prokurimit “Blerje autoveture e re për nevojat e AK”, që konsistojnë në:

-ngritjen e grupit të punës për llogaritjen e fondit limit dhe hartimin e specifikimeve teknike, me urdhrin Nr.255 Prot., datë 20.04.2023, në bazë të cilit emërimi i kryetarit të grupit nuk është në përputhje me VKM-në Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar neni 74, pika 2 dhe 4, pasi nuk ka arsim të lartë (shofer), si dhe specialisti i fushës (i jashtëm) me detyrë inxhinier, nuk rezulton të ketë marrë pjesë në hartimin e specifikimeve teknike, duke funksionuar në këtë mënyrë grupi

me 2 anëtarë, jo në përputhje me VKM-në Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar nenin 74, pika 2.

-raporti përmbledhës mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe formulari i publikimit të njoftimit të kontratës Nr. 255/9 Prot., datë 14.06.2023 nuk janë nënshkruar në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, jo në përputhje me Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 i ndryshuar neni 97 dhe VKM Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar neni 73, pika 1, neni 84, pika 1 dhe neni 85.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLI LARTË I SHITIT